

VËRTETËSIA

BOTIM I XHEMATIT MUSLIMAN AHMEDIA TË SHQIPËRISË

NR. 14

WWW.ALISLAM.AL



6 GRADAT E ZHVILLIMIT MORAL

“Nijeti”

Shpjegimi i hadithit të parë nga “Dyzet hadithet e Neveviut”

26

Dhjetë argumente për ekzistencën e Zotit

30

Heshtja apo shenjtërimi

Mësimet islame për ruajtjen e nderit

40

Emrat e Allahut

Shpjegimi i atributit el-Ghaffâr dhe el-Kabbâr

84



Mesih i Premtuar

~ IMAM MEHDI

I Dërguari i Allahut ^{s.a.w.a} kishte paralajmëruar se Mesihu i Premtuar do të zbrësë pranë një minareje të bardhë, në lindje të Damaskut. Kjo profeci u përmbush me ardhjen e Hazret Mirza Ghulam Ahmedit ^{a.s.} në Kadijan të Indisë, një qytezë që ndodhet pikërisht në lindje të Damaskut.



Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ^{a.s.}, Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi lindi në vitin 1835 në një familje fisnike në Kadijan të Indisë. Që në moshë të re, ai shfaqti interes të veçantë për fenë dhe ushqe dashurinë për Profetin Muhammed ^{s.a.w.a}. Ai dallohej për fisnikërinë, dashamirësinë dhe vendosmërinë e tij. Me kalimin e kohës, njohuria dhe botëkuptimi i tij për besimin dhe zbatimin e tij në shoqëri u thelluan. Duke qenë një musliman i devotshëm, ai besonte fuqimisht se të gjitha fetë janë të vërteta për sa i përket origjinës së tyre, megjithatë përgjatë rrjedhës kohore ato u janë shmangur mësimëve burimore. Ai mbrojti dinjitetin e besimit dhe vërtetoi se ai është bashkëkohor dhe se u përgjigjet sfidave të kohës.

Përpjekjet e tij në përkrahje të besimit u shpërblyen prej Allahut, i cili e dalloj atë si shërbëtor të përkryer të Islamit, të Kuranit dhe të Profetit Muhammed ^{s.a.w.a}, duke i dhuruar bekimin e shpalljes nën shërbim të Profetit ^{s.a.w.a}.

Misioni i tij ishte të shquante të vërtetat që përmban çdo fe, si dhe të rigjallëronte mësimet e Islamit. Përmes këtij misioni, ai hodhi themelet për t'i bashkuar njerëzit dhe për të vendosur paqe e harmoni të përhershme.

Më 1889, sipas urdhrit hyjnor, Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ^{a.s.} themeloi Xhematin Musliman Ahmedia. Kjo bashkësi që tashmë është shumëfishuar në numër e në shtrirje, është angazhuar fuqimisht për të përçar mesazhin e Islamit deri në skajet e botës.

Gjatë periudhës në të cilën jetoi ai, Islami ishte nën shënjestër

të sulmeve armiqësore nga të gjitha anët dhe muslimanët në përgjithësi ishin në rënje të skajshme shpirtërore, me një besim të dyshimtë dhe krejtësisht sipërfaqësor. Ai ndërmoi një fushatë të jashtëzakonshme për t'i treguar botës fytyrën e bukur dhe të vërtetë të fesë islame. Ndër përpjekjet e tij të çmuara e madhore, mund të përmendim: mbi tetëdhjetë libra, të cilët janë përkthyer në më shumë se 60 gjuhë të botës si “Filozofia e mësimëve të Islamit”, “Brahin-e-Ahmedia” etj., qindra ligjërata me njohuri të thella të mistikës e debate të shumta fetare, të cilat argumentojnë më së miri se feja islame është një fe e gjallë, nëpërmjet së cilës njeriu mund të lidhë kontakt me Krijuesin dhe arrin të komunikojë me Të.

Shumica e veprave të tij janë shkruar në gjuhën urdu, disa në gjuhën arabe e disa të tjera edhe në gjuhën perse. Ai gjithashtu provoi se mësimet e Kuranit Famëlartë dhe ligji i fesë islame kanë fuqinë të ngrënë e të përsosin nivelin moral, intelektual dhe shpirtëror të njeriut. Ai deklaroi se Zoti i Madhërishtëm e ka caktuar atë si Mesih dhe Imam Mehdi, siç ishte përmendur në profecitë e Biblës, të Kuranit Famëlartë dhe të haditheve të Hazret Profetit Muhammed ^{s.a.w.a}.

Nga 1889 deri 1908 kur ai ndërroi jetë, mijëra njerëz iu bindën atij dhe lidhën besën me të. Ky bekim vazhdon të përhapet përmes Kalifëve (zëvendësve) të tij.

Aktualisht, Hazret Mirza Masrur Ahmedi (Allahu e ndihmoftë fuqimisht) është udhëheqësi botëror i Xhematit Musliman Ahmedia dhe Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar ^{a.s.} Ky Xhemat sot është përhapur në më shumë se 205 vende të botës dhe përbëhet nga miliona anëtarë.

e mira dhe e keqja



E mira dhe e keqja nuk mund të barazohen. Kundërpërgjigju përmes asaj që është më e mira, atëherë ai që ka armiqësi mes tij dhe teje, papritmas do të të bëhet mik i ngushtë.

ISLAMI, KURANI FAMËLARTË, 41:35.

Bëni mirësi. Me të vërtetë, Allahu i do mirëbërësit.

ISLAMI, KURANI FAMËLARTË, 2:196.

Ju jeni populli më i mirë që është nxjerrë për njerëzimin. Ju urdhëroni për të drejtën, ndaloni nga ligësia dhe besoni në Allahun.

ISLAMI, KURANI FAMËLARTË, 3:111.

I Dërguari i Allahut S.A.V.S.

tha: “Turpi është prej besimit dhe besimi është në xhenet. Imoraliteti është vrazhdësia dhe vrazhdësia është në xhehenem”.

ISLAMI,

PROFETI MUHAMMED S.A.V.S.

XHAMI' ET-TIRMIDHI, KITAB: "EL-BIRRU VES-SILETU 'ARR-RESULILLAHI S.A.V.S.", BAB: "MA XHAE FIL-HAJAJ", HADITHI NR. 2009.



Dhjetë urdhëresat

Unë jam Zoti, Perëndia yt, që të nxori nga vendi i Egjiptit, nga shtëpia e skllavërisë. Nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje. Nuk do të bësh skulpturë ose shëmbëlltyrë të asnjë gjëje që ndodhet aty në qiejt ose këtu poshtë në tokë ose në ujërat nën tokë. Nuk do të përkulesh para tyre dhe as nuk do t'i shërbesh, sepse unë, Zoti, Perëndia yt, jam një Perëndi xheloz që dënon padrejtësinë e etërve mbi fëmijët e tyre deri në brezin e tretë dhe të katërt të atyre që më urrejnë, dhe unë përdor dashamirësi për mijëra, për ata që më duan dhe që zbatojnë urdhëresat e mia. Nuk do ta përdorësh emrin e Zotit, të Perëndisë tënd, kot, sepse Zoti nuk do të lërë të pandëshkuar atë që përdor kot emrin e tij. Mbaje mend ditën e shtunë për ta shenjtëruar. Do të punosh gjashtë ditë dhe në ato do të bësh të gjithë punën tënde; por dita e shtatë është e shtuna, e shenjtë për Zotin, Perëndinë tënd; nuk do të bësh në atë ditë asnjë punë, as ti, as biri yt, as bija jote, as shërbëtori yt, as shërbëtorja jote, as kafshët e tua, as i huaji që ndodhet brenda portave të tua; sepse në gjashtë ditë Zoti krijoi qiejt dhe tokën, detin dhe gjithçka

që është në to, dhe ditën e shtunë ai pushoi; prandaj Zoti e ka bekuar ditën e shabatit dhe e ka shenjtëruar atë. Do të nderosh atin tënd dhe nënën tënde, me qëllim që ditët e tua të jenë të gjata mbi tokën që Zoti, Perëndia yt, po të jep. Nuk do të vrasësh. Nuk do të shkelësh besnikërinë bashkëshortore. Nuk do të vjedhësh. Nuk do të bësh dëshmi të rreme kundër të afërmit tënd. Nuk do të dëshirosh shtëpinë e të afërmit tënd; nuk do të dëshirosh gruan e të afërmit tënd, as shërbëtorin e tij, as shërbëtoren e tij, as lopën e tij, as gomarin e tij, as edhe një gjë tjetër që është e të afërmit tënd”.

JUDAIZMI,

DHJATA E VJETËR, EKSODI 20:2-17



Mos i shikoni me smirë cilësitë e mira të të tjerëve, por përvetësojini ato me admirim.

BUDIZMI,

ATISHA DIPAMKARA SRIJNANA

VËRTETËSIA

10 6 gradat e zhvillimit moral

Një shpjegim i thellë i Kuranit
Famëlartë, i cili sqaron 6 gradat e
zhvillimit moral të njeriut

HAZRET MIRZA BASHIRUDDIN MAHMUD AHMEDI ^{R.A.}
KALIFI I DYTË I MESIHUT TË PREMTUAR

18 Si mund të gjesh Zotin?

HAZRET MIRZA GHULAM AHMED ^{A.S.}
MESIH I PREMTUAR DHE IMAM MEHDI

**20 Nëse Zoti është i Mëshirshëm,
pse ka kaq shumë vuajtje
në botë?**

HAZRET MIRZA GHULAM AHMED ^{A.S.}
MESIH I PREMTUAR DHE IMAM MEHDI

26 Hadithi i parë “Nijeti”

Shpjegimi i hadithit të
parë nga “Dyzet hadithet e
Neveviut” të Imam Neveviut

**30 Dhjetë argumente për
ekzistencën e Zotit**

Argumenti i parë për ekzistencën
e Zotit është harmonia që
gjendet në fe të ndryshme

HAZRET MIRZA BASHIRUDDIN MAHMUD AHMEDI ^{R.A.}
KALIFI I DYTË I MESIHUT TË PREMTUAR

40 Heshtja apo shenjtërimi

mësimet islame për ruajtjen e nderit
dhe vendosjen e drejtësisë

IFTEKHAR AHMED

**52 Çfarë thotë ligji i Islamit
për përdhunimin?**

Si e përkufizon Islami krimin
dhe cilat janë bazat e masave
disiplinore në Islam

AL-HAKAM

**62 Shtatë nivelet e përsosjes
së namazit**

Cilat janë ato kushte në bazë të
të cilave, mund të dijmë se namazi
ynë a është i pranueshëm te Zoti?

**67 13 metoda për t’u zgjuar
për namazin e tehexhudit**

Të zgjohesh për namazin e tehexhudit
kërkon vullnet dhe disiplinë të lartë.
Këto metoda mund t’ju ndihmojnë
për ta arritur këtë disiplinë.

HAZRET MIRZA BASHIRUDDIN MAHMUD AHMEDI ^{R.A.}
KALIFI I DYTË I MESIHUT TË PREMTUAR

72 Sprovat në jetën e besimtarit

78 Kush është Dexhalli?

Shumica e muslimanëve i marrin fjalët e haditheve në lidhje me ardhjen e Dexhallit në mënyrë të drejtpërdrejtë. Por a është i drejtë një kuptim i tillë?

84 Emrat e Allahut

Vërtetësia ju sjell kuptime të thella që përmbajnë atributet e Allahut.

92 Pesë arsyt pse agjërojnë muslimanët?




10



30



40



Eseja e titulluar “*Filozofia e mësimeve të Islamit*” është shkruar në gjuhën urdu nga Hazret Mirza Ghulam Ahmed a.s., Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu, si përgjigje ndaj ftesës së Z. Svami Sad’hu Shogan Çander, i cili organizoi Mbledhjen e Madhe të Feve, në Town Hall të qytetit Lahor në datat 26 – 29 dhjetor të vitit 1896. Dijetarët muslimanë, të krishterë, arjë dhe të feve të tjera ishin ftuar për të përfaqësuar fenë e tyre përkatëse. Atyre u ishte caktuar të ligjëronin rreth pesë pyetjeve të kërkuara në bazë të Librit që ata besonin si Hyjnor:

1. Gjendjet trupore, morale dhe shpirtërore të njeriut
2. Cila është gjendja e njeriut pas kësaj jete, pra në botën vijuese?
3. Cili është qëllimi i vërtetë i qenies së njeriut në këtë botë dhe si mund të përmbushet ai qëllim?
4. Si ndikojnë veprat te njeriu në këtë botë dhe në botën vijuese?
5. Cilat janë mjetet për të arritur dijen dhe njohjen Hyjnore?

Lexoni online:

<https://www.ahmadiyya-islam.org/al/librat/>

ose blini këtu:

<https://www.ahmadiyya-islam.org/al/kontaktoni/>

VËRTETËSIA

KRYEREDAKTOR

Samad Ahmed Ghori

BORDI EDITORIAL

Jinahuddin Saif, Bujar Ramaj, Shahid Butt, Rexhep Hasani, Besmir Yvejsi

FAQOSJA

Shahid Butt

MENAXHER

Idriz Ramadani

Email: idriz.xhamajl@gmail.com

PËR ABONIM KONTAKTONI:

SHQIPËRI

Sali Beja

Email: salibeja@gmail.com

KOSOVË

Shkëlqim Bytyçi

Email: shkelqimbytyci@gmail.com

SHTYPUR NË SHTYPSHKRONJËN

RanaPoster.de Druckerei

Robert-Perthel-Str. 15

50739 Köln-Bilderstöckchen, Deutschland

Email: masood313@aol.com

ADRESA POSTARE

NË SHQIPËRI:

Xhemati Musliman Ahmedia i

Shqipërisë, pranë Vodafonit,

Rr. "Pavarësia" Km. 1, Mëzez,

Kutia Postare 8176, Tiranë, Shqipëri

vertetesia@gmail.com

NË KOSOVË:

Xhemati Musliman Ahmedia i Kosovës

Rr. "Elbasani", nr. 9,

Lagjja e Spitalit,

Kutia Postare 43,

Prishtinë 10000, Kosovë

Email: amj.kosovo@gmail.com

NË GJERMANI:

Albanian Desk

Barendorfer Bruch 15,

58640, Iserlohn, Deutschland

Email: albanian.desk@gmail.com

KONTAKT REDAKSI:

M +355 67 216 8054

+355 69 464 4888

+383 44 817 813

EMAIL

vertetesia@gmail.com

WEBSITE

www.alislam.al

Kurani Famëljartë



إِنَّ اللَّهَ يُأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَاءِ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ
الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَالْبَغْيِ يَعِظُكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ ﴿٩١﴾

Sigurisht, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe dashamirësinë si ajo që u tregohet të afërmve, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju të reflektoni.

Kurani Famëljartë 16:91

Hadithi



حَدَّثَنَا أَبُو نُعَيْمٍ، حَدَّثَنَا زَكَرِيَّا، قَالَ سَمِعْتُ غَابِرًا، يَقُولُ سَمِعْتُ الثُّعْمَانَ بْنَ بَشِيرٍ - رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا - عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ ” مَثَلُ الْقَائِمِ عَلَى حُدُودِ اللَّهِ وَالْوَاقِعِ فِيهَا كَمَثَلِ قَوْمٍ اسْتَهَمُوا عَلَى سَفِينَةٍ، فَأَصَابَ بَعْضُهُمْ أَعْلَاهَا وَبَعْضُهُمْ أَسْفَلَهَا، فَكَانَ الَّذِينَ فِي أَسْفَلِهَا إِذَا اسْتَقَوْا مِنَ الْمَاءِ مَرُّوا عَلَى مَنْ فَوْقَهُمْ فَقَالُوا لَوْ أَنَّا خَرَقْنَا فِي نَصِيبِنَا خَرْقًا، وَلَمْ نُؤْذِ مَنْ فَوْقَنَا. فَإِنْ يَتْرَكُوهُمْ وَمَا أَرَادُوا هَلَكُوا جَمِيعًا، وَإِنْ أَخَذُوا عَلَى أَيْدِيهِمْ نَجَّوْا وَنَجَّوْا جَمِيعًا “.

Hazret Nu'man ibn Beshiri ^{r.a.} rrëfen se Profeti i shenjtë ^{s.a.v.s.} ka thënë:

“Shembulli i atij personi, i cili iu përmbahet kufijve të caktuar të Allahut dhe i atij i cili i tejkalon, është si ai populli që hodhi shortin për të siguruar vend në një anije. Disave u ra kuverta e sipërme, kurse të tjerëve kuverta e poshtme. Ata të kuvertës së poshtme, kur u nevojitej ujë, kalonin përmes atyre që ishin në kuvertën e sipërme.

Atyre u ra ndërmend se nëse e bëjnë një vrimë në pjesën e poshtme të anijes, nuk do t'i trazonin udhëtarët e kuvertës së sipërme. Nëse ata, të kuvertës së sipërme i lejojnë të bëjnë këtë, të gjithë do të mbyten, ndërsa nëse i ndalojnë, të gjithë do të shpëtojnë”.



إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَاءِ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ
الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَالْبَغْيِ يَعِظُكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ ﴿٦﴾

6 GRADAT E ZHVILLIMIT MORAL

Sigurisht, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe dashamirësinë si ajo që u tregohet të afërmve, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju të reflektoni.¹

Fjalë kyçe:

Fjala ذِي الْكُرْبَى (dhil kurba) si farefisi: كُرْبَى (kurba) është një emër i përgjithshëm që rrjedh nga rrënja كَرَبَ ka-ru-be që do të thotë ai u afrua ose ishte i afërt. Fjala الْقَرَابَةُ el-Karabetu është gjithashtu emri i përgjithshëm që rrjedh nga قَرَب, por ndryshe nga كُرْبَى kurba që përdoret për lidhjet farefisnore midis njerëzve nga ana e babait, الْقَرَابَةُ el-karabetu tregon për lidhje gjaku ndërmjet njerëzve nga ana e nënës. Megjithatë, të dyja këto fjalë mund të përodren edhe në kuptimin e ndërsjellë².

Fjala مُنْكَر (munker) d.m.th. imoraliteti i dukshëm rrjedh nga نَكَر (ne-ke-re). Arabët thonë: نَكَرَ الرَّجُلُ عَمَامًا d.m.th. ai nuk e njohu apo dalloi atë njeri. نَكَرَ الْأَمْرَ (nekerel emre) ai e injoroi a shpërfilli çështjen, dhe nuk i kushtoi vëmendjen. نَكَرَ الْأَمْرَ (nekurel emru) do të thotë: çështja u ndërlikua, u bë e vështirë, u pështjellua, u koklaviti, u bë e mundimshme ose u bë e rëndë, e keqe, e neveritshme, e ndyrë ose e papranueshme. Fjala مُنْكَر (munker) është kundrinë e foljes نَكَرَ (enkere) e shprehur me një emër. Fjala مُنْكَر munker i përgjigjet çdo dukurie a veprimi që konsiderohet i shëmtuar, i pahjishëm, i qortueshëm dhe i neveritshëm nga arsyeja e shëndoshë dhe të cilin ligji (sheriati) e quan të ndaluar e të dënueshëm.³

Fjala إِحْسَان ihsan nënkupton aktin e bamirësisë dhe mirëbërësisë dhe të qenit mirë. Emri حُسْنَى husna përdoret për gjininë femërore dhe mbart këto kuptime: (1) sukses ose fitore, (2) gjëja më e mirë, (3) vullnetin ose vizionin e Zotit.⁴

Fjala الْفَاحِشَةُ (el-fabishetu d.m.th. imoralitet) rrjedh nga rrënja فَحَشَ fe-he-she. Arabët thonë فَحَشَ أَمْرُهُ d.m.th. çështja u shëmtua dhe u bë e ndyrë, e shthurur dhe e neveritshme. Kur thuhet فَحَشَتِ الْمَرْأَةُ kjo do të thotë; gruaja u bë e ndyrë, dhe e pomoralshme. فَاحِشَةٌ fabeshebu do të thotë, ai u ndesh me të dhe u përpoq ta mposhte atë me një gjuhë të ndyrë, të rëndë e të turpshme. Pra, fjala الْفَاحِشَةُ el-fabishetu do të thotë një teprim a tejkalim, dhe si emër ky i përgjigjet çdo gjëje që i ka kaluar caqet dhe normat e drejtësisë; ose që është jashtëzakonisht e turpshme,


e shëmtuar, imorale, e shthurur dhe banale. Ky emër i përgjigjet mëkatit ose krimit që është tepër i ndyrë; si tradhtia bashkëshortore ose kurvëria. **العُشَّاء** *el-fehsau* përveç që jep të njëjtin kuptim si **فاحشة** *fahishetun*, gjithashtu nënkupton koprracinë në pagesën e zekatit ose pagimin e tij në norma mjaft të ulëta.⁵

Fjala **بَغْيَا** *beğ-jen* rrjedh nga rrënja **ب غ ي** *be-ğ-je* dhe nënkupton kundërvajtje, padrejtësi, mizori, kriminalitet, lakmi, trazirë, dhunë, zili, korrupsion, shkelje e ligjit, shi të rrëmbyeshëm etj. Arabët thonë **بَغَى الشَّيْءَ** d.m.th. ai dëshiroi apo synoi atë gjë. **بَغَى الرَّجُلُ** *beğe-rrexhulu* do të thotë, njeriu bëri shkelje, mohoi të vërtetën, nuk u bind madje u revoltua kundër një autoriteti të ligjshëm, veproi në kundërshtim me një detyrim ligjor, shoqëror, moral a fetar dhe u largua nga e vërteta. **بَغَى عَلَيْهِ** *beğa 'alejhi* do të thotë, ai bëri padrejtësi dhe vijoi këtë veprim për një kohë të zgjatur (Akrab). **بَغَى عَلَى أَخِيهِ** *beğa 'ala ekhîh* do të thotë, ai e kishte zili vëllain e tij; ai kishte dëshirë të madhe e të pangopur për të pasur një mirësi që kishte vëllai i tij (Lane).

Komentim:

Një ajet përpara⁶, Kurani ka deklaruar se zotëron katër cilësi të jashtëzakonshme: (1) Është shpjegim i çdo gjëje, (2) është udhëzim, (3) mëshirë dhe (4) myzhde për ata që i nënshtrohen Zotit.

Këto dhe ajetet vijuese tregojnë jo vetëm të vërtetën e kësaj deklarate dhe vërtetojnë se Kurani përmbush në mënyrë të shkëlqyer qëllimin kryesor të shpalljes së tij. Edhe ajeti aktual, që përmban fjalë përmbledhëse, vërteton se deklarata e Kuranit është një fakt i pakundërshtueshëm. Ajeti përmban tri porosi dhe tri ndalesa. Këto tri urdhërime dhe ndalesa përfshijnë në mënyrë të përmbledhur të gjitha fazat e zhvillimit moral dhe shpirtëror të njeriut. Pra, ky ajet përbën një shembull të mirëfilltë të asaj që është përmendur për Kuranin në ajetin paraardhës, d.m.th. se ai përbën shpjegimin e çdo gjëje **تَبَيَّنَا لِكُلِّ شَيْءٍ**. Ajeti përfundon me fjalët **لَكُمْ تَذَكُّرُونَ** që do të thotë, që të kujtoni detyrimet që i keni ndaj Zotit dhe krijesave të Tij dhe gjithashtu që të lavdëroni madhështinë e Zotit dhe të shpallni lavdinë e Tij. Meqenëse këto përbëjnë qëllime për të cilat është





krijuar njeriu, ajeti u jep besimtarëve lajmin e hareshëm se nëse ata i ndjekin porosinë e Tij që gjenden në këtë libër, ata mund të arrijnë qëllimin e krijimit të tyre. Është me të vërtetë e mrekullueshme që Kurani Famëllartë, në një ajet kaq të shkurtër, ka hedhur dritë mbi çështjet që vërtetojnë deklaratën e tij të lartpërmendur.

Nuk është e mundur të gjejmë një kombinim të tillë të thjeshtësisë, koncizitetit dhe gjithëpërfshirjes në ndonjë shkrim tjetër hyjnor. Por pavarësisht se mbart një temë kaq të thellë, fjalët e këtij ajeti janë mjaft të qarta e të thjeshta dhe mund të kuptohen lehtësisht nga një person me inteligjencë të zakonshme.

Një pyetje nuk mund të trajtohet tërësisht nëse nuk i janë shpjeguar dhe ndriçuar të dyja anët e saj, pozitive e negative. Sërish, një shkrim hyjnor nuk mund të pretendojë se është i përsosur nëse nuk përvetëson këto tipare thelbësore:

1. Ai duhet të nxisë e të motivojë lexuesin për kryerjen e veprimeve të tilla që çojnë në përsosmërinë morale dhe shpirtërore të njeriut. Po ashtu, ai duhet ta ndalojë lexuesin nga sjelljet që janë të dëmshme për të arritur një përsosmëri të tillë.
2. Ai duhet t'i përshkruajë rregullat e normat, që kanë karakter të përgjithshëm. Pra, ata të mund të ndiqen e zbatohen jo nga një individ apo popull i caktuar, por nga shumica e individëve dhe popujve. Po ashtu, në hartimin e këtyre ligjeve duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë natyrës, vetisë dhe temperamentit të të gjithë atyre njerëzve, të cilëve ai drejtohet, në mënyrë që ata të mos hasin vështirësi në zbatimin e mësimave të tij dhe çdo person të veprojë në përputhje me aftësitë e tij ose të saj.
3. Karakteristika e tretë që duhet të ketë një ligj i përsosur është që mësimi i tij duhet të jetë praktik dhe i zbatueshëm. Po ashtu, zbatimi i mësimave të tij nuk duhet të çojë në rënien dhe përkeqësimin e moralit, intelektit apo qytetërimit njerëzor. Ajeti aktual ka thurur në mënyrë të mrekullueshme të gjitha këto cilësi thelbësore të një ligji të përsosur dhe njëkohësisht nuk ka






dështuar të trajtojë siç duhet çështjet thelbësore të zhvillimit moral të njeriut, si nga anët pozitive ashtu edhe ato negative. Ai bën thirrje për vendosjen e drejtësisë, mirësisë ndaj të tjerëve dhe dhembshurisë ndaj të afërmeve; dhe ndalon imoralitetin, të keqen e dukshme dhe shkeljen e padrejtë.


Drejtësia e rreptë do të thotë që një person t'i trajtojë të tjerët në mënyrë reciproke pra me të njëjtën frymë siç ata e trajtojnë atë. Ai duhet t'ua kthejë të tjerëve me të njëjtën monedhë, pra të sillet me të tjerët mirë apo keq në të njëjtën masë apo shkallë siç ata janë sjellë me të. Nëse flasim për عدل *adl* d.m.th. drejtësinë në lidhje me Zotin, derisa ajo është atributi i parë i përmendur në këtë ajet, ai do të nënkuptojë se ashtu siç Zoti sillet me mëshirë e dhembshuri me njeriun, edhe njeriu duhet t'i japë Zotit të drejtën e Tij dhe jo të drejtojë kritika ndaj Tij. Ai nuk duhet t'u japë të tjerëve atë që i takon Zotit, p.sh. në vend të Zotit, t'ua kushtojë besnikërinë dhe nënshtrimin të tjerëve. Barazimi i zotave të rremë me Të përbën gjithashtu padrejtësi ndaj Zotit. Në të njëjtën mënyrë, është në kundërshtim me kërkesat e drejtësisë që një njeri t'i atribuojë vetes ndonjë cilësi a veti që i përket vetëm Zotit.

Për shembull, shpallja e ligjeve fetare është një e drejtë që i takon posaçërisht vetëm Zotit. Por, nëse dikush ia atribuon vetes këtë të drejtë të shenjtë e posaçme hyjnore të Zotit dhe fillon të hartojë një ligj fetar dhe kërkon ta quajë atë si një ligji të shpallur, padyshim ai i kalon kufijtë e drejtësisë.

Të sillesh me drejtësi në raport me Zotin do të thotë të heqësh dorë nga të gjitha llojet e shirkut (d.m.th. nga barazimi i dikujt apo i diçkaje me Zotin), pabesisë dhe mosbindjes ndaj Zotit.

Një shkallë më e lartë se عدل drejtësia është faza e إحسان *ihسان* mirësisë. Në këtë fazë, njeriu nuk duhet t'i kushtojë asnjë vëmendje mënyrës se si e trajtojnë të tjerët. Ai duhet të sillet mirë me të gjithë, pa marrë parasysh se si sillen të tjerët me të. Ai duhet t'u bëjë mirë të tjerëve edhe nëse ata veprojnë me përbuzje e ashpërsi. Sjellja e tij në këtë fazë nuk duhet të nxitet nga qëndrimi hakmarrës apo bashkëveprim reciprok, por ai duhet t'u bëjë mirë të tjerëve pavarësisht nëse






ka gjetur dashamirësi prej tyre apo edhe nëse kanë shprehur përbuzje ndaj tij.


Me të vërtetë, kjo shkallë morale është më e lartë sesa faza e parë e drejtësisë. Cilësitë e faljes, bamirësisë, sakrificës, altruizmit, etj., të gjitha i përkasin kësaj kategorie. Përkrahja, mbrojtja dhe përkujdesja për përhapjen e dijes dhe disiplinimi a sistemimi i degëve të ndryshme të saj përfshihen gjithashtu në këtë shkallë, sepse ajo synon mirëqenien materiale dhe shpirtërore të njeriut.

Faza e fundit dhe më e lartë e zhvillimit moral të njeriut është إيتاء ذي القربى dashamirësia si ajo që u tregohet të afërmeve. Në këtë fazë, një njeri pritet t'u bëjë mirë të tjerëve jo si veprim reciprok në këmbim të ndonjë të mire të marrë prej tyre, as me idenë për të shumëfishuar shpërblimin për atë sjellje, por vetëm nga impulsi i brendshëm i nxitur nga një shtysë e natyrshme, njësoj siç ndodh në marrëdhënie fafëfisnore që kanë lidhje gjaku.

Kjo është një fazë morale shumë më e lartë se faza e إحسان mirësisë. Në fazën e mirësisë, mirëbërësi mund të ketë në nënvetëdije idenë se personi në fjalë i ka bërë diçka të mirë dhe se ai duhet t'ia kthejë në mënyrën më të mirë e kështu të fitojë miratimin publik. Po ashtu, nëse ai e fal një person që i ka bërë ndonjë të keqe, ai kënaqet se akti i tij i faljes do ta kthejë një armik në mik. Por në fazën إيتاء ذي القربى “dashamirësinë si ajo që u tregohet të afërmeve” një njeri u bën mirë të tjerëve i nxitur nga një shtysë e natyrshme. Gjendja e tij në këtë fazë i ngjan asaj të një nëne, dashuria e së cilës për fëmijët e saj buron nga impulsi i brendshëm dhe një dëshirë e natyrshme. Sakrificat e saj dhe mundimet e mëdha që ajo duron për fëmijët e saj me dashje e vetëdije, nuk nxiten aspak nga shpresa që ato do të shpërblehen apo vlerësohen. Ato kanë zanafillë në burimin e pashtershëm dhe të natyrshëm të dashurisë që Zoti e ka ngulitur në natyrën e saj. Në këtë fazë, zhvillimi moral i njeriut arrin në pikën më të lartë.

Mund të vërehet se raporti i njeriut me Zotin nuk mund të shkojë përtej fazës së drejtësisë, sepse është e pamundur që njeriu t'i bëjë ndonjë të mirë Zotit. Megjithatë, në raport me bashkëqytetarët e tij, ai mund të sillet sipas gjendjes së tij morale në fazën e “mirësisë” ose në fazën e “dashamirësisë si ajo që u tregohet







të afërmve”. Kjo na lë të kuptojmë se për të arritur afërsinë e Zotit dhe për të fituar favorin e Tij, është thelbësore që njeriu t’u bëjë mirë krijesave të Tij. Një përshkrim i këtyre tri fazave të moralit përbën anën pozitive të temës së zhvillimit moral të njeriut.

Ana negative e saj paraqitet në tre ndalesat të cilat shpjegohen me tri fjalët arabe: *الْفَحْشَاءُ* (imoralitet), *الْمُنْكَرُ* (vepra e shëmtuar) dhe *الْبَغْيُ* (dhunë). *الْفَحْشَاءُ* (*el-Fah’sha*) nënkupton vese të tilla për të cilat është në dijeni vetëm personi ai që bën, ndërsa *الْمُنْكَرُ* (*el-Munkuru*) do të thotë ato vepra, shëmtia e të cilave shihet dhe dënohet edhe nga njerëzit e tjerë, edhe pse ata nuk pësojnë ndonjë dëm e as nuk u cenohen të drejtat prej tyre. Megjithatë “veprat e shëmtuara” përfshijnë jo vetëm të gjitha ato vese dhe veprime që shihen, ndjehen dhe urrehen nga njerëzit, por që u sjellin atyre edhe dëme e humbje. Këto tri fjalë të thjeshta mbulojnë të gjitha veset e mundshme.

Një mësim i përsosur duhet të ketë parasysh kërkesat morale të njerëzve që kanë temperamente dhe prirje të ndryshme. Ajeti në fjalë e përmbush plotësisht këtë kusht thelbësor. Ka njerëz që mund të fajësohen për sjellje të pahijshme, por nuk do të pranojnë apo të përkrasin kurrë veprime të padrejta, nëse dëmi i prek edhe të tjerët. Ka të tjerë që nuk i cenojnë të drejtat e njerëzve të tjerë, por që vuajnë nga paturpësi dhe shpërbërje morale, dëmin e së cilës e pësojnë vetë. Ndër këto sjellje përfshihen përgojimi, smira dhe dashakeqësia ndaj të tjerëve. Tri fjalët e shkurtra të përmendura më sipër mishërojnë të gjitha llojet e veseve dhe sjelljeve të këqija ndaj të cilave njeriu mund të bjerë pre. Në këtë mënyrë, ky ajet i shkurtër i Kuranit, me anë të tri porosive dhe tri ndalesave, ka përfshirë gjithë etikën e virtytit dhe veseve e përmban udhëzime të nevojshme për njerëzit që kanë motive të ndryshme në fazat e ndryshme të zhvillimit të tyre moral.

Me një përzgjedhje dhe renditje të duhur të fjalëve, ky ajet ka shpjeguar rrugëtimin se si një njeri mund t’u shmanget në mënyrë rrënjësore të gjitha veseve dhe të përvetësujt të gjitha virtytet. Ai përmend tri kategoritë e virtyteve duke nënkuptuar se për t’i arritur ato, njeriu duhet së pari të kultivojë cilësinë e drejtësisë, pastaj do të jetë në gjendje të rrënjosë cilësinë më fisnike dhe më të lartë të mirësisë, dhe së fundi, pasi t’i ketë fituar këto dy cilësi morale, ai do të triumfojë në ngulitjen e cilësisë së *إِيَّاءٍ*





ذِي الْقُرْبَى “dashamirësisë si ajo që u tregohet të afërmve”, shkalla më e lartë dhe më fisnike nga të gjitha cilësitë morale.

Ndërsa për shmangien dhe largimin e veseve, njeriu duhet të fillojë me atë që është më e dukshme dhe më e dëmshme prej tyre, dmth prej البُغْيِ dhunës dhe shkeljes së gabuar. Pasi të ketë arritur ta mposhtë këtë ves, ai duhet të përpiqet të çrrënjosë vesin më pak të dukshëm të الْمُنْكَرِ *el-munker* veprave të shëmtuara. Kur të ketë thyer çdo qëndresë dhe të ketë hequr këtë të keqe, ai duhet të ngulmojë për të vënë nën kontroll vesin më delikat të الفَحْشَاء imoralitetit e të paturpësisë.

Përshkrimi i cilësive të larta morale dhe i veseve përkatëse së bashku në një ajet synon të tërheqë vëmendjen ndaj një fakti të rëndësishëm. Ajeti na mëson se për të fituar cilësi të larta morale, njeriu duhet të ngjitet nga pjesa më e ulët e shkallës, ndërsa për të zhdukur veset, ai duhet të niset me atë që është më i përfolur dhe më i dëmshëm. Kështu, për përsosmërinë morale, njeriu duhet të përshkojë gjashtë faza të zhvillimit. Këto faza përputhen harmonisht me ligjin e njohur të natyrës, dmth çdo gjë duhet të kalojë përmes gjashtë fazave të zhvillimit përpara se të arrijë përsosmërinë. Në këtë mënyrë, ky ajet sikur mishëron rrjedhën e plotë të evolucionit dhe rritjes morale dhe shpirtërore të njeriut.

SHËNIME:

1. *Kurani Famëlartë* 16:91.

2. *Lane*

3. *Lane dhe Akrebul Mevarid*


4. Si më lartë.

5. *Lane*

6. *Kurani Famëlartë* 16:90

وَنَزَّلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ تِلْكَ آيَاتُ الْكِتَابِ وَلَقَدْ آتَيْنَاكَ الْكِتَابَ وَلَقَدْ آتَيْنَاكَ الْكِتَابَ وَلَقَدْ آتَيْنَاكَ الْكِتَابَ وَلَقَدْ آتَيْنَاكَ الْكِتَابَ

Ty të kemi zbritur librin si shpjegues të çdo gjëje, udhëzim, mëshirë dhe lajm të mirë për të nënshtruarit. (e përkthyer nga anglishtja nga “*The Holy Quran with English Translation and Commentary*” vëll. 3, nën komentimin e ajetit 91 të sures en-Nahl, 2019, Islam International Publications Ltd., Qadian, Indi, f. 1706-1710)





Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}

Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi



Si mund të gjesh Zotin?

Mos mendoni se shpallja e Zotit nuk vjen më dhe se i takon vetëm së kaluarës¹ dhe se Shpirti i Shenjtë nuk zbret dhe se ka zbritur vetëm në kohërat e mëparshme. Singërisht ju them të vërtetën, çdo derë mbyllet, por dera nga e cila zbret Shpirti i Shenjtë kurrë nuk mbyllet. Hapni dyert e zemrave tuaja, që ai të hyjë në to. Ju largoheni vetë nga Ai Diell, në momentin kur mbyllni dritaren nga e cila mund të hyjë rrezja e Tij. O i pamend! Çohu dhe hape këtë dritare! Atëherë, Dielli vetvetiu do të hyjë brenda teje. Derisa Zoti nuk jua mbylli rrugët e bekimeve tokësore në këtë kohë, përkundrazi jua shtoi edhe më shumë, a mendoni që Ai ju paska mbyllur rrugët e bekimeve qiellore, të cilat ju duheshin shumë në këtë kohë? Kurrësi jo. Madje, ju është hapur me shumë qartësi.

Dhe tani që Zoti juaj hapi derën e të gjitha bekimeve të mëparshme, mu sipas Fjalës së Tij që Ai ju ka mësuar në suren El-Fatiha, ju vetë pse nuk pranoni t'i merrni ato? Jini të etur për këtë burim, që t'ju arrijë uji vetvetiu. Qani si foshnjë, që të dalë qumështi vetvetiu prej gjirit për ju. Bëhuni të denjë për t'u mëshiruar që të mëshiroheni. Shfaqni dhimbjen, që të gjeni karar. Lëshoni klithmat vazhdimisht, që një Dorë t'ju kapë për dore. Sa e vështirë është kjo rrugë, që është rruga e Zotit! Por ajo u bëhet e lehtë atyre që hidhen për "të vdekur" në këtë gropë të thellë, sepse ata e kanë vendosur me zemër se pranojnë zjarritin e digjen për të Dashurin e tyre. Por, si përfundim, zjarri ku ata hidhen qenka një parajsë! ... Ata që për hir të Zotit hidhen në këtë zjarr, do të shpëtojnë.

Kurse ai që për shpirtin am-marah² të tij ndjek rrugën e zjarrit, zjarri do ta gllabërojë atë. Të bekuar janë ata, të cilët luftojnë shpirtin e keq të tyre për hir të Zotit, dhe fatligë janë ata që luftojnë Zotin për hir të shpirtit të tyre të keq dhe nuk afrohen me Të. Ai që anashkalon urdhrin e Zotit për hir të shpirtit të tij, kurrsesi nuk do të pranohet në qiell. Prandaj, përpiquuni të mos dëshmojë kundër jush qoftë një fjalë a një pikë e Kuranit Famëlartë, që të mos ndëshkoheni pikërisht për atë pikë. Sepse, edhe një ligësi e vogël është e ndëshkueshme. Pak kohë keni dhe jetës nuk i dihet. Nxitoni, sepse po afrohet nata. Kontrolloni mirë atë që keni për të paraqitur, në mos ju mbetet ndonjë gjë e mangët; në mos keni marrë diçka të dëmshme, ose në mos gjithçka e juaja është e pistë dhe e kotë, apo e padenjë për t'u paraqitur në oborrin Mbretëror.

(¹"Mësimi ynë", f. 27-29, Islam International Publications Ltd., Tiranë, 2020)



NËSE ZOTI ËSHTË I MËSHIRSHËM, PSE KA KAQ SHUMË VUAJTJE NË BOTË?

Hazret Mirza Ghulam Ahmed a.s.

Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu ^{a.s.}



“Pyetja:

Nëse te Zoti ka dashuri, drejtësi dhe barazi, cila është arsyeja që disa gjallesa u bëhen ushqim disave të tjera? Nëse dashuria, drejtësia dhe barazia janë attribute të qenësishme e të veçanta të Zotit, përse Ai u ka dhuruar disa prej krijesave aftësi dhe fuqi që ato mund të hanë krijesa të tjera, ndërkohë të dyja duhet të gëzonin të drejtën e barazisë duke qenë krijesat e Tij?

Përgjigja:

Kur fjala dashuri përmendet për Zotin e Madhërishëm, është gabim i madh që ta logjikoni atë në bazë të dashurisë njerëzore. Kuptimi dhe ndikimi që ka kjo fjalë në marrëdhëniet njerëzore, në asnjë mënyrë nuk mund të jetë i njëjti në lidhje me Zotin e Madhërishëm, e as nuk mund të përligjet ai kur është fjala për dashurinë e Zotit. Njeriu ka ndjenjën e dashurisë dhe zemërimit, por perceptimi i këtyre ndjenjave në asnjë mënyrë nuk mund të jetë i njëjtë për Zotin. Këtu është gabimi. Në natyrën e njeriut vërejmë se kur ai dashurohet me dikë, brengoset në momentin kur largohet prej tij. Nëna e do fëmijën e vet, por sa shumë ajo tronditet dhe brengoset kur asaj i ndahet fëmija. Në të njëjtën mënyrë, kur njeriu zemërohet mbi dikë tjetër, së pari ai vetë pëson një tronditje dhe ndikim të zemërimit

të vet. Me një fjalë, i zemëruari për të ndëshkuar tjetrin, e ndëshkon edhe vetveten. Kjo tregon se te njeriu zemërimi është një brengë, e cila së pari ndikon mbi qenien e vet duke krijuar hidhërim dhe duke i marrë rehatinë dhe qetësinë. Por, Zoti i Madhërishëm është i pastër nga këto ndikime. Pra, është shumë e qartë që ndikimin që kanë këto fjalë tek njeriu ose në marrëdhëniet njerëzore, nuk mund ta aplikojmë mbi Zotin e Madhërishëm, pasi nuk është i pranueshëm për Qenien e Tij. Prandaj, ne nuk i duam këto fjalë. Kjo është sajësë e atyre njerëzve që Zotin e perceptojnë si njeri. Ai është i Shenjtë dhe i pastër nga këto mangësi. Çdokush që ndjek pëlqimin e Tij, fillon të krijojë lidhje me Të, gjithnjë e më të fortë. Po, fjala dashuri dhe zemërim simbolikisht mund të përdoren për Zotin e Madhërishëm.

... Fjala dashuri nënkupton një dhimbje. Edhe sikur të supozohet që Zoti është dashuri dhe se Ai ka edhe ndjenjën e zemërimit njësoj siç i ka njeriu, duhet të pranojmë edhe këtë tjetër që edhe Zoti brengoset dhe pëson dhimbje. Por, dijeni se fjalë kaq të kufizuara nuk mund të aplikohen mbi Zotin e Madhërishëm.

Pyetja:

E kuptova. Por dua t’ju pyes edhe këtë

se përse Zoti ka lejuar në këtë sistem që i dobëti t'i shërbejë të fortit, të bëhet ushqim për të dhe të poshtërohet para tij?

Përgjigjja:

Sapo e kemi thënë që atributet dashuria, mëshira dhe zemërimi në lidhje me Zotin ne nuk i përkufizojmë ashtu siç ato përkufizohen te njeriu. Është gabim i hapët ta pandehni Zotin të jetë në gjendjen e njeriut. Ky është një sistem shumë i gjerë i Zotit të Madhërishëm, të cilin kështu e ka krijuar Ai. Njeriu nuk mund të ndërhyjë përtej kufirit të tij në këtë sistem. Nuk është e denjë që të nxirrni pyetjet në çdo gjë që u përket çështjeve të fshehta hyjnore. Kjo botë është një botë e kufizuar. Pas kësaj Zoti i Madhërishëm ka përgatitur një botë shumë të gjerë dhe Ai ka vendosur dhe premtuar që atje do t'u jepet lumturia e vërtetë dhe e përhershme. Çdo shqetësim që keni në këtë botë, do t'ju kompensohet në botën tjetër. Çdo mangësi që shihni në këtë botë, do të plotësohet në botën e ardhshme. Për sa u përket shqetësimeve, dhimbjeve, vështirësive, brengave etj., këto të gjithë i ka njësoj, edhe i dobëti, edhe i forti dhe kjo ishte e nevojshme për qëndrueshmërinë e sistemit të kësaj bote. Po të shihni me sy largpamës, askush nuk është larg shqetësimeve. Çdo krijesë sipas kapacitetit të saj është e detyruar të marrë diçka prej tyre. Dikush në një

mënyrë e dikush tjetër në një mënyrë tjetër. Shqiponja rrëmben zogjtë e vegjël, tigri, luani dhe ujku sulmojnë fëmijët e njeriut, gjarpërinjtë dhe akrepa bëjnë punën e tyre, pra ky është një zinxhir që vazhdon dhe askush nuk mund të dalë jashtë tij. Por për kompensimin e këtyre shqetësimeve Zoti i Madhërishëm ka lënë edhe një botë tjetër. Për këtë arsye, në Kuranin Famëlartë Zoti quhet edhe Sunduesi i ditës së gjykimit (Maliki jeumid-din). Dikush mund të thotë se njeriu është i lumtur, por edhe kjo është e mundur që zogjtë dhe bagëtيت janë më të lumtura se njeriu. Kjo botë është një sprovë. Për ta zgjidhur këtë është caktuar ajo bota tjetër. Çdo shqetësim që ju sjell kjo botë, Zoti ju premtton se do t'jua kthejë në qetësim në botën vijuese. Nëse dikush prapë këmbëngul dhe pyet, përse e ka bërë kështu e përse nuk e ka bërë ashtu, përgjigjja është që është Zoti që pushton dhe sundon. E ka bërë si të dojë Ai. Askush nuk ka të drejtë ta akuzojë Atë për diçka që ka bërë.

Është edhe diçka tjetër që duhet menduar. Shqetësimet e njeriut janë më të mëdha sesa shqetësimet e shtazëve. Për këtë arsye, edhe shpërblimi për njeriun është më i madh sesa për shtazët. Shqetësimet e njeriut janë të dyllorshme: 1) Shqetësimet që u vijnë për shkak të ligjit dhe 2) shqetësimet që i vijnë nga Caktimi. Në të dytën marrin pjesë thuajse në mënyrë të barabartë edhe

njerëzit, edhe shtazët. Nëse njerëzit vrasin kafshët, ata edhe vriten prej tyre. Po ashtu, edhe në shqetësime të tjera të kësaj kategorie njerëzit dhe kafshët kanë një lloj barazie. Por në shqetësimet ligjore, nuk marrin pjesë shtazët. Urdhrat e sheriatit (të ligjit) janë një lloj thike që vendoset mbi qafën e njeriut, gjë që nuk e kanë shtazët. Çështjet e sheriatit janë një lloj vdekjeje që njeriu është i detyruar ta pranojë. Nga ky këndvështrim na del se shqetësimet njerëzore janë shumë më të mëdha sesa ato shtazore.

Pika e tretë që duhet ta kemi parasysh është që shqisat njerëzore janë shumë të përparuara e të ndjeshme. Shtazët dhe bimët nuk e kanë një gjë tillë. Kjo është arsye që shtazët nuk zotërojnë intelektin. Mendja lind ndjenjat. Shtazët ngaqë nuk e kanë aq të plotësuar mendjen, ato jetojnë në një lloj ngeje. Ndjenjat te njeriu janë më të dukshme, kurse kafshët këto i kanë aq të pakta sa hiç. Prandaj, shtazët i ndiejnë shumë pak këto shqetësime dhe ka mundësi që në disa raste të mos i ndiejnë fare. Pra, nga ky këndvështrim mund të mendoni se cilët janë më të shqetësuarit në botë? Njerëzit apo shtazët? Padyshim që janë njerëzit ata që marrin pjesën më të madhe të shqetësimeve të kësaj bote”.¹

SHËNIME:

Malfuzat, vëll. 5, botuar Rabvah, 2003, f. 672-674; Gazeta El-Hakam, data 30 maj 1908, f. 4-7.



MENDIMI JUAJ ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR NE


Na shkruani komentet, mendimet
dhe sugjerimet tuaja në WhatsApp,
Viber ose Telegram në numrin

+355 69 4644 888

ose në email

amj.albania@gmail.com

VËRTETËSIA



TRI KATEGORITË E TË MËKATUARIT


“Njerëzit hyjnë në mëkate në tri mënyra. Së pari, disa njerëz për disa mëkate nuk dinë fare se ato janë të tilla dhe nga padijenja mëkatojnë. Padyshim që mëkatet e mëdha e të njohura, të gjithë i dinë. Gjithkush di që vjedhja, rrëmbimi, kurvëria, gënjeshttrat etj. janë mëkate dhe duhet të rrijë larg nga ato. Por, një shtëpi nuk mund të kompletohet derisa të plotësohet me të gjitha elementet e saj. Nëse dikush ndërton vetëm katër mure dhe nuk hedh çatinë, shtëpia e tij s’është e mbrojtur nga shiu dhe dielli. Shtëpia e kompletuar duhet të ketë një çati, disa dritare etj. Në të njëjtën mënyrë, asnjëri nuk mund të bëhet i pastër shpirtërisht, derisa të mos jetë vigilent ndaj të gjitha aspekteve të mëkateve.

Ka disa mëkate të fshehta që nuk mund t’i kapësh pa pasur dije të thellë për to dhe pa bërë përpjekje të mundimshme. Për çdo gjë janë të përcaktuara mjetet që e mbrojnë, por ka edhe elemente të tjera që i japin bukuri. Nëse këto të fundit nuk përdoren, nuk prish shumë punë, por nëse të parat mbeten pa bërë, atëherë ajo gjë nuk mund të realizohet. Për shembull, shtëpia nuk kompletohet derisa nuk i vendosni dyert e dritaret. Por, nëse i vendosni ato dhe nuk hidhni dyshtemenë ose nuk i hidhni beton shtëpisë, atëherë ajo edhe pse është e mbrojtur, nuk ka bukuri.

Prandaj, nëse një njeri s’ka njohuri për disa mëkate të caktuara dhe mendon që do të ketë sukses në këtë rrugë, edhe sikur të përpiqet ditë e natë, nuk mund ta arrijë suksesin. Sepse në këtë mënyrë, ai do të anashkalojë disa gjëra që nuk duhen anashkaluar. Thënë ndryshe, ai nuk do të ruhet nga disa gjëra, prej të cilave duhet ruajtur. Ai gabon nëse pretendon të bëhet i përsosur shpirtërisht, sepse kushti i suksesit të tij është që ai të jetë vigilent në të gjitha aspektet. Pra, gjëja e parë që i duhet, është që të bëhet i vetëdijshëm për mëkatet.

Arsyeja e dytë pse njerëzit bëjnë mëkate është se disa njerëz edhe pse kanë njohuri për mëkatet, kur vjen koha, ata pushtohen nga tundimi i tyre dhe mëkatojnë, duke harruar çdo gjë. Për shembull, nëse dikush është vigilent që nuk duhet të flasë gënjeshtër, kur vjen koha, nuk përmbahet dhe gënjen e pastaj pendohet. Në të njëjtën mënyrë një njeri e di që të shajë dikë është mëkat, por prapë shan sepse rrëmbehet nga rrethanat e pastaj bëhet pishman. Pra, pengesa e parë është që njerëzit s’kanë dije për mëkatet, ndërsa e dyta është që njerëzit edhe pse dinë për mëkatet, në kohën kur u vjen dëshirë e fortë për të bërë mëkat, ata harrojnë çdo gjë dhe mëkatojnë e pastaj vetëm pendohen”.

Shpjegimi i 40 haditheve

A person is standing on a dark, rocky peak, looking out over a vast landscape at sunset. The sun is a bright, glowing orb in the center of the sky, surrounded by soft, orange and yellow clouds. The person is silhouetted against the bright light of the sun. The foreground is dark and rocky, with some sparse vegetation. The overall mood is contemplative and serene.

HADITHI I I-RË “NIJETI”

عَنْ أَمِيرِ الْمُؤْمِنِينَ أَبِي حَنْصَلٍ عُمَرَ بْنِ الْخَطَّابِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ: "إِنَّمَا الْأَعْمَالُ بِالنِّيَّاتِ، وَإِنَّمَا لِكُلِّ امْرِئٍ مَا نَوَى، فَمَنْ كَانَتْ هِجْرَتُهُ إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ فَهِجْرَتُهُ إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ، وَمَنْ كَانَتْ هِجْرَتُهُ لِدُنْيَا يُصِيبُهَا أَوْ امْرَأَةٍ يَبْتَهِجُهَا فَهِجْرَتُهُ إِلَى مَا هَاجَرَ إِلَيْهِ".

رَوَاهُ إِمَامُ الْمُحَرَّرِينَ أَبُو عَبْدِ اللَّهِ مُحَمَّدُ بْنُ إِسْمَاعِيلَ بْنِ إِبْرَاهِيمَ بْنِ الْغُبَيْرَةِ بْنِ بَرْزَنْهَ الْبَخَارِيُّ الْجَنْغِيُّ [رق: 1]، وَأَبُو الْحُسَيْنِ مُسْلِمُ بْنُ الْحَجَّاجِ بْنِ مُسْلِمِ الشَّافِعِيِّ التَّبْسَاوَرِيُّ [رق: 1907] رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا فِي "صَحِيحَيْهِمَا" اللَّذَيْنِ هُمَا أَصَحُّ الْكُتُبِ الْمُصَنَّفَةِ.

Prijësi i besimtarëve Hazret Omer ibn el-Hattabi ^{r.a.} rrëfen se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ^{s.a.v.s.} duke thënë:

“Veprat varen prej qëllimeve dhe çdo njeri shpërblehet sipas nijetit që ai ka pasur. Pra, kushdo që shpërngulet drejt Allahut dhe të Dërguarit të Tij, shpërngulja e tij, me të vërtetë, është tek Allahu dhe i Dërguari i Tij. Ndërsa, ai që shpërngulet për të arritur diçka prej kësaj bote apo për t’u martuar me ndonjë grua, shpërngulja e tij do të jetë po sipas qëllimit që ka pasur”.

Komentim i shkurtër

Kjo thënie profetike është prej *Xhevamiul Kelim* حوامع الكلم pra nga ato hadithe që përbëjnë fjalë të pakta por kuptime të thella. Për këtë arsye, dijetarët e kanë konsideruar si një prej thënieve thelbësore e qendrore të Islamit, madje thuhet që i gjithë botëkuptimi i Islamit sillet rreth këtij boshti. Disa dijetarë e kanë vlerësuar si një të tretën e Islamit apo si një të tretën e dijes. Imam Buhariu ^{r.a.} ka zgjedhur pikërisht këtë hadith për

ta nisur veprën e tij madhështore të koleksionit të haditheve dhe ka thënë që nuk ka hadith më urtiplotë e më kuptimplotë se sa kjo. Me të vërtetë i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka ngjeshur gjithë thelbin e besimit në një thënie të vetme. Ky hadith përmban parimin themelor, përmes të cilit, njeriu dallohet nga bota shtazore, dhe instinkti i tij i pavetëdijshëm hyn në shkallën morale. Në këtë pikë, veprimet e tij tashmë i përgjigjen arsyes dhe lidhen ngushtë me normat morale, dhe kështu e bëjnë njeriun të ndërgjegjshëm për sjelljen e tij dhe ai u nënshtrohet kufizimeve të përcaktuara në ligjin hyjnor.

Imam Shafiu ^{r.a.} ka thënë që ky hadith përmban një të tretën e diturisë së Islamit. Ai thotë që veprat e njeriut përfshijnë zemrën, gjuhën dhe gjymtyrët e tij, andaj qëllimi i zemrës përbën një të tretën e veprave. Sipas Imam Shafut ky hadith zgjidh 70 temat e *fik’hut*. Imam Ahmedi ka thënë që Islami ngrihet mbi tri themele, të cilat janë tri hadithe:

1. Hadith i parë është ky që u citua më lartë.
2. “Kush shpik diçka të re në fenë tonë, e cila nuk ka qenë prej saj, nuk do t’i pranohet”.
3. “*Hallalli* (e lejuara) është i qartë dhe harami (e ndaluara) është i qartë, ndërsa midis tyre ka gjëra të dyshimta, të cilat shumë njerëz nuk i njohin...”.

Këto tri thënie mund të konsiderohen si tri kritere të rëndësishme që përcaktojnë sjelljen e muslimanëve në veprimet e tyre të përditshme. Në këtë mënyrë muslimani sjell një harmoni të plotë në botën e tij të brendshme dhe të jashtme. I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} fillimisht na tregon parimin (se veprat varen nga nijeti) dhe pastaj e shtjellon atë duke paraqitur tre shembuj. Kjo është metoda e Profetit ^{s.a.v.s.} që ai shpjegon porosi me anë të shembujve të thjeshtë, me qëllim që njerëzit të kenë më të lehtë të kuptojnë dhe të zbatojnë ato në jetën e përditshme.

Veprat bazohen në qëllim

1. Në gjuhën arabe, janë dy fjalë të cilat i përgjigjen nuancës kuptimore të fjalës “veprim”. Ato janë فعل *Fe’l* dhe عمل *Amel*. Dijetarët kanë thënë që fjala Fe’lun i referohet atij veprimi që bëhet instinktivisht e në mënyrë të pavetëdijshme, të cilit i mungon qëllimi, ndërsa fjala ‘Amalun i referohet veprimit i cili bëhet me vetëdije dhe në mënyrë të qëllimshme. Kur bëhet me vetëdije, vepra e njeriut cilësohet si e mirë apo e keqe, dhe rrjedhimisht meriton shpërblym apo ndëshkim. Në këtë hadith është përdorur pikërisht fjala ‘Amal dhe në bazë të këtij shpjegimi, hadithi tregon që veprimet instinktive kalojnë cilësohen si ‘Amal apo arrijnë shkallën morale, kur ato shoqërohen me qëllim.

Raporti midis veprës dhe qëllimit,

nënvizon lidhjen që ekziston midis faktorëve truporë dhe spiritualë të cilët gjendet brenda një njeriu. Hadithi vë në dukje rëndësinë e të pasurit një qëllim dhe një objektivë për çdo veprim fizik që ne e kryejmë. Me të thënë këtë, del në pah nevoja për një lidhje midis vetëdijes sonë dhe veprimet tona fizike dhe rrjedhojat e tyre shpirtërore.

Përderisa qëllimet na prijnë te rezultatet, prandaj ndryshimi që pëson qëllimi në rrjedhën e veprimit, shkakton dhe ndryshimin e zhvillimeve të jashtme. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm, prandaj Atij i mjafton vetëm qëllimi ynë i sinqertë, për të ndryshuar realitetin tonë të jashtëm. Prandaj, për të arritur ndryshim në gjendjen tonë të jashtme, duhet të ndërmarrim ndryshime të nevojshme në qëllimin tonë.

2. Ky hadith na mëson gjithashtu që veprat arrijnë përfundimin kur të jenë lidhur me qëllim. Qëllimi është i domosdoshëm për çdo veprim. Vetëm mendimi, dëshira, pëlqimi apo prirja e brendshme nuk mjaftojnë absolutisht për të përfunduar një punë. Rrënja e fjalës nijet është نية *Nevatun* që do të thotë bërthamë apo pjesë thelbësore dhe qendrore e farës, që përmban të gjitha tiparet e zhvillimit dhe prej së cilës dalin filiza të njomë, të cilat rriten dhe përfundimisht kthehen në pemën e veprave.

3. Meqë vepra për nga rezultati varet nga qëllimi, prandaj sa më i vendosur dhe i matur do të jetë qëllimi, po aq qëndrueshmëri dhe maturi do të shfaqet në realizimin e saj. P.sh. një njeri vendos për të ndërtuar një shtëpi. Menjëherë pas këtij nijeti, do të ndikohet ndjeshëm gjendja e tij ekonomike. Ai do të kërkojë burime të tjera të ardhurash, e nëse në një anë nuk do të përtojë nga rendimenti i lartë i punës, në anën tjetër do të frenojë shpenzime të panevojshme. Pra, sa më i qëndrueshëm, i qartë dhe i vendosur do të jetë nijeti, në të njëjtin proporcion do të ndikohen veprat e tij. Këtu qëndron sekreti i zhvillimit të njeriut dhe i bukurisë së veprave të tij.

4. Një veti e rëndësishme e besimtarit është إخلاص ikhlas d.m.th. sinqeritet. Ai gjithmonë duhet të jetë i drejtë dhe i sinqertë ndaj Allahut. Përmes çdo veprimi, ai duhet të synojë vetëm pëlqimin e Allahut. Ky pëlqim mund të arrihet duke ndjekur gjurmët e të Dërguarit të Allahut^{s.a.v.s.}, i cili është modeli më i përsosur për mbarë njerëzimin. Duke ndjekur rrugën e tij, në adhurim, në etikë (normat morale) dhe në marrëdhëniet shoqërore, mund të shpresojmë për të fituar pëlqimin e Allahut.

5. Besimtari vazhdimisht duhet të kontrollojë nijetin dhe të analizojë qëllimin e veprave të tij. Ai duhet të pyesë veten: Përse po bëj këtë që po

bëj tani? Në këtë hadith i Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.} ka dhënë shembullin e hixhretit (mërgimit). Muslimanët e parë u detyruan të bënin hixhret dy herë gjatë jetës së Profetit^{s.a.v.s.}, vetëm për hir të besimit. Por, nëse dikush shpërngulet duke pasur një qëllim tjetër, ai nuk do të shpërblehet për këtë vepër.

6. Veprat e këqija nuk mund të bëhen të lejueshme nga qëllimi i shëndoshë dhe as anasjelltas. Për shembull, namazi është shkalla më e lartë e adhurimit, mirëpo kur njeriu i fal namazet për syfaqësi, Allahu ia kthen mbrapsht. Po ashtu, nëse dikush jep lëmosha për t'u rënë në sy njerëzve, vepra e tij nuk do të pranohet tek Allahu.

Përfundim:

Ne duhet të bëjmë çdo veprim duke synuar pëlqimin e Allahut. Një vepër e mirë që shoqërohet me një qëllim të keq, nuk do të na sjellë asnjë shpërblim në ahiret.

SHËNIME:

[1] Sahihu i Buhariut, hadithi nr. 1

[2] Fat'hul Bari, vëll. I, f. 14

[3] Sahihu i Buhariut, #2697

[4] Sahihu i Buhariut, #52

Dhjetë argumente për ekzistencën e Zotit



Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmedi

Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar ^{r.a.}

Argumenti i 1-rë

Kundërshtimi më i madh ndaj feve dhe besimeve, i ngritur nga bota që beson vetëm në aspektin lëndor të gjërave, është mbi vetë ekzistencën e Zotit. Idhujtarët pavarësisht se adhurojnë idhuj të tjerë krahas Zotit, prapëseprapë të paktën besojnë në ekzistencën e Tij. Kurse ateistët e mohojnë tërësisht. Shkenca e sotme dijen e çdo gjëje e ka bazuar mbi shqisën e të parit, për këtë arsye, ateistët në përgjithësi pyesin:

Nëse Zoti ekziston, na e trego që ta shohim! Si mund ta besojmë Atë pa e parë vetë?

Fryma e botës së sotme ka fshirë nga zemrat e shumë të rinjve shenjat e Asaj Qenieje të Pastër. Studentë të shkollave të larta, pedagogë, avokatë etj., gjithnjë e më tepër po bëhen mohues të Zotit. Rreth jush mund të hasni me mijëra njerëz, të cilët për shkak të frikës nga populli a vendi, nuk e shfaqin mendimin e tyre, por e vërteta është se përbrenda nuk besojnë hiç në ekzistencën e Zotit. Prandaj, e pashe të udhës, nëse Zoti i Madhërishëm më mundëson, të shkruaja e të botoja një libërth për këtë temë, se ndoshta

ndonjë shpirt i pastër përfiton.

“Do të besojmë në Zot, vetëm kur ta shohim me sy!”

Më ka rastisur shpesh ta dëgjoja këtë kërkesë, dhe çdo herë më ka habitur. Gjëra të ndryshme njeriu i njeh nëpërmjet shqisave të ndryshme. Disa gjëra i njeh me të parë, disa i njeh me të prekur, disa me të nuhatur, disa me të dëgjuar, disa me të shijuar e me radhë. Ngjyrën e bojës mund ta dalloni vetëm duke e parë dhe jo duke e nuhatur, as duke e prekur, e as duke e shijuar. A nuk do t’ju duket qesharak ai që këmbëngul se do ta dallojë ngjyrën, duke i dëgjuar zërin?!

Tingujt i njohim nëpërmjet dëgjimit. A nuk do ta quanim qesharak atë që do të pretendonte se sheh me sy zërin e dikujt?! Gjithashtu, aromën e ndieni me shqisën e të nuhaturit. Por nëse dikush ju kërkon: “do ta besoj se ky është trëndafil, nëse më mundëson ta ha aromën e tij”, a do ta merrnit seriozisht?!

Po ashtu, gjërat që dallojmë nëpërmjet të shijuarit, siç janë ëmbëlsirat, të kripurat, të hidhurat, të thartat

etj., nëse dikush këmbëngul t'i njohë nëpërmjet të nuhaturit, nuk do të arrijë kurrë. Pra, nuk është domosdoshmëri që ne të besojmë vetëm gjërat që na dalin para syve, e ato që nuk i shohim, të mos i besojmë, sepse kështu do të na duhet të mohojmë aromën e trëndafil, thartësinë e limonit, ëmbëlsinë e mjaltit, hidhësinë e pelinit, fortësinë e hekurit, jehonën e zërit dhe çdo gjë tjetër si këto, pasi nuk i shohim dot me sy.

Prandaj, a nuk ju duket i pakuptimtë kundërshtimi i atyre që nuk besojnë në Zot vetëm e vetëm sepse nuk e shohin me sy Atë? Duke qenë se kundërshtarët e tillë besojnë në ekzistencën e gjërave që kemi renditur më sipër edhe pa i parë ato me sy, përse vallë vetëm për Qenien e Zotit të Madhërishtë thonë se nuk e besojnë përderisa nuk e shohin me sy Atë?!

Përveç kësaj, vetëm brenda trupit të njeriut ka shumë gjëra që të gjithë ne besojmë se ekzistojnë dhe që funksionojnë, pa i parë ndonjëherë me sy. A besoni apo jo se në trupin tuaj keni një zemër, një mëlçi, mushkëri, brinjë, shpretkë, edhe pse kurrë nuk i keni parë ato me sy? Nëse njeriut do t'i duhet t'ia vinim përpara gjithë këto, a do të mbetej i gjallë për t'i parë ato me sytë e vet?!

Në shembujt që janë ilustruar më sipër ju tregova për gjërat që pavarësisht se nuk ka nevojë t'i shohim me sy për t'i vërtetuar, na duhet patjetër njëra nga shqisat e mbetura. Por ka edhe shumë

gjëra të tjera që nuk i dallojmë dot drejtpërdrejt me asnjërën prej këtyre pesë shqisave dhe metoda për t'i njohur ato është krejtësisht tjetër. Për shembull, mendja, kujtesa, intelekt, etj. janë gjërat që askush në botë nuk i mohon dot, por a mundet vallë që dikush ta ketë parë mendjen, ose ta ketë dëgjuar, ose ta ketë shijuar ose ta ketë nuhatur?! Pse atëherë beson se mendja ekziston?!

Mendoni pak për forcën. Çdo njeri ka forcë, dikush më pak, dikush më shumë, por këtë a e ka parë ndokush me sy në formë fizike, ose a e ka dëgjuar, a e ka prekur apo e ka shijuar?! Pse atëherë çdo njeri në botë, qoftë i shkolluar apo i pashkolluar, beson se forca ekziston. Arsyeja është që shohim pasojat dhe ndikimet e forcës. Po ashtu, kur njeriu has një vështirësi, mendon për të gjetur një rrugëdalje dhe e gjen atë. Atëherë kupton se ka diçka që i shërben në situata të tilla dhe e quan mendje. Pra, mendjen ne nuk e kemi zbuluar drejtpërdrejtë nga asnjëra prej pesë shqisave tona, por vetëm duke dëshmuar mrekullitë e saj.

Po kështu, vërejmë që njeriu ngre barra shumë të rënda, dhe kuptojmë se ai zotëron diçka që e mundëson t'i ngrejë ato ose arrin t'i nënshtrojë gjërat më të dobëta se ai, dhe këtë e quajmë forcë.

Kështu që, një gjë e caktuar sa më shumë të jetë e patrupëzuar, aq më shumë ajo është larg shikimit të njeriut dhe njeriu gjithmonë do ta vërtetojë atë nëpërmjet

ndikimeve të saj dhe jo nëpërmjet shqisës së të parit, as të të shijuarit, as të të nuhaturit dhe as të të prekurit.

Kurse Allahu i Madhërishëm është Qenia më e patrupëzuar se çdo gjë tjetër e patrupëzuar. Si mundet vallë që njerëzit t'i lejojnë vetes t'i vënë kufizime të tilla pikërisht Zotit duke thënë se nuk do ta besojnë, derisa nuk do ta shohin Atë?! Vallë, kanë parë me sy rrymën elektrike? Nëse jo, a e mohojnë ekzistencën e energjisë së saj, dhe të të gjitha funksioneve që realizohen përmes saj?!

Zbulimi i etherit (mediumit) në botën fizike shkaktoi një jehonë, por shkencëtarët deri më sot nuk kanë mundur dot të krijojnë ndonjë mjet për ta parë atë, apo për ta dëgjuar, për ta shijuar apo për ta prekur atë. Por nëse mohojnë ekzistencën e tij, nuk mund ta shpjegojnë dukurinë sesi mbërrin drita e diellit në Tokë. Pra, a nuk është padrejtësi që duke i pasur këto dëshmi, për çështjen e Zotit njeriu të këmbëngulë se do ta besojë vetëm nëse do ta shikojë Atë?!

Realisht, Allahu i Madhërishëm shikohet, por me ata sy që janë të aftë ta shohin Atë. Nëse dikush e kërkon Zotin, Zoti i shfaqet atij përmes fuqive dhe mrekullive të Tij dhe pavarësisht se Ai është i fshehtë, mund të bëhet gjëja më e dalluar për të. Kurani Famëlartë e shpjegoi këtë temë shkurt,

por në mënyrë mbresëlënëse. Zoti i Madhërishëm thotë në Kuran:

لَا تُدْرِكُهُ الْأَبْصَارُ وَهُوَ يُدْرِكُ الْأَبْصَارَ وَهُوَ اللَّطِيفُ الْخَبِيرُ

Sytë nuk e arrijnë Atë dhe Ai i arrin sytë. Ai është i Mprehti, i Gjithinformuari.¹

Në këtë ajet Zoti i Madhërishëm i tërheq vëmendje njeriut duke thënë se shikimi i tij nuk ka aftësi ta shohë Qenien e Zotit, sepse Ai është i Patrupëzuar. Gjërat që nuk kanë trup, nuk rroken nga sytë, siç është mendja, forca, shpirti, rryma elektrike, etheri, etj.. Ndërsa Zoti i Madhërishëm është Qenia më e patrupëzuar se gjithçka tjetër, si mund ta rrokin sytë e njerëzve Atë?!

Shtrohet pyetja: Si mundet atëherë që njerëzit ta shohin dhe ta njohin Atë? Përgjigjen e jep pjesa e dytë e këtij ajeti që thotë: “Ai i arrin sytë”. Pavarësisht se shikimi i njeriut është i dobët dhe si i tillë nuk e rrok dot Zotin, Ai manifeston Veten e Tij përpara njeriut, duke i treguar fuqinë madhështore, krijimtarinë e jashtëzakonshme dhe cilësitë e Tij të përsosura. Ai shfaqet përpara njeriut herë përmes shenjave të llahtarshme, herë përmes profetëve të Tij, herë përmes shenjave të mëshirës së Tij, e herë duke i pranuar lutjet dhe përgjërimet.

Pra, nëse e kushtëzoni besimin në Zot me mundësinë për ta parë me sy Atë, atëherë do t'ju duhet të mohoni pesë të katërtat e fenomeneve, e madje sipas

disa filozofëve që pohojnë se asgjë nuk është e dukshme në botë, përveç cilësive të gjërave, do t'ju duhet të mohoni të gjitha fenomenet.

Pas këtij sqarimi, më lejoni të paraqes prova që tregojnë ekzistencën e Zotit dhe që bindin njeriun se ai nuk është i vetëkrijuar, por e ka një Krijues.

ARGUMENTI I PARË

Sipas bindjes sime Kurani Famëlartë i ka treguar të gjitha mjetet për të arritur përsosurinë shpirtërore, prandaj, të gjitha argumentet për ekzistencën e Zotit do t'i paraqes po nga Kurani Famëlartë.

Prej Allahut vjen mundësia!

Duke qenë se me të ardhur në këtë botë, njohuritë e para njeriu i merr përmes aftësisë së tij të të dëgjuarit, ndaj argumenti i parë i ekzistencës së Zotit që doja të paraqisja, lidhet pikërisht me kujtesën e tij dëgjimore.

Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëlartë thotë:

قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّىٰ ۖ وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّىٰ ۚ بَلْ تُؤَظُّرُونَ الْخَيَاةَ الدُّنْيَا ۚ وَالْآخِرَةَ خَيْرٌ وَأَتَقَىٰ ۖ إِنَّ هَذَا لَفِي الصُّحُفِ الْأُولَىٰ ۖ صُفِّىٰ إِبْرَاهِيمَ ۖ وَمُوسَىٰ ۖ

Fitoi ai që u pastrua. Dhe përmendi emrin e Zotit të tij, dhe e adhuroi. (Pra, së pari ta pranojë edhe gojarisht Zotin e tij e më pas ta adhurojë Atë edhe praktikisht.) Por ju e zgjidhni jetën e

kësaj bote, ndërkohë ahireti (ose jeta përfundimtare) është më i miri dhe më i qëndrueshmi. Këtë e thonë (jo vetëm Kurani Famëlartë, por) edhe Librat e parë, pra, edhe Libri i Ibrahimit, edhe Libri i Musait.²

Në këtë ajet, Zoti i Madhërishëm u jep argument kundërshtarëve duke thënë se ata që heqin dorë nga tundimet vetjake, që besojnë në Zotin e Madhërishëm e më pas tregojnë bindje të plotë ndaj Tij, gjithnjë fitojnë dhe korrin sukses dhe se prova e këtij mësimi është përbashkësia e tij edhe në fetë e mëparshme.

Kështu që, Kurani sjell si shembuj fetë kryesore të kohës, judaizmin dhe krishterimin, dhe ngaqë u drejtohet idhujtarëve të Mekës, u kujton Hazret Ibrahimin ^{a.s.} dhe Hazret Musain ^{a.s.}, të cilët ata i pranonin dhe u thotë: Edhe këta të njëjtin mësim kanë dhënë.

Kështu që, një prej dëshmimeve të fuqishme që Kurani Famëlartë jep për ekzistencën e Zotit është që të gjitha fetë janë unanime dhe të gjithë popujt janë në një mendje për këtë. Sa më shumë të thelloheni në këtë argument, aq më i pastër dhe aq më i vërtetë ju duket. Është fakt i njohur që të gjitha fetë e botës bashkohen te kjo pikë:

ka një Zot që krijoi gjithë këtë univers.

Ndonëse mund të ketë dallime në doktrina dhe besime për shkak të dallimeve gjeografike dhe rrethanore,

të gjitha fetë e pranojnë universalisht ekzistencën e të Madhit Zot.

Të gjitha fetë ekzistuese, pra Islami, Krishterimi, Judaizmi, Budizmi, Sikhizmi, Hinduizmi dhe Zoroastrizmi, që të gjitha besojnë në ekzistencën e një Zoti të Plotfuqishëm, që e quajnë Allah, Elohim, Pàràmeshvâr, Pàràmatma, Sâtgurû ose Jezdân, pavarësisht se kanë pikëpamje të ndryshme për sa u përket attributeve të Tij.

Edhe për fetë që janë zhdukur, të dhënat arkeologjike tregojnë se ato që të gjitha besonin në një Zot. Pra, si ata që jetonin të izoluar në kontinentin amerikan, si ata që jetonin nëpër pyje të Afrikës, si banorët e lashtë të Romës, të Anglisë, të Java-Sumatrasë, të Japonisë, të Kinës, të Siberisë apo të Mançurisë, të gjithë e kanë pasur besimin në një Zot.

Si mund të ketë arritur kjo harmoni në besim dhe kush ishte ai që ua tregoi banorëve të Amerikës besimin dhe bindjet e banorëve të Indisë ose banorëve të Kinës besimin e afrikanëve të lashtë?!

Në të kaluarën nuk kishin as mjetet e transportit dhe të telekomunikacionit, si treni, telegrami, posta etj., siç i kemi sot, as nuk kishin avionë ose anije të mëdha që venin e vinin ndërmjet kontinenteve. Ata udhëtonin vetëm me kuaj e mushka dhe, edhe anijet me vela që kishin, u duheshin muaj për të

bërë një udhëtim që në kohën tonë e realizojmë vetëm për disa ditë. Shumica e vendeve as nuk ishin zbuluar për të gjithë njerëzit. Atëherë si mund të kenë bërë pakt pikërisht për këtë besim popuj të largët, me kultura, zakone dhe gjuhë kaq të ndryshme?

Është vështirë të bashkohen dy njerëz në diçka që është e sajuar. Prandaj, fakti që kaq shumë popuj dhe vende kanë pasur besimin në një Zot, pa pasur mundësi për shkëmbimin e ideve, është dëshmi e vërtetësisë së këtij besimi dhe është dëshmi që atyre u ishte kumtuar ky besim përmes një metode të panjohur, të cilën e ka sqaruar Islami (në Kuranin Famëlartë).

Historianët pajtohen se kur një informacion është pohuar nga kronistët e popujve të ndryshëm [antikë], ai duhet të konsiderohet autentik. Prandaj, kur miliona njerëz bashkohen për këtë besim themelor, pse nuk duhet pranuar që ata ta kenë pranuar për shkak të një manifestimi Hyjnor?!

SHËNIME:

[1] Kurani Famëlartë 6:104.

[2] Kurani Famëlartë 87:15-20.

Pjesë e shkëputur nga libri *“Dhjetë argumente për ekzistencën e Zotit”* botuar nga Fond. Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë në 2019 në Tiranë, Shqipëri.

Hallali dhe harami

Cili është koncepti i tyre në Islam?



Islami është një fe që synon të aftësojë njeriun për të arritur potencialin e tij të plotë – veçanërisht në lidhje me pastërtinë e tij shpirtërore. Islami gjithashtu i ngulit në zemër një dashuri të pakrahasueshme për arritjen e përsosmërisë në pastërti e dëlirësi, dhe e edukon të përmbahet tërësisht nga gjithçka që nuk është e pastër. Ky është ai boshti kryesor rreth të cilit sillet koncepti i hallallit (e lejueshme) dhe të haramit (e palejueshme).

Nëse keni një shok apo koleg musliman, me siguri duhet ta keni dëgjuar fjalën hallall, veçanërisht në lidhje me ushqimin. Po ashtu, gjatë kalimit nëpër dyqane ushqimesh apo picërie, me siguri keni parë produkte të etiketuara me logon “Hallall” me shkronja të trasha. Në të vërtetë, termi hallall në Islam ka një domethënie shumë më të thellë, e cila përfshin një hapësirë shumë më të gjerë sesa thjesht ushqimi dhe materialet e konsumit.

Ai përdoret për të përshkruar kufijtë që Zoti ka vendosur në çdo aspekt të jetës sonë, që kanë të bëjnë jo vetëm me ushqimin, por edhe me martesën, me fitimet apo edhe me sjelljen tonë të përditshme. Me anë të këtij termi, Zoti dhe i Dërguari i Tij i Shenjtë, Muhammedi ^{s.a.v.s.}, përfkufizojnë se çfarë është e lejueshme për ne dhe çfarë është e ndaluar, të gjitha për hir të pastrimit të plotë nga çdo lloj zvetënimi e degjenerimi. Ashtu siç është përmendur më parë, mësimet e Islamit kanë për qëllim të zgjidhin problemet duke qëlluar në rrënjët e tyre, dhe synojnë të

shmangin edhe rrezikun më të vogël që shkaktohet nga veprat e këqija.

Në Kuranin Famëlartë Zoti ka përmendur një parim të përgjithshëm lidhur me atë që konsiderohet Hallall. Ai thote:

يَسْأَلُونَكَ مَاذَا أَحَلَّ لَهُمْ قُلْ أُحِلَّ لَكُمْ الطَّيِّبُ

Ata të pyesin se çfarë u lejohej. Thuaju: Ju lejohen të pastrat.¹

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ishte obliguar t’ia përcillte këtë përgjigje çdokujt që e pyeste se çfarë është e ligjshme. Çdo gjë që është e dobishme dhe e pastër, është bërë Hallall për ne, dhe gjithçka që është e dëmshme për ne është përshkruar qartësisht e ndaluar nga Zoti në Kuranin Famëlartë në terma të qartë. Nuk ka asnjë paqartësi në lidhje me ndalimet specifike të bëra nga Zoti. Për shembull, konsumimi i mishit të derrit², pirja e alkoolit³, marrja e interesit⁴ dhe lidhja martesore me gra si nëna, motrat, tezet, hallat ⁵, janë ndaluar shprehimisht në Kuranin Famëlartë, duke mos lënë asnjë mëdyshje.

Zoti nuk ka vendosur këta kufij për të na penguar në ndonjë mënyrë, përkundrazi për të na mbrojtur nga shpërdorimi i krijimit të Zotit dhe për të skalitur dëlirësinë brenda shpirtit.

عَنْ سَعِيدِ بْنِ يَسَارٍ، أَنَّهُ سَمِعَ أَبَا هُرَيْرَةَ، يَقُولُ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ “مَا تَصَدَّقَ أَحَدٌ بِصَدَقَةٍ مِنْ طَيِّبٍ – وَلَا يَقْبَلُ اللَّهُ إِلَّا الطَّيِّبَ – إِلَّا أَخَذَهَا الرَّحْمَنُ بِبَيْمِهِ وَإِنْ كَانَتْ نَمْرَةً فَزَبَوُ فِي كَفِّ الرَّحْمَنِ حَتَّى تَكُونَ أَعْظَمَ مِنَ الْجَلَلِ كَأَنِّي أُحَدِّثُ فَلَوْهُ أَوْ فَصِيلَةٌ.”

Një herë i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} po u shpjegonte sahabëve se lutjet e atij që ushqehet, vishet dhe vepron në kundërshti të hapur (haram), nuk

sjellin asnjë rezultat⁶. Në këtë mënyrë, nxjerrim përfundimin se gjithçka që arrihet nga mjetet e paligjshme nuk është hallall, përkundrazi është haram. Nëse i nxjerrim fitimet tona përmes mjeteve të paligjshme, ato fitime dhe gjithçka e fituar përmes tyre, bëhet e paligjshme.

Për sa i përket ushqimit, mishi mbetet gjithmonë një çështje disuktimi. Shumë veta pyesin për një lloj të veçantë mishi prej viçit apo pules është hallall apo jo. Dihet se viçi dhe pula të dy janë hallall, ose me fjalë të tjera të lejueshme për t'u konsumuar. Zoti ka përmendur në disa pjesë të Kuranit se çfarë është e lejueshme dhe çfarë nuk është. Një shembull i kësaj dispozite është si në vijim:

إِنَّمَا حَرَّمَ عَلَيْكُمُ الْمَيْتَةَ وَالدَّمَ وَلَحْمَ الْخَنَازِيرِ وَمَا أَهْلَ بِهِ لغيرِ اللَّهِ فَمَنْ أَضْطَرَّ
غَيْرُ بَاغٍ وَلَا عَادٍ فَلَا إِثْمَ عَلَيْهِ إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ

Ai ju ka ndaluar vetëm ngordhësirën, gjakun, mishin e derrit dhe atë, për të cilën i është lutur dikujt tjetër përveç Allahut. Por ai që detyrohet tej mase dhe që nuk është as lakmues e as shkelës i kufijve, nuk bën mëkat. Allahu, pa dyshim, është shumë Falës, Mëshirëbërës.⁷

Përveç atyre që Zoti ka ndaluar shprehimisht, çdo gjë tjetër është e lejueshme për t'u konsumuar me kushtin që të jetë e pastër dhe e dobishme për njeriun nga ana shëndetësore, ashtu siç

përshekruan Allahu:

وَكُلُوا مِمَّا رَزَقَكُمُ اللَّهُ حَلَالًا طَيِّبًا ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي أَنْتُمْ بِهِ مُؤْمِنُونَ

Dhe hani nga ajo që ju ka dhënë Allahu, të lejuara, të pastra. Kini drojë Allahun, të cilin e besoni.⁸

Zoti ka përmendur se konsumimi i mishit të derrit dhe gjakut është i dëmshëm për njerëzit dhe për shëndetin e tyre, prandaj Ai e ka ndaluar atë. Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ^{a.s.} i cili ka deklaruar se është Mesih i Premtuar dhe ka themeluar Xhematin Musliman Ahmedia, ka shpjeguar një aspekt më të thellë të ndalimit të mishit të derrit. Ai shkruan:

“Kush nuk e di që kjo kafshë ha ndyrësira më shumë se të gjitha kafshët dhe është kryekëput e paturpshme dhe e pacipë. Nga kjo, del në pah edhe arsyeja e ndalimit të saj, sepse sipas ligjit të natyrës, mishi i një kafshe të tillë të paturpshme e të ndyrë në trupin dhe shpirtin e njeriut ndikon ndyrazi, siç e kemi provuar që edhe ushqimet medoemos ndikojnë në shpirtin e njeriut. Prandaj, nuk ka dyshim që një e keqe e tillë, ka ndikim negativ.

Mjekë grekë, që në kohën para Islamit, dhanë mendimin e tyre që mishi i kësaj kafshe ul ndjenjën e turpit dhe shfrenon epshet. Sheriati Islam e ndalon edhe mishin e kafshës së ngordhur, sepse edhe

ai ndikon me natyrën e vet tek ai që e ha. Mishi i saj është edhe i dëmshëm për shëndetin”.⁹

Nga ushqimi që konsumojmë deri te mjedisi në të cilin kalojmë kohën – të gjithë këta faktorë ushtrojnë një ndikim të thellë në gjendjen tonë të brendshme apo shpirtërore. Kjo është arsyeja që qëndron pas ndalimit të ushqimeve të tilla të dëmshme dhe urdhrit për ta ngrënë atë që është hallall dhe e pastër. Përveç kësaj, ajeti i mësipërm i Kuranit Famëlartë gjithashtu përmend ndalimin e ushqimit që blatohet ose përgatitet në emër të dikujt tjetër përveç Zotit. Ndonëse, ushqime të tilla nuk përbëjnë ndonjë rrezik të qenësishëm për shëndetin, është vetëm çështje besimi dhe besimtarët gjithmonë konsumojnë vetëm atë që është përgatitur në emër të Atij, i cili u ka siguruar çdolloj ushqimi. Megjithatë, Islami është një fe që bazohet në arsye, e cila i identifikon nevojat e njeriut dhe e mbështet dëshirën e tij për t’u mbijetuar. Madje, në rrethanat specifike kur jeta njerëzore është në rrezik, Zoti i bën të ligjshme gjërat që janë të paligjshme në rrethana të zakonshme. Pas ndalimit të gjakut dhe mishit të derrit, Zoti thotë:

فَمَنْ أَضَلُّ عَرَّ بَاغٍ وَلَا عَادٍ فَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ غُورٌ رَجِيمٌ

Por ai që detyrohet tej mase dhe që nuk është as lakmues e as shkelës i kufijve, nuk bën mëkat. Allahu, pa dyshim, është

shumë Falës, Mëshirëbërës.¹⁰

Nëse mbijetesa e një personi varet nga konsumimi i mishit të derrit, atëherë kjo bëhet përkohësisht e lejueshme për të, por vetëm në masën që i nevojitet për mbijetesë.

Si përfundim, mësimet e Islamit në lidhje me hallall dhe haram janë shumë të qarta dhe zbatimi i tyre i mundëson njeriut pastrimin shpirtëror dhe përdorimin e drejtë të krijimit të Zotit. Dispozitat islame synojnë vetëm mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes njerëzore, dhe përpiqen të reformojnë jo vetëm individin, por edhe shoqërinë në tërësi.

SHËNIME:

[1] Kurani Famëlartë 5:5

[2] Kurani Famëlartë 16:116

[3] Kurani Famëlartë 5:91

[4] Kurani Famëlartë 4:162

[5] Kurani Famëlartë 4:24

[6] Sahihu i Muslimit, Kitab: ez-Zekatu, bab: Kubulis-Sadakati minel-Kesbit-tejibi ue terbijetiha, hadith nr. 1014a

[7] Kurani Famëlartë 2:174

[8] Kurani Famëlartë 5:88

[9] Hazret Mirza Ghulam Ahmed a.s., Filozofia e mësimet të Islamit, f. 66, Islam International Publications Ltd., Tiranë, 2019, ISBN: 978-9928-4491-5

[10] Kurani Famëlartë 2:174

HESHTJA APO SHENJTËRIMI

MËSIMET ISLAME PËR RUAJTJEN E NDERIT
DHE VENDOSJEN E DREJTËSISË



IFTEKHAR AHMED

QENDRA AHMEDIANE E ARKIVIT DHE E KËRKIMIT
(ARC - AHMADIYYA ARCHIVE AND RESEARCH CENTRE)

Ndonëse niveli i lartë i zhvillimit material, i mundësuar nga risitë shkencore e teknologjike, ka revolucionuar pothuaj çdo fushë të interesit njerëzor, por ka dështuar që (ky zhvillim) të bashkërendohet me ndonjë përmirësim në kategoritë e ndërlidhura dhe të përbashkëta të paqes - p.sh. në paqen shpirtërore, paqen e brendshme, dhe në paqen shoqërore etj.

Përkundrazi, pakënaqësia, ankthi dhe humbja e besimit në lidhje me të ardhmen janë bërë më të dukshme dhe në të njëjtën kohë, besimi në përgjithësi në diskursin civil është disi përjashtuar nga jeta shoqërore. Dukuritë tronditëse si rritja e shkallës së vetëvrasjeve, veçanërisht në mosha të reja, dhe nisja e shumë lëvizjeve të ndërtuara rreth çështjes së të drejtave themelore si dhe motiveve të fshehta, kanë marrë përmasa të jashtëzakonshme.

Identifikimi i shkaktut që qëndron pas këtyre dukurive është kthyer në subjekt të debatit publik dhe unë dua të kontribuoj në këtë debat të vazhdueshëm duke ofruar perspektivën islame në një aspekt specifik: aspektin e verbalizimit në hiperseksualizmin e shfrenuar të sotëm; sepse në asnjë fushë tjetër të jetës njerëzore, materializmi nuk ka sjellë pasoja kaq të rënda, ashtu siç ka lënë në fushën e seksualitetit.

Hiperseksualiteti: Si kemi përfunduar

në këtë derexhe?

Për këdo që ka studiuar sadopak historinë e Oksidentit, duhet të ketë të qartë se koncepti paramodern perëndimor dhe socio-seksologjik¹ i ekzistencës dhe ai që dominon sot në këto mjedise ndryshojnë diametralisht me njëri-tjetrin. Sipas përshtypjes së jashtme, sot, për sa i përket socio-seksologjisë, ekzistojnë një mizëri modelesh të ndryshme jetese, mes të cilave duket një konkurrencë e lirë dhe e gjallë.

Me kalimin e kohës, botëkuptimi dhe mendësia e Oksidentit, e cila për një kohë mjaft të gjatë, ishte formësuar dhe dominuar nga doktrinat krishtere nisi jo vetëm të shfaqej dukshëm, por arriti kulmin, duke ngjallur neveri ndaj institucionit fetar dhe genies së Zotit.

Si rrjedhojë, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë në perëndim, nisi kritika masive dhe shfaqti skepticizëm ndaj besimit. Një nga faktorët vendimtarë në këtë zhvillim ishte ideja dhe botëkuptimi i krishterë, të cilat konsideroheshin si mjaft të shkëputura e kontradiktore me jetën reale. Një nga këto ide themelore është antagonizmi fetar ndaj ndjenjave epshore dhe seksualitetit, dhe “pesimizmi seksual” i kishës dhe klerikëve të saj. (Sipas pikëpamjes pesimiste, dëshirat seksuale mund të jenë problematike nga ana morale dhe përbëjnë kërcënim për racionalitetin tonë)

Përveç revolucioneve sociale dhe kulturore, periudha e pas Luftës së Dytë Botërore u shoqërua me shfaqjen e të ashtuquajturit revolucion seksual (ose çlirimi seksual), i cili kërkoi të çlironte shoqërinë nga rregullat dhe ndalimet e krishterimit, i cili kishte nisur të perceptohej si diçka fanatike. Megjithatë, në rrjedhën e këtyre ndryshimeve, u çliruan forca të shfrenimit e të shthurjes, të cilat nëpërkëmbën të gjitha frenimnet. Këto forca, në mënyrë të pashmangshme zhvendosën shoqërinë nga një ekstrem në tjetrin.

Ndryshe nga paraardhësit tanë, ne tani kemi qasje në diçka që atyre u mungonte: përvoja 50 vjeçare dhe provat sociologjike, psikologjike, mjekësore dhe të fushave të tjera të ngjashme për pasojat e revolucionit seksual. Ajo që vihet re në veçanti, është se gratë kanë mbartur pasojat më të mëdha nga ajo që vazhdon të konsiderohet si një përmbysje e suksesshme. Seksualiteti publik që mbizotëron sot ka zëvendësuar vetëm një lloj objektivizimi me një tjetër. Sipas “gjyshërve” intelektualë të teorive shoqërore, një revolucion seksual nuk ka ndodhur kurrë, as atëherë, as më vonë. Madje, në vend të saj, ishte lëshuar një zhurmë mediatike me të njëjtin emër. Për ata që kanë studiuar në hollësi lëvizjen e revolucionit seksual, fituesit e kësaj hisotrie janë të qartë. Ata janë tregtarët e seksit, të cilët janë shpërblyer me fitime përrallore për kontributet e

tyre në këtë çlirim.

Rritja e banalizimit dhe ekspozimit të trupit në publik, si dhe normalizimi i një fjalori të ndyrë e të shthurur nuk na çon në më shumë liri. Media dhe industria e reklamave janë fiksuar të paraqesin gjatë gjithë kohës të njëjtët imazhe që objektivizojnë trupin e njeriut. Përveç kësaj, prezenca masive e imazheve seksuale kudo nëpër filma, reklama, revista dhe në “pop muzikë” si dhe përhapja e pakufizuar e pornografisë përmes internetit po sjellin pasojat jashtëzakonisht të dëmshme.

Megjithatë, sot ndër zhanret e shfaqjeve problematike të lejueshmërisë së shfrenuar seksuale, pornografia përbën një ekstrem ose thënë ndryshe është vetëm maja e ajsbergut.

Aspekti i veçantë që unë dua ta trajtoj këtu, shpesh shpërfillet ose nuk i kushtohet vëmendja e duhur. Unë u referohem rregullave që përcaktojnë kufijtë e lejueshmërisë dhe të ndalimit për të folurin në nivelin publik, nga këndvështrimi islam.

Këndvështrimi i Islamit

Islami është një fe që e konsideron këtë botë si dhe rrethanat, kushtet dhe ligjet që mbizotërojnë në të si të krijuara nga Zoti, që funksionojnë me vullnetin e Zotit. Kurani Famëllartë, i zbritur nga Zoti, i referohet vetes si **كِتَابٌ مُبِينٌ** (*kitabun*

mubin) “libri i qartë”,² ndërsa natyra e njeriut, e krijuar nga Zoti, përmendet si *كِتَابٌ مُكْنُونٌ* (*kitab meknun*) “libri i fshehtë”.³ Këtu ekziston një kongruencë absolute dhe e pakushtëzuar midis këtyre të dyve. Për këtë arsye, Islami është ajo fe që e vendos natyrën njerëzore përsosmërisht në qendër të vëmendjes, dhe e ndihmon atë të zhvillojë në shkallën më të lartë, pasi ai synon përputshmërinë dhe lidhshmërinë e së brendshmes me të jashtmen.

As epshi seksual e as kënaqësia trupore nuk janë dukuri negative; por ato bëhen të tilla kur kthehen në një dëshirë të tepruar apo në një fenomen të shturur, p.sh. duke i kthyer ato në dukuri publike, parim ky që vlen edhe për mënyrën e të folurit.

Plotësimi i epshit seksual përmes rrugës së lejuar dhe ndërprerja e tij e plotë janë dy gjëra të ndryshme. Liria duhet të ushtrohet brenda një kornize të shëndetshme, e cila e shmang afrimin e qasjeve ekstreme, pra të hedonizmit⁴ ose të hedonofobisë. Ajo që Islami synon të përmbajë është lejueshmëria e shfrenuar (unbridled permissiveness) e cila fshihet e mbuluar nën maskën e lirisë. Sot ajo është një nga shtylla e degjenerimit shoqëror të kohës sonë, ndërsa Islami synon të kanalizojë instinktet njerëzore në përputhje me rrethanat.

Kurani Famëlartë trajton shkaqet, jo

thjesht simptomat

Një parim metodologjik i jurisprudencës në Islam është luftimi i shkaqeve dhe jo vetëm i simptomave. Ky parim respektohet duke bllokuar veprimet dhe mjetet e ligjshme për parakushtet dhe pasojat e tyre, të ashtuquajturat *sadd edh-dharai*.⁵ Për shembull, Kurani i Shenjtë jo vetëm thotë se besimtarët nuk duhet të kryejnë kurvëri ose kurvëri, por thotë:

وَلَا تَقْرُبُوا الزَّوْجَ

“Dhe mos iu afroni kurvërisë ose tradhtisë bashkëshortore”.⁵

Dhe thotë:

وَلَا تَقْرُبُوا الْفَوَاحِشَ مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَمَا بَطَنٌ

“Dhe mos iu afroni paturpësive, as të dukshmes e as të padukshmes së tyre”.⁶

Kufijtë në lirinë e shprehjes

Nëse mendojmë për bazat më themelore, mbi të cilat qëndron shoqëria e sotme, padyshim liria mund të konsiderohet një nga vlerat më të dalluara. Ne ndodhemi aktualisht në mes të një krize të lirisë. Ne kemi filluar t’u shmangemi të gjithë atyre faktorëve të rëndësishëm, të cilët kanë qenë stabilizues dhe formues përgjatë rrugëtimit të qytetërimit. Sot është bërë shumë e lehtë të hedhim poshtë të vërtetën dhe mirësjelljen, ndërsa korrektësia politike është kthyer

në një fjalë të pistë.

Ekzistojnë dy lloje lirish: liria nga diçka dhe liria për të bërë diçka. Kur flasim për lirinë prej diçkaje, ajo në asnjë mënyrë nuk nënkupton çlirimin apo “heqjen qafe” nga e vërteta, mirësjellja a etika njerëzore. Po ashtu, duhet të mbështesim lirinë për të bërë diçka, kur ajo nënkupton lirinë për të pasur një jetë kuptimplotë dhe objektive. Fatkeqësisht, shumica nga ne kërkojmë një jetë të lumtur (apo egoistike), ndërsa kër kemi i një jete kuptimplotë po bëhet gjithnjë e më rrallë. Pra, kemi një pabarazi dhe mospërputhje, qysh në konceptin dhe përkufizimin e fjalës “liri”.

Dihet që vendosja e kufizimeve në liri dhe veçanërisht në lirinë e shprehjes është e nevojshme dhe ky parim i pajton normat islame me konventat ndërkombëtare për të drejtën e njeriut. Në këndvështrimin e ligjit të Islamit, qëllimi kryesor i lirisë së shprehjes, është në radhë të parë të krijojë mjedisin, i cili mund të ndihmojë në njohjen e së vërtetës si dhe për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor. Në këtë mënyrë, sipas ligjit islamik, e drejta e lirisë së shprehjes nuk është absolute, por e kushtëzuar nga shprehja e drejtë e fjalës. Brenda traditave islame, disa lloj shprehjesh a temash, konsiderohen mjaft problematike. Në këtë këndvështrim, është vetëm e mira e përbashkët e cila përbën hapësirën e pranueshmërisë së shprehjes së lirë. Caqet e kësaj hapësire,

përveç të tjerash, rrjedhin nga dispozitat etike siç janë nxitja e dhembshurisë dhe respektimi ndaj të drejtave të të tjerëve.

Kufizimet ligjore mbi lirinë e fjalës përfshijnë shpifjen, përhapjen e qëllimshme të fjalëve të rreme dhe fyerjen, dhe kundërvajtet penale dënohen me ligj. Një tjetër kufizim mbi lirinë e fjalës vjen nëse ligjërimi konsiderohet se përbën një sulm përbuzës dhe armiqësor ndaj personit, për shkak të bindjeve fetare. Nxitja e urrejtjes që kërcënon sigurinë shoqërore, fetare dhe etnike është e dënueshme dhe konsiderohet një vepër penale.

Kufizimet kryesore morale për lirinë e fjalës përfshijnë gënjeshtren, shpifjen, fyerjen dhe prëdorimin e gjuhës urrejtëse. Ekziston një kod i përgjithshëm moral në Islam që shkurajon përhapjen e të metave dhe të fshehtave personale të të tjerëve. Ekziston gjithashtu një kufizim i përgjithshëm moral që Islami vendos mbi qëllimet keqdashëse që synojnë përbuzjen dhe poshtërimin e qëllimshëm të të tjerëve (المِرَاة el-mira’).

Qëndrimi i Islamit për nevojën e kufizimeve në lirinë e shprehjes është diçka që është e përbashkët me konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Liria e shprehjes në ligjin islam ka për qëllim kryesor identifikimin e së vërtetës dhe ruajtjen e dinjitetit njerëzor. Nën mantelin e lirisë së shprehjes,

nuk lejohet as përhapja e një gjuhe të pahijshme e as asaj e thashethemeve.⁷

Pra, sipas Islamit, liria e shprehjes nuk është absolute, por është e kufizuar në shprehjen dhe fjalën e duhur. Brenda traditës islame, disa lloje të të shprehurit dhe të folurit konsiderohen mjaft problematike. Kriteri i mirëqenies së shoqërisë është ai që përcakton kryesisht kufijtë e pranueshmërisë të fjalës së lirë. Përveç faktorëve të tjerë, këta kufij burojnë nga mësimet etike të tilla si nxitja e dhembshurisë dhe respekti për të drejtat e të tjerëve.

Në këtë kontekst, ekzistojnë dy kategori kufizimesh që ia caktojnë vijën e kuqe lirisë së fjalës. Ato janë morale dhe ligjore. Kufizimet morale nuk sjellin ndonjë pasojë ligjore dhe i përgjigjen sferës private. Në anën tjetër, kufizimet që janë juridikisht të rëndësishme në ligjin islam, janë shpifjet publike, ligjërimet urrejtëse, gënjeshttrat, fyerjet, përbuzjet, sjelljet e pamoralshme etj.

Nderi dhe dinjiteti njerëzor

Si bartës të vlerave shpirtërore dhe morale, çdo njeri ka një sedër të brendshme për vetveten dhe një ndjenjë nderimi të jashtëm, përkatësisht një ndjenjë respekti e vlerësimi si pjesëtar i një shoqërie. Baza thelbësore e nderit të brendshëm dhe thelbi i sedrës vetjake është dinjiteti personal, të cilin Zoti ia

ka falur në mënyrë të pashmangshme çdo njeriu që nga lindja. Kjo ndjenjë e brendshme nderimi nxit pretendimim ligjor të çdo qenieje njerëzore se as nderi i tyre i brendshëm dhe as respektimi i tyre i mirë i jashtëm nuk mund të përbuzen, përçmohen apo të shpërfillen plotësisht, madje të vlerësohet njësoj sipas nderit të tyre të brendshëm.

Edhe nëse një veprim apo sjellje e pahijshme mund të jetë plotësisht e vërtetë, megjithatë nuk do të lejohej të flitej publikisht për të, pasi zbulimi apo zbërthimi i mëkatit do të nënkuptonte poshtërim dhe një siklet të madh për mëkatarin. Shfaqja publike e mëkateve përbën një rrezik të madh që mund të privojë keqbërësin nga ndjenjat e keqardhjes si dhe nga mundësia e të kërkuarit falje prej Allahut, që të pastrojë shpirtin e tij nga mëkati. Nuk është poshtërimi por frika nga poshtërimi, një prej pengesave, që e largon njeriun nga bërja e mëkatit. Megjithatë, kur keqbërësi mëson se tashmë një mori njerëzish i kanë zbuluar mëkatin, ndjenjat e turpit dhe të keqardhjes i bëhen gjithnjë më të dobëta dhe në këtë shkallë, ai mund të gjejë guximin të mëkatojë hapur.

Islami dhe ligjërimi i sjelljes së pahijshme në publik

Një nga ajetet më të rëndësishme të Kuranit që përcakton rregullat e diskursit publik, fatkeqësisht keqkuptohet dhe

keqinterpretohet nga shumë njerëz. Aty thuhet,

لَا يُحِبُّ اللَّهُ الْجَهْرَ بِالسُّوءِ مِنَ الْقَوْلِ إِلَّا مَنْ ظَلَمَ⁵

Allahu nuk do që të thuhet hapur e keqja, përjashtimi bën për atë, të cilit i është bërë mizori.⁸

Nga ajeti i sipërm, mund të arrijmë në përfundimin se çdo shprehje publike e një veprimi apo të një sjellje të pahijshme, të pamoralshme dhe të turpshme është e ndaluar sipas ligjit islam. Ndalimi i shpallur në këtë ajet përfshin, për shembull, të gjitha veprimet e turpshme të shprehura me fjalë ose me shkrim, fajësimi ndaj të tjerëve për sjellje të pahijshme, rrëfimin e veprimeve të turpshme nga personi që i ka kryer etj. Në këtë mënyrë, çdo fjalë e keqe dhe lënduese është e ndaluar të shprehet publikisht, edhe nëse përmban të vërtetën ose ka një qëllim gjoja të mirë.

Përjashtimi i vetëm nga ky rregull i përmendur më lartë është për atë të cilit i është bërë padrejtësi. Atij i jepet pak më shumë liri dhe për të kërkuar drejtësinë, ai mund të flasë me autoritetet publike. Ajeti është shumë i qartë se përjashtimi për përmendjen publike të sjelljes apo veprimit të pahijshëm vlen vetëm për atë i cili është drejtpërdrejt viktimë e kësaj padrejtësie. Nëse personat nga pala e tretë, të cilëve nuk u është bërë padrejtësi drejtpërdrejt, të cilët nuk janë

as viktimat e as nuk kanë të drejtë të flasin si përfaqësues ligjor të atyre që kanë deklaruar veten si viktimat, të cilët flasin publikisht në emër të tyre për motivet e interesat personale dhe shpërndajnë publikisht akuzat nga personat e njohur apo anonimë, kjo sjellje i kundërvihet qartësisht përjashtimit që përmban ajeti..

Kjo do të thotë që njeriu, të cilit i është bërë padrejtësi, patjetër duhet të ngrejë zërin kundër padrejtësisë, por kjo duhet bërë vetëm përpara forumit apo platmormës së duhur. Historia e e hershme e Islamit tregon se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe pasardhësit e tij të drejtë (Kalifët) kërkuar dëshmitarë dhe çdo provë që paditësi mund të siguronte, duke lehtësuar kështu vendosjen e drejtësisë në çdo çështje. Këto raste shqyrtoheshin përpara forumeve të posaçme.

Në këtë ajet, ndalimi i përhapjes së akuzave ndaj të tjerëve nënkupton një domosdoshmëri për të pasur një dallim të qartë midis atyre që preken drejtpërdrejt nga akuzat dhe atyre që nuk preken prej tyre. Një liri e pakufizuar do të çonte në mënyrë të pashmangshme në shpërbërjen e shoqërisë, pasi çdo njeri mund të ngrinte çfarëdo akuze kundër çdokujt, dhe do të përhapeshin shpifjet gjithandej, duke rrezikuar shkatërrimin e jetës dhe pozitës së individëve potencialisht të pafajshëm. Për këtë arsye, ligji hyjnor i Islamit

i lejon vetëm ata, të cilët besojnë se u është bërë padrejtësi, për të ngritur zërin për padrejtësinë që u është bërë. Më pas kjo akuzë dhe padi hetohet nga organet përkatëse të drejtësisë për të përcaktuar përfundimisht të vërtetën.

Duke folur për lirinë, një cilësi e Zotit që theksohet veçanërisht në teologjinë islame është atributi i Tij si çlirimtar. Ky atribut i Allahut sjell emancipimin, çlirimin dhe zhvillimin duke rrënuar strukturat armiqësore që i kundërvihen jetës njerëzore. Në këtë aspekt, Zoti nuk përshkruhet gjithmonë si pajtues dhe i durueshëm. Në rastin tonë, Ai u mohon atyre dashurinë dhe mëshirën e Tij që flasin publikisht për veprime të pahijshme. Qëllimi është transformimi i atyre njerëzve, jetesa e të cilëve dëmton të tjerët dhe krijesën e Zotit në tërësi.

Në këtë pikë, Zoti kërkon transformimin e njerëzve dhe Ai nuk është i gatshëm të lërë botën në këtë gjendje mjerane. Prandaj, Ai u bën thirrje njerëzve për të marrë një vendim. Ai i fton ata që t'i nënshtrohen Atij (të pranojnë "Islamin" i cili nënkupton dorëzimin para Allahut), të jenë besimtarë (prej atyre që i dorëzohen plotësisht Atij) dhe të përpiqen të zbatojnë vullnetin e Tij në këtë jetë.

Sfera private dhe publike

Një nga klasifikimet dhe ndarjet e

shumta për përshkrimin e saktë të jetës tokësore është dallimi midis private dhe publike. Kjo ndarje mbështetet dhe merret parasysh edhe në kontekstin e fesë islame, pasi rastësitë dhe hamendësimet rreth saj gjenden thellë në gjendjen psikologjike të njeriut dhe janë të rëndësishme për vetë formimin e tyre.

Fakti pse asnjë qenie njerëzore nuk mund të zbulojë apo të hyjë në mendimin e të tjerëve, tregon se asnjë nga veprimet e njeriut, që ai i kryen në sferën e jetës private nuk duhet t'i ngjallë kërsheeri apo interes dikujt tjetër, madje ndërhyrja në të duhet të jetë e dënueshme. Kjo është arsyeja pse legjislatura islame nuk ka asnjë kompetencë ligjore, për të rregulluar çështjet që zhvillohen në jetën private. Megjithatë, sa më e sigurt dhe e pakontrolluar të jetë hapësira private, aq më e kontrolluar do të jetë hapësira publike.

Një studim i hollësishëm i jurisprudencës islame tregon se nuk ka asnjë dënim tokësor për marrëdhënie jashtëmartesore ose paramartesore që ndodhin në sferën private. Ajo që dënohet sipas Kuranit Famëllartë është marrëdhënia seksuale e paligjshme që bëhet në atë mënyrë publike që katër dëshmitarë të drejtë dhe të patëmetë të kenë vëzhguar aktin e penetrimit me sytë e tyre.

Pra, për të krijuar një baraspeshë të

qëndrueshme, sa më e sigurt dhe e pakontrolluar të jetë hapësira private, aq më e kontrolluar do të jetë hapësira publike.

Pandehja e pafajësisë

Ashtu siç ndodh në të gjitha sistemet kushtetuese të cilat ndjekin sundimin e ligjit, pandehja e pafajësisë vlen edhe në jurisprudencën islame.

Në Kuran thuhet:

وَمَنْ يَكْسِبْ إِثْمًا فَإِنَّمَا يَكْسِبُهُ عَلَى نَفْسِهِ ۚ وَكَانَ اللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿٥٠﴾
يَكْسِبْ خَطِيئَةً أَوْ إِثْمًا ثُمَّ يَرْمِ بِهِ بَرِيئًا فَقَدِ احْتَمَلَ بُهْتَانًا وَإِثْمًا مُّبِينًا ﴿٥١﴾

Kushdo që bën mëkat, e bën kundër vetes së tij. Allahu është i Gjithëdijsëm, i Urtë. Kushdo që bën gabim ose mëkat, pastaj atë ia vesh një të pafajshmi, mori mbi vete një shpifje dhe mëkat të hapur.⁹

I Dërguari i Allahut ka thënë:

النَّبِيُّ عَلَى الْمُدَّعَى، وَالْبَرِيءُ عَلَى الْمُدَّعَى عَلَيْهِ

“Barra e provës bie mbi paditësin (akuzuesin) dhe detyra e atij i cili e mohon akuzën është të bëjë betimin”.¹⁰

Përhapja e paturpësisë (fevahish)

Një aspekt tjetër i sjelljes së pahijshme, për të cilën është e ndaluar të flitet në publik, është ajo që Kurani e quan paturpësi (الْفَاحِشَةُ fahisheh). Tani, çfarë përfshin përhapja e paturpësisë? Kjo porosi nuk u referohet vetëm atyre

që shfaqin e nxisin haptazi sjellje të turpshme, të pahijshme e të ulëta, por gjithashtu, edhe atyre që përdorin një sërë mjetesesh për të bërë të duket se komuniteti i besimtarëve është zhytur në të këqijat morale e shoqërore.

I Dërguari i Allahut ka thënë:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ " إِذَا قَالَ الرَّجُلُ هَٰذَا النَّاسُ . فَهُوَ أَهْلُكُهُمْ "

“Nëse dikush thotë se njerëzit janë shkatërruar, atëherë është vetë ai, ai që i ka shkatërruar ata.” Kjo tregon që nëse dikush i dënon publikisht dhe në faqe të tjerëve abuzimet morale në shoqëri, veprimi i tij konsiderohet i barabartë me kryerjen e atyre abuzimeve.¹¹

Kurani Famëlartë thotë:

إِنَّ الَّذِينَ يُجْبُونَ أَنْ يُشِيعَ الْفَاحِشَةُ فِي الَّذِينَ آمَنُوا لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ ۚ وَاللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ ﴿٥٢﴾

Njëmend, ata të cilët duan që imoraliteti të përhapet mes njerëzve që besuan, do të kenë ndëshkim të dhimbshëm në këtë botë dhe në ahiret. Allahu di dhe ju nuk dini.¹²

Nëse shqyrtohet në tërësi konteksti i gjerë tekstual nga i cili është shkëputur ky ajet, bëhet e qartë se çështja specifike këtu u referohet atyre personave të cilët akuzat për sjellje të pahijshme seksuale nuk i trajtojnë me fshehtësinë e duhur, përkundrazi ata i bëjnë ato publike.

Është për t'u habitur se ajeti në fjalë e barazon përhapjen e thashethemeve apo të akuzave për sjellje të pahijshme, të turpshme dhe keqbërje me vetë përhapjen e asaj sjelljeje imorale, të pahijshme dhe të turpshme në shoqëri.

Kur këto thashetheme apo shpifje dëgjohen nga një njeri normal, ai ndikohet akoma më shumë dhe kështu ngjallen dyshime dhe paragjykime (*sū'adh-Dhan*) ndaj shoqërisë, si dhe ndaj meritave dhe vlerave që ajo përfaqëson.

Shëmbëlltyra e njerëzimit sipas Islamit

Shëmbëlltyra e njerëzimit, si tërësia e ideve, perceptimeve dhe përshtypjeve rreth asaj që e mishëron, gjendet shpesh në forma mjaft divergjente nëpër fe, filozofi, botëkuptime dhe ideologji të ndryshme. Këto imazhe përfshijnë përfytyrimet e botës dhe ato të individit, dhe ofrojnë orientimin ekzistencial dhe moral. Në botën post-moderne, ne përballemi me furnizim të pakufishëm dhe një derdhje të tepruar e dërmuese të koncepteve të jetës, të cilat kërkojnë me ngulm përligjjen dhe vlefshmërinë e tyre, ose thënë ndryshe ato kërkojnë një fuqi për të ndërtuar dhe përcaktuar formën e ekzistencës.

Sipas Kuranit Famëlartë, imazhi mbi të cilin Zoti ka krijuar njerëzimin, në thelb është brumosur me mirësi, por si rrjedhojë e ndikimit nga faktorët e

jashtëm njeriu në momentin e zgjedhjes së brendshme mund të anohet edhe nga e keqja.

Megjithatë, mund të vërehet se prirja njerëzore për të konsideruar të mirën si të mirëqenë në përgjithësi e degradon atë në një gjendje normale. Në përballje me këtë gjendje normale, e keqja bie qartë në sy.

Prandaj, nëse e keqja lejohet të dominojë diskursin publik dhe të shpërndahet gjerësisht, vetëdija njerëzore fillon të gjykojë se në të vërtetë njerëzimi është degjeneruar tërësisht dhe përfaqëson vetëm të keqen. Nga ana tjetër kjo për rrjedhim do të sjellë një efekt të dëmshëm, pra konceptet morale do të vihen në dyshim, dhe si pasojë e një hamendësimi të cunguar e të verbër, shoqëria do të nxjerrë një përfundim të gabuar se të qenit keq është vetë në thelbin e natyrës së njeriut. Sipas këtij perceptimi të metë, meqenëse ka gjasa që të gjithë njerëzit janë të këqij, prandaj nuk ka asgjë anormale, nëse ata i bashkohen të keqes në një botë të ligë. Sigurisht, një përfytyrim i tillë është plotësisht i gabuar.

Kur mëkatet dhe shkeljet morale përmenden në mënyrë të përsëritur në mbledhje a tubime etj., frika e kryerjes së mëkateve dalëngadalë fillon të zbehet nga zemrat e njerëzve. Në fillim, njerëzit më lehtë i shprehin dhe

rrëfejnë mëkatin dhe sjelljet e pahijshme nëpër gojë dhe gradualisht kur mëkatet nuk konsiderohen më si një temë tabu, ata nuk ndiejnë asnjë pengesë edhe në kryerjen e tyre. Kjo është skema e thjeshtë e përhapjes së mëkateve në shoqëri.

Kjo është arsyeja përse duhet të përkrahim e të mbështesim konceptin e Islamit se në thelb njeriu nga natyra është i mirë dhe çdo dobësi që e çon atë në sjellje të turpshme dhe vulgare, nuk duhet lejuar të zërë hapësirë publike. Nëse nga dobësia e karakterit, njeriu i ka ndonjë padrejtësi dikujt, viktima gëzon të drejtën të trokasë në protën e duhur dhe të ngrejë zërin kundër keqbërësit. Nuk duhet të harrojmë se Islami synon të reformojë individët, të cilët kanë shkelur kodin e moralit dhe jo t'i lërë ata të mbeten përgjithmonë në gjendjen e tyre mjerane.

Islami nuk lejon që imoraliteti, sjellja e paturpshme dhe vulgariteti të pëshpëriten si thashetheme e të përhapen gojë pas goje, por të kallëzohen në forumet përkatëse që janë ngritur posaçërisht për kësioj çështjesh. Nëse pas shqyrtimit të akuzave, i pandehuri del fajtor për padrejtësi, Islami urdhëron që ai të ndëshkohet publikisht. Në këtë mënyrë, nëse Islami ua ruan nderin të gjithëve, ai gjithashtu ua siguron drejtësinë të gjithëve.

Përfundim: Paralajmërimet e të Dërguarit të Allahut S.a.V.S.

I Dërguari i Allahut S.a.V.S. ka thënë:

عَنْ سَالِمِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ، قَالَ سَمِعْتُ أَبَا هُرَيْرَةَ، يَقُولُ سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ "كُلُّ أُمَّتِي مُعَاذِي إِلَّا الْمُجَاهِرِينَ، وَإِنَّ مِنْ الْمَجَانَةِ أَنْ يَفْعَلَ الرَّجُلُ بِاللَّيْلِ عَمَلًا، ثُمَّ يُضَيِّحُ وَقَدْ سَرَّهُ اللَّهُ، فَيَقُولُ يَا فَلَانُ عَمِلْتُ الْبَارِحَةَ كَذَا وَكَذَا، وَقَدْ بَاتَ يَسْتُرُهُ رَبُّهُ وَيُضَيِّحُ يَكْشِفُ سِرَّهُ اللَّهُ عَنْهُ."

"Secili nga umeti im do të falet, përveç atyre që bëjnë mëkate haptazi ose ua zbulojnë njerëzve. Shembulli i rrëfimit të mëkatit në publik është si ai njeri i cili ka kryer një vepër të keqe gjatë natës dhe Allahu e mban të fshehur nga njerëzit. Por, ai vjen në mëngjes dhe thotë: 'O filan njeri! Mbrëmë kam kryer këtë e atë (mëkat)'. Zoti i tij e kishte fshehur atë gjatë natës, por në mëngjes, ai e largon perden e Allahut nga vetja".¹³

Ai gjithashtu ka thënë:

عَنْ ابْنِ شِهَابٍ، أَنَّ سَالِمًا، أَخْبَرَهُ أَنَّ عَبْدَ اللَّهِ بْنَ عَمْرٍو - رَضِيَ اللَّهُ عَنْهَا - أَخْبَرَهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ "الْمُسْلِمُ أَخُو الْمُسْلِمِ، لَا يَظْلِمُهُ وَلَا يُظْلَمُهُ، وَمَنْ كَانَ فِي حَاجَةِ أَخِيهِ كَانَ اللَّهُ فِي حَاجَتِهِ، وَمَنْ فَرَّجَ عَنْ مُسْلِمٍ كُرْبَةً فَرَّجَ اللَّهُ عَنْهُ كُرْبَةً مِنْ كُرْبَاتٍ يَوْمَ الْقِيَامَةِ، وَمَنْ سَتَرَ مُسْلِمًا سَتَرَهُ اللَّهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ."

"Muslimani është vëllai i muslimanit, ai nuk duhet t'i bëjë padrejtësi dhe as nuk duhet ta dorëzojë atë te zullumqari. Ai që ia plotëson nevojat vëllait të tij, Allahu vetë ia plotëson nevojat atij. Ai që shpëton muslimanin nga brenga, Allahu do ta shpëtojë atë nga mundimet e Kiametit. Ai që ia mbulon të metat

muslimanit, Allahu do t'ia mbulojë të metat në Ditën e Kiametit".¹⁴

Unë në fund, citoj edhe një thënie të të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.}. Ai ka thënë:

عَنْ نَافِعٍ، عَنِ ابْنِ مَحْمُودٍ، قَالَ صَعِدَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ الْمِنْبَرَ فَنَادَى بِصَوْتٍ رَفِيعٍ فَقَالَ " يَا مَعْشَرَ مَنْ قَدْ أَسْلَمَ بِلِسَانِهِ وَلَمْ يَنْفِضِ الْإِيمَانَ إِلَى قَلْبِهِ لَا تُؤْذُوا الْمُسْلِمِينَ وَلَا تَعَيِّرُوهُمْ وَلَا تَتَّبِعُوا عَوْرَاتِهِمْ فَإِنَّهُ مَنْ تَتَّبَعَ عَوْرَةَ أَخِيهِ الْمُسْلِمِ تَتَّبَعَ اللَّهُ عَوْرَتَهُ وَمَنْ تَتَّبَعَ اللَّهُ عَوْرَتَهُ يَفْضَحْهُ وَلَوْ فِي جُوفِ رَحْلِهِ "

“O ju që e keni pranuar Islamin me gojë, besimi akoma nuk ju ka hyrë deri në zemër! Mos i u sillni keq muslimanëve! Mos i shani ata, as mos i përgjoni për të zbuluar të metat e tyre të fshehta! Me të vërtetë, kushdo që përpiket t’i zbulojë të fshehtat e vëllait të tij musliman, Allahu do t’i zbulojë të fshehtat e tij, edhe nëse ai do të ishte në brendësi të shtëpisë së tij”.¹⁵

SHËNIME:

[1]. Socioseksualiteti, i quajtur ndonjëherë orientim socioseksual, është ndryshimi individual në gatishmërinë për t’u përfshirë në aktivitet seksual jashtë një marrëdhënieje të përkushtuar. Simpson, J. A.; Gangestad, S.W. (1991). “*Individual differences in sociosexuality: Evidence for convergent and discriminant validity*”. Journal of Personality and Social Psychology. 60 (6): 870–883. doi:10.1037/0022-3514.60.6.870.

[2]. Kurani Famëllartë 6:60.

[3]. Kurani Famëllartë 56:79.

[4]. Hedonizmi është ndjekja e kënaqësisë e cila

është në vetvete një qëllim i vërtetë dhe qëllimi i të gjitha aktiviteteve.

[5]. Kurani Famëllartë 17:33.

[6]. Kurani Famëllartë 6:152.

[7]. “Njëmend, ata të cilët duan që imoraliteti të përhapet mes njerëzve që besuan, do të kenë ndëshkim të dhimbshëm në këtë botë dhe në ahiret. Allahu di dhe ju nuk dini.” Kurani Famëllartë 24:20.

[8]. Kurani Famëllartë 4:149.

[9]. Kurani Famëllartë 4:112-113

[10]. *es-Sunen el-Kubra lil-Bejheki*, Kitab: ed-Da’ve vel-Bejjinat, Bab el-Bejjineh ‘alal-Mud-de’i vel-Jemin ‘alal Mud-da’a ‘alejh.

[11]. *Sahih Muslim*, Kitab el-Birr ves-silah vel-Adab, Bab: en-Nahju ‘an Kaul, heleken-nasu, hadith numër: 2623a.

[12]. Kurani Famëllartë 24:20.

[13]. *Sahih el-Buhari*, Kitab: el-Edeb, Bab: Setrul Mu’mini ala nefsih, hadith numër 6069.

[14]. *Sahih el-Buhari*, Kitab el-Mezalim, Bab: La jezlimul Muslimul-muslime vela jeslimuhu, hadith numër 2442.

[15]. *Xhami’ et-Tirmidhi*, Kitab: el-Birr ves-sile, Bab: Ma xha-a fi Ta’dhimil-mu’mini, hadith numër 2032.

ÇFARË THOTË LIGJI I ISLAMIT PËR PËRDHUNIMIN?



Mësimet e Islamit përcaktojnë se shteti mban përgjegjësi për mbrojtjen e interesave (مَصَالِح *masālīh*) dhe të drejtave (حُوق *Hukūk*) të qytetarëve. Përmes mbrojtjes së këtyre interesave dhe të drejtave të çdo individi, Islami vendos bazat e një shoqërie paqësore. Të gjitha shkollat e jurisprudencës islame, duke u bazuar në Kuranin Famëllartë, pajtohen në pesë llojet kryesore të interesave njerëzore (*maslehatul beshr*) të cilat duhet të mbrohen nga shteti:

1. Feja (*dīn*) 2. Jeta (*nefs*) 3. Intelekti (*ʿAql*) 4. Pasardhësit (*nasl*) 5. Prona (*māl*)

Nëse cenohet njëra prej këtyre elementeve, rrezikohet siguria dhe mirëqenia e individit, dhe kjo gjendje nxit pështjellim dhe çrregullim në shoqërinë në përgjithësi. Nëse dikush vepron kundër këtyre interesave dhe shpallet fajtor nga një gjykatë, atëherë ligji i shtetit do t'i japë një dënim.

Qëllimet e këtyre masave ndëshkimore e disiplinore në Islam janë: vendosja e drejtësisë, reformimi i shkelësve dhe paralajmërim për anëtarët e tjerë të shoqërisë.

Përkufizimi i krimit në Islam dhe një shënim i shkurtër mbi masat disiplinore në islam

Islami e përkufizon krimin kështu: çdo veprim apo akt përmes të cilit i shkaktohet dëm një individi në mënyrë fizike apo mendore, në të cilin dëmi përfshin dhunën fizike, lëndimin trupor, sulmin ndaj nderit dhe vdekjen.¹

Sipas ligjit islam, ndëshkimet ndaj krimeve ndahen kryesisht në tri lloje:

1. dënimi ligjor (*Hadd*),
2. dënimi hakmarrës (*Kisās*) dhe
3. dënimi diskrecional (*ta'zīr*).

Meqenëse ky shkrim synon veçanërisht të përqendrohet në këndvështrimin islam për përcaktimin e elementeve të krimit të përdhunimit, ne do të përmendim vetëm përkufizimin e *Haddit* dhe *ta'zīrit*. Nuk kemi nevojë pse të diskutojmë *Kisās*in, pasi ai nuk është një dënim që Islami e përshkruan për krime si përdhunim.

***Hudūd* (dënime shprehimsht të përcaktuara)**

Në ligjin islam, *Haddi* i referohet dënimit që është përcaktuar nga Allahu i Plotfuqishëm ose suneti me siguri. Pasi të përligjet një *Hadd* përmes metodës së përcaktuar, gjykata, shteti ose pala e dëmtuar nuk lejohen të bëjnë asnjë lëshim në zbatimin e këtyre dënimeve.

Sipas shumicës së studiuesve të së drejtës islame (*fuqahā*), në Islam janë shtatë *Hudūd*,² megjithatë, sipas Imam Ebu Hanifes, pesë krimet e mëposhtme i nënshtrohen dënimit të hadit:

1. Vjedhja (*seriqa*)
2. Kurvëria/tradhtia bashkëshortore (*zinā*)
3. Konsumimi i alkoolit (*shurb*)
4. Të dehurit (*sukr*)
5. Shpifje (*Qadhf*) veçanërisht në rastin e abuzimit seksual ose tradhtisë bashkëshortore.³

Le të theksohet se *hudūd* janë dënimet

më të rrepta që përcaktojnë Kurani e Suneti, dhe sa herë ata përshkruajnë këto dënime, japin edhe udhëzime të qarta në lidhje me metodën e hetimit, dëshmitarët, provat dhe të dhënat etj. për vërtetimin e krimit. Një *kādi* ose gjykatës duhet të ndjekë me përpikëri udhëzimet e përshkruara dhe nëse provat nuk përputhen me standardin e kërkuar, nuk mund të jepet dënimi *hadd*.

Megjithatë, kjo metodë nuk e privon kurrë viktimën e një krimi nga drejtësia e vërtetë. Pra nëse fajësia e të pandehurit vërtetohet me provat, të cilat janë të ndryshme nga provat që janë si parakusht i domosdoshëm për shqiptimin e dënimit maskimal *hadd*, atij prapëseprapë mund të jepet një dënim *ta'zīr*.

Ta'zīr

Dënimi i *ta'zīrit* dallohet dukshëm nga dënimet e tjera *hadd* dhe *kisās*, pasi ai përcaktohet nga gjykata. Përpos kësaj, faktorët që e bëjnë krimin të dënueshëm me masat *hadd* janë përshkruar në mënyrë të prerë e të përpiktë nga Kurani dhe suneti, ndërsa një krim që dënohet me masat e *ta'zīrit* mund të vërtetohet në bazë të çdo lloj prove të besueshme që paraqitet përpara trupit gjykues. Në këtë rast, gjykata gëzon kompetencën dhe autoritetin e plotë, për të përcaktuar dhe për të dhënë dënimin e *ta'zīrit*. Kështu, krimet të cilat nuk u përgjigjen plotësisht kritereve të *hudūdīt*, edhe pse

provat që ekzistojnë vërtetojnë fajësinë e të pandehurit, mund të gjykohen dhe dënimi i tyre mund të jepet me anë të metodës së *ta'zīrit*.

Pas kësaj hyrjeje të shkurtër të llojeve të ndryshme të dënimeve në Islam, ne tani i hedhim një vështrim qëndrimit të Islamit mbi *zinā* الزنى (shkelje kurore) dhe *ightisāb* الاغتصاب (përdhunim).

Përcaktimi i zinasë dhe ightisābit (përdhunimit)

Të gjitha shkollat e jurisprudencës islame pajtohen gjerësisht se zinaja është marrëdhënia seksuale e paligjshme dhe konsensuale e ndërsjellë midis një burri që është i vetëdijshëm dhe që ka arritur moshën e pubertetit (*bulgh*) dhe një gruaje që nuk është bashkëshortja e tij ligjore.⁴

Sipas këtij përkufizimi të zinasë, shkollat e jurisprudencës islame Mālikī, Shāfi'i dhe Hanbalī e përkufizojnë përdhunimin si kryerja e detyruar a këtij akti si tradhti bashkëshortore ose përdhunim të detyruar.

Sipas jurisprudencës Henefi, *ightisāb* ose përdhunimi përkufizohet si akt i në të cilën detyrohet një grua për të kryer marrëdhëniet seksuale të paligjshme (jashtë lidhjes martesore) kundër vullnetit të saj. Ky term gjithashtu përfshin përcaktimin nëse paditësi e ka nxitur ose jo të pandehurin për të kryer këtë veprim.

Në këtë mënyrë, ligji islamik e përkufizon aktin e përdhunimit kështu:

“Kryerja e marrëdhënies seksuale të paligjshme me dhunë nga një burrë me një grua që nuk është bashkëshortja e tij e ligjshme, kundër vullnetit të saj të lirë”.⁵

Ndëshkimi i përdhunimit (*ightisāb*) në Islam

Ndonëse, në jurisprudencën islame, termi “marrëdhënie seksuale e detyruar” (*zinā bil-xhebr*) përdoret gjithashtu për aktin e përdhunimit, shumica e juristëve arabë përdorin termin *ightisāb*, që do të thotë çnderimi me dhunë i një vajze apo një gruaje.

Sa i përket dispozitës së sheriatit për këtë krim të shëmtuar, shumica e juristëve janë të mendimit se në thelb ajo është e njëjtë si për përdhumin ose për tradhtinë bashkëshortore. Nëse personi është beqar, ai dënohet me 100 rrahje me kamxhik dhe dënohet me gurëzim, nëse është i martuar.

Disa dijetarë si Imam Maliku ^{r.a.} dhe Imam Ebu Henifa ^{r.a.} kanë sugjeruar se autorit të krimit gjithashtu do t'i kërkohej t'i paguajë një *mehr* (para për prikë) për viktimën.⁶

Disa dijetarë kanë shkruar se nëse viktima e përdhunimit ishte rrëmbyer me dhunë nga shtëpia e saj ose nga ndonjë vend tjetër përveç shtëpisë së saj dhe më pas ishte përdhunuar nën

kërcënimin e armës, një veprim i tillë do të përligjte dhënien e dënimit më të ashpër *hadd* që është dënimi “*Muharabe*”. Allahu thotë:

إِنَّمَا جَزَاءُ الَّذِينَ يُحَارِبُونَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَسْعَوْنَ فِي الْأَرْضِ فَسَادًا أَنْ يُقَتَّلُوا أَوْ يُصَلَّبُوا أَوْ تُقَطَّعَ أَيْدِيهِمْ وَأَرْجُلُهُمْ مِنْ خِلَافٍ أَوْ يُنْفَوْا مِنَ الْأَرْضِ

“Dënimi i atyre që luftojnë kundër Allahut dhe të dërguarit të Tij dhe orvaten për të bërë trazirë në tokë është të vriten keqas, ose të kryqëzohen ose t'u priten duart dhe këmbët të anëve të ndryshme ose të dëbohen nga vendi. I tillë është poshtërimi i tyre në këtë botë dhe në ahiret dhe ata kanë një ndëshkim të madh.”⁷

Një diskutim i detajuar i pëqendruar vetëm mbi dënimin e përdhunimit në Islam kërkon një trajtim më të hollësishëm, gjë që nuk është qëllimi i këtij shkrimi. Në fokus të këtij shkrimi mbetet metoda që ndiqet për të përcaktuar krimin e përdhunimit në dritën e mësimave të Islamit.

Përcaktimi i krimit të përdhunimit

Një parim bazë që gjendet si në jurisprudencën islame ashtu edhe në ligjet e vendit, është se duhet t'i kushtohet vëmendje e duhur mbrojtjes së njerëzve të pafajshëm nga pretendimet e rreme. Kjo do të thotë se paditë dhe akuzat nuk mund të konsiderohen të pranueshme derisa nuk ka prova të vlefshme dhe se i akuzuari do të trajtohet si i pafajshëm, veçse t'i provohet fajësia. Ky parim është sinonim me thënien e mëposhtme të

Profetit të Shenjtë:

عَنْ ابْنِ عَبَّاسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: «لَوْ يَغْطِي النَّاسُ بِدَعْوَاهُمْ لَادَّعَى رَجُلٌ أَمْوَالَ قَوْمٍ وَدِمَاءَهُمْ، لَكِنَّ الْبَيِّنَةَ عَلَى الْمُدَّعِي، وَالْبَيِّنَ عَلَى مَنْ أَنْكَرَ»

“Po t’u jepej njerëzve gjithçka që pretendonin, disa do të pretendonin (padrejtësisht) pasurinë dhe jetën e të tjerëve. Barra e provës bie mbi paditësin, ndërsa ai që e mohon (akuzën) duhet të betohet”.⁸

Në dritën e udhëzimeve të dhëna në këtë hadith, një shpifje serioze e përdhunimit ose sulmit seksual do të jetë e pranueshme vetëm nëse vërtetohet përmes provave që nuk mund të mohohen. Sipas studiuesve të jurisprudencës islame, një pretendim për përdhunim mund të vërtetohet në tre mënyra:

1. Vërtetimi i përdhunimit në mënyrën më përfundimtare

Ligji tradicional i islamit e përkufizon *ightisābin* (përdhunimin) si një formë shtrënguese e të dhunshme të zinasë (shkelja e kurores) dhe pothuajse të gjithë studiuesit e jurisprudencës islame pajtohen se për të vërtetuar akuzën e përdhunimit në mënyrën më të sigurtë, mund të prëdoren këto dy metoda:

1. Përmes dëshmisë së katër dëshmitarëve, i cili është një kufi i përcaktuar në Kuranin Famëlartë për përcaktimin e zinasë
2. Nëpërmjet pranimit të fajit nga autori

Sipas fukahave, nëse akuza e përdhunimit vërtetohet me këtë nivel sigurie, autorët e krimit do ngarkohen me dënim e *haddit*, i cili përbën dënimin më të rreptë të përcaktuar nga Islami.

Dijetari i famshëm i shekullit 11, Imam Ibn Abd al-Barr-i ka përmendur për një *ixhma*’ (marrëveshje unanime të dijetarëve) për këtë çështje dhe thotë:

وقد أجمع العلماء على أن على المستكره المصيب الحد إن شهدت البينة عليه بما يوجب الحد، أو أقر بذلك، فإن لم يكن: فعليه العقوبة

“Dijetarët janë në pajtim të plotë se përdhunuesi duhet t’i nënshtrohet dënimit *hadd* nëse kundër tij ka *bejjineh* bينة (katër dëshmitarë), dhe kjo që do të përligjë dhënien e dënimit *hadd*. [Vendosja e dënimit *hadd* do të zbatohej gjithashtu] nëse përdhunuesi i akuzuar e pranon vetë autorësinë e krimit të tij. Në një situatë në të cilën nuk përmbushet asnjëra nga këto dy kushtet, personi do t’i nënshtrohet ‘*akubes*’ (d.m.th. dënimit *ta’zir*) [në përputhje me provat e tjera që mund të sillen kundër tij].”⁹

Këtu, Imam Ibn Abd al-Barri ka bërë një dallim të qartë midis asaj që ngarkon të akuzuarin me dënimin të përcaktuar me ligjin islam (*hadd*) dhe asaj që përligj shqiptimin e një dënimi diskrecional.

Ai përmend shprehimisht se nëse katër dëshmitarë japin dëshmi kundër autorit, apo nëse personi i akuzuar vetë e pranon autorësinë e krimit, atij do t’i jepet dënimi *hadd*. Nëse këto dy kushte nuk

plotësohen, atëherë persosnit të paditur mund t'i shqiptohet lloji i dytë i dënimit në bazë të diskrecionit të gjykatës ose gjyqtarit. Kjo e fundit nuk është e përkufizuar në ligjin islam; madje ajo përcaktohet sipas provave rrethanore që mund të paraqiten kundër të pandehurit. Qëllimi është të vendoset drejtësia dhe të parandalohet përsëritja e rasteve të ngjashme në të ardhmen.

Duke u bazuar në urdhëresën Kuranore, në thelb të gjithë juristët pajtohen se meqë *zinaja* (shkelja kurore) kryhet në mënyrë konsensuale nga të dyja palët, andaj kërkon kushtin më të rreptë, të paraqitjes së katër dëshmitarëve. Ndërsa në rastin e *ightisāb*-it, ku akti ushtrohet me dhunë ndaj viktimës kundër dëshirës së saj, ekziston një mosmarrëveshje në mendimin e juristëve. Krahas disa shkollave të cilat vazhdojnë të këmbëngulin kërkesën e vetme të dëshmisë së katër dëshmitarëve, edhe në rastin e përdhunimit, shumica e juristëve janë të mendimit që nëse katër dëshmitarë nuk mund të paraqiten si provë parësore, mund të shqyrtohen të gjitha rrugët e tjera të hetimit të përhkruara më sipër.

2. Vërtetimi i përdhunimit nëse viktimë mbetet shtatzënë

Në ligjin islam, nëse një grua mbetet shtatzënë jashtë lidhjes martesore, ajo do t'i nënshtrohet ndjekjes penale për tradhti bashkëshortore dhe do

t'i shqiptohet dënimi për krimin e provuar. Megjithatë, nëse një grua e tillë mohon kryerjen e shkeljes së kurorës dhe pretendon se ajo është përdhunuar, ekziston një mosmarrëveshje midis juristëve muslimanë nëse pretendimi i saj do të hetohet apo do të pranohet pa hetim.

Shumica e juristëve të shkollave henefi, shāfi'i dhe hanbali sugjerojnë se justifikimi i një gruaje të tillë pranohet pa hetim dhe ajo nuk ndiqet penalisht apo dënohet. Megjithatë, Imam Malik ^{r.a.}, juristi më i hershëm musliman, jep pikëpamjet e tij të prera mbi këtë çështje dhe shprehet se justifikimi i një gruaje të tillë do të pranohet vetëm nëse ajo paraqet prova bindëse që mbështesin pretendimin e saj. Një provë e tillë e përdhunimit mund të jetë gjakderdhja e shkaktuar nga akti nëse ajo ishte e virgjër. Po ashtu si provë do të konsiderohet edhe thirrja e saj për ndihmë, dhe nëse dëshmitarët gjithashtu e kanë gjetur në një gjendje që vërteton torturën e saj. Nëse ajo nuk paraqet prova të tilla rrethanore, i nënshtrohet dënimit të parashikuar dhe pretendimet e saj nuk do të merren në konsideratë.¹¹

Kjo tregon se edhe në rastet kur nuk është ngritur padi ndaj asnjë personi për përdhunim, dhe pafajësia apo fajësia e personit është vënë në pikëpyetje, Islami ndjek një metodë rigorozë për të verifikuar pretendime të tilla. Kjo tregon

qartazi se çfarë vëmendje e rëndësie Islami i kushton hetimit të krimit.

3. Konstatimi i përdhunimit nëpërmjet formave të tjera të provave

Tani do të shqyrtojmë pyetjen nëse Islami a lejon pranimin e provave të tjera përveç dëshmitarëve apo jo. Kundërshtarët e Islamit pretendojnë se nëse një viktimë e përdhunimit nuk është në gjendje të sjellë katër dëshmitarë për të mbështetur pretendimin e saj, ajo i nënshtrohet dënimit të rreptë të *haddit* për shpifje (*kadhif*).

Një ngjarje mjaft interesante lidhur me këtë çështje mund të gjendet në historinë e Islamit, të transmetuar nga Imam Ibn Kajim el-Xheuzije në librin e tij *Et-Turuk-ul-Hukmijah*.

Gjatë kalifatit të Hazret Omer ^{r.a.} ibn el-Hattabit, një grua u dashurua me një djalosh nga Medina. Por, megjithë këmbënguljen e saj ajo nuk e bëri dot për vete dhe djaloshi nuk tërhiqet pas joshjeve të saj për të krijuar lidhje.

Pas refuzimit të djaloshit, në dëshpërim e sipër, grua ja leu të bardhën e vezës në rrobat dhe kofshët e saj dhe pastaj shkoi te Hazret Omeri ^{r.a.}. Ajo iu ankua se gjoja djaloshi e kishte përdhunuar, duke i treguar njollat në rrobat e saj si dëshmi kundër tij.

Hazret Omeri ^{r.a.} e referoi atë tek disa gra për t'i shqyrtuar "të ashtuquajturat" provat e saj. Gratë arritën në përfundimin

se njollat u ngjanin se ishin nga sperma. Atëherë, Hazret Omeri deshi t'i shqiptonte atij dënimin, por djaloshi e mohoi kategorikisht këtë akuzë dhe iu lut Hazret Omerit që ta hetonte edhe njëherë këtë çështje dhe të shqyrtonte autencitetin e provave të gruas.

Hazret Omer ^{r.a.} më pas i bëri thirrje Hazret Aliut ^{r.a.} që ta ndihmonte në hetimin e mëtejshëm të pretendimeve. Hazret Aliu ^{r.a.} kontrolloi imtësisht rrobat e saj dhe derdhi ujë të nxehtë mbi njollat. Kjo provë hodhi dyshime mbi pretendimin e gruas, pasi rezultati ishte shumë i ngjashëm me atë të të bardhës së vezës.

Thuhet se Hazret Aliu ^{r.a.} kishte shkuar deri në atë masë që të provonte shijen e substancës, përpara se të konfirmonte se ishte e bardha e vezës që grua ja kishte përdorur si provë për të mbështetur pretendimin se ishte përdhunuar. Pas kësaj, Hazreti Aliu ^{r.a.} i foli rreptësisht dhe e kërkoi të thoshte të vërtetën, dhe kështu në fund ajo rrëfeu gjithçka.¹²

Në historinë islame, Atharët (thëniet, veprimet dhe pëlqimi i sahabëve të Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}) ndihmojnë lexuesin të nxjerrë këto përfundime të rëndësishme:

1. Së pari, në mungesë të katër dëshmitarëve, Hazret Omeri ^{r.a.} dhe Hazret Aliu ^{r.a.} shqyrtuan provat që ishin paraqitur nga pala paditëse. Metodologjia e ndjekur dëshmon qartë

që ndonëse rrëfimi i dëshmitarëve okularë konsiderohet prova kryesore për të vërtetuar fajësinë apo pafajësinë e dikujt, mungesa e llojeve themelore të dëshmive nuk pengon hetimin e mëtejshëm të një krimi të rëndë si përdhunimi; e as gruaja nuk i nënshtrohet *haddit* nëse ajo nuk është në gjendje të paraqesë dëshmitarë për mbështetjen e padisë së saj.

2. Së dyti, Hazret Omeri ^{r.a.}, pasi i kishte parë provat e paraqitura, nuk i dha asaj ndonjë dënim të përcaktuar në ligjin islam (*hadd*); përkundrazi, për shkak të mungesës së katër dëshmitarëve në këtë rast, u ndoq metoda e *ta'zīrit*, e cila, siç është përshkruar më lart, është një dënim diskrecional që vjen pas dënimit *hadd* dhe është më i rreptë në islam.

3. Së treti, ne mund të konstatojmë rëndësinë e të shqyrtuarit të autenticitetit të provave në hollësi të skajshme. Në rastet kur ngrihen disa akuza të rënda e të ndyra, duhet të ekzistojnë mekaniza të fuqishëm që mbrojnë njerëzit e pafajshëm nga shpifjet si përdhunimi.

Shënim i rëndësishëm

Diskutimi i mësipërm është një debat teorik i bazuar në jurisprudencën islame dhe nuk shërben si udhëzim për askënd për të zgjidhur çështjet e shkeljeve të tilla të urryera në mënyra jashtëgjyqësore. Xhemati Musliman Ahmedia beson fuqishëm se çështje të tilla penale duhet të ndiqen përmes ligjit të vendit.

SHËNIME:

1. Imam Shafi'i, *el-Umm*, vëll 6; Ibn Rushd, *Bidajet el-Muxbtehid*, vëll 2; Imam Ibn Tejmije, *es-Sijaset esh-Sheri'ah*.
2. Prof dr. Wahbah az-Zuhaily, *El-Fik'h el-Islami wa-'Adilatuhu*.
3. Si më lartë.
4. 'Ala'ed-Din Ebu al-Kasani, *Bada'i al-Sana'i*, vëll. 7, Dar el-Kutub el-Arabi, Bejrut, 1982.
5. Përkufizime të tilla pranohen përgjithësisht në vendet islame, p.sh. në Pakistan, seksioni 6 i *Zbatimit të Urdhërësës së Hududit* (VII, 1979) e përcakton përdhunimin në vija të ngjashme.
6. *El-Muveta*, 4/1063; *El-Muntaka Sherh el-Muveta*, 5/269
7. *Kurani Famëllartë* 5:34
8. Imam en-Nevevi, *Dyzet hadithet e Neveviut*, f. 52, hadith nr. 33, Imam el-Bejhaki, *Sahih el-Bejhakiu*, vëll. 10, f. 252.
9. *El Istidkar* 146/7, *Bidaje el-Muxbtehid* 221/4.
10. Ahmed Raza Khan Bareilvi në *Fatawa al-Radhwiyah*, vëll. 13, f. 613, Fetva nr. 252, Kitab al-Hudood uet-T'azir; www.islamweb.net, kërkimi "*Fetva nr. 70220*", "Vërtetimi i përdhunimit me mjete moderne mjekësore", publikuar më 1 maj 2017, vizituar më 9 janar 2022),
11. *El-Muveta*, 5/1208.
12. *El-Turuk-ul-Hukmijeh fis-Sijaset esh-Sheri'ah*, FasI: Fi suvari lil-hukam bil-firasah, f. 70.

📖 Marrë nga gazeta javore Al-Hakam,

www.alhakam.org/rape-in-islam/

URDHRI PËR NDALIMIN E PIRJES SË ALKOOLIT DHE NDIKIMI I TIJ I JASHTËZAKONSHËM

Në kohën midis betejës së Uhudit dhe asaj që po vinte më pas, bota dëshmoi një shembull që ilustron shumë qartë se sa thellë Islami kishte sjellë ndikim te ndjekësit e tij. E kemi fjalën për urdhrin e ndalimit të pirjes së alkoolit. Në faqet e para, duke treguar gjendjen e arabëve para Islamit, kemi treguar që arabët ishin tepër alkoolistë. Në çdo familje të famshme, pesë herë pihej alkooli dhe se ata nuk turpëroheshin fare kur deheshin, ngaqë kjo ishte diçka e zakonshme për ta. Madje, këtë gjendje e konsideronin të virtytshme. Kur u vinte ndonjë mik, e zonja e shtëpisë e kishte për detyrë t'i shërbente me alkool. Padyshim, nuk ishte e lehtë t'ua heqje këtë ves, njerëzve të tillë.

Por, në vitin e katërt pas mërgimit, Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.} i zbriti urdhri që pirja e alkoolit të ndalohej. Menjëherë pas shpalljes së kësaj porositë, muslimanët hoqën dorë tërësisht nga alkooli. Siç rrëfëhet në hadithe, kur zbriti ky urdhër, Profeti ^{s.a.v.s.} thirri një sahab dhe e porositi që ta njoftonte këtë kumt nëpër rrugicat e Medinës.

Gjatë asaj kohe, në shtëpinë e një ensari, pra të një muslimani të Medinës, po pihej alkooli. Shumë njerëz ishin ftuar tek ai dhe po kthenin gotë pas gote. Ishte zbrazur një shtambë e madhe dhe do të hapej një tjetër. Njerëzit ishin të dehur dhe shumë të tjerë afër dehjes. Në këtë gjendje, ata dëgjuan lajmëtarin, i cili thoshte se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.}, sipas urdhrin të Zotit, e ndaloi pirjen e alkoolit. Njëri u ngrit dhe tha se po dëgjonte diçka rreth ndalimit të alkoolit. U ngrit tjetri, i cili e theu shtambën e alkoolit me shkopin e tij duke thënë:

“Ta zbatojmë urdhrin një herë, pastaj të sqarohemi. Nuk duhet të vazhdojmë me pirjen e të merremi me hulumtime. Neve na mjafton që kemi dëgjuar urdhrin. Detyra jonë është që ta derdhim alkoolin përjashta e pastaj të hetojmë njoftimin”. (Buhariu, Kitabut-tefsir, tefsir suretil-Maidah, bab keuluhu “Inemel khemru”)

Muslimani kishte të drejtë, sepse nëse ndalimi i pirjes së alkoolit ishte shpallur dhe ata do të vazhdonin ta pinin, atëherë do të bënë gjynah. Por edhe nëse ndalimi nuk ishte shpallur, derdhja e alkoolit nuk sillte ndonjë dëm të madh që nuk mund të përballohej. Pas këtij njoftimi, muslimanët hoqën dorë krejtësisht nga pirja e alkoolit.

Pra, nuk u nevojiti ndonjë përpjekje e sensibilizim i veçantë për të sjellë këtë revolucion madhor. Muslimanët që dëgjuan këtë urdhër dhe dëshmuar zbatimin e tij të menjëhershëm, jetuan deri në shtatëdhjetë apo tetëdhjetë vjet më vonë dhe asnjë prej tyre as edhe një herë nuk e shkeli këtë urdhër. Nëse ndodhi ndonjë abuzim tek-tuk, ndodhi vetëm me atë njeri, i cili nuk kishte përfutur drejtpërdrejt nga shoqëria e Profetit ^{s.a.v.s.}.

Kur e analizojmë këtë me lëvizjen amerikane për moslejimin e pirjes së alkoolit dhe kur shohim përpjekjet që janë bërë për ta sjellë në jetë këtë rregull, ose ato përpjekje që janë bërë edhe në Evropë për vite me radhë, na del në pah se tek muslimanët vetëm një urdhër i Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.} ishte i mjaftueshëm për ta larguar këtë ves shoqëror.

Kurse në Amerikë dhe në Europë, sado që u vendosën ligje, u përpoqën bashkërisht trupat policore a ushtarake, inspektorët e tjerë të tatimeve apo ndonjë tjetër, nuk e arritën. Ata e pranuan disfatën e tyre. Pirja e alkoolit fitoi para përpjekjeve të tyre. Edhe pse kjo koha jonë quhet koha e zhvillimit, kur e krahasojmë me atë të fillimit të Islamit, befasonemi dhe përballemi me një pyetje: Vallë cila nga dy kohërat është më e zhvilluar, e jona apo ajo e Islamit që shkaktoi një revolucion kaq të madh shoqëror?

(Marrë nga “Jeta e Muhammedit ^{s.a.v.s.}”, e shkruar në vitin 1948)

SHTATË NIVELET E PËRSOSJES SË NAMAZIT



الم ﴿ ذَٰلِكَ الْكِتَابُ لَا رَيْبَ ۚ فِيهِ ۚ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ ۖ الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِالْغَيْبِ
وَيُقِيمُونَ الصَّلَاةَ ۖ وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ ۖ
وَالَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْكَ وَمَا أُنزِلَ مِن قَبْلِكَ ۖ وَبِالْآخِرَةِ هُمْ يُوقِنُونَ ۖ
أُولَٰئِكَ عَلَىٰ هُدًى مِّن رَّبِّهِمْ ۚ وَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ۖ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit. Alif.Lam.Mim. (اَلَا اللّٰهُ اَعْلَمُ). Unë jam Allahu, më i Dijshmi) Ky është Libri. Nuk ka mëdyshje në të. Është udhëzim për të druajturit, që besojnë në të padukshmen, falin namazin dhe shpenzojnë nga çdo gjë që Ne u kemi dhënë; që besojnë në atë që të është shpallur ty dhe në atë që është shpallur para teje dhe, që edhe ahiretin e besojnë bindshëm. Pikërisht këta janë në udhëzim prej Zotit të tyre dhe pikërisht këta janë të suksesshmit.¹

Në këto ajete janë përmendur tiparet e besimtarit dhe një prej tyre është që ata falin namazin.

Çfarë është namazi në të vërtetë?

Namazi është forma më e përsosur dhe më madhështore e shprehjes së dashurisë së rob-it ndaj Krijuesit. Përmes namazit, robi synon të ndërtojë një lidhje të sinqertë e të fortë me Krijuesin. Përmes tij, ai synon të bashkëbisedojë me Të dhe t'i shprehë mirënjohje dhe falënderime.

Në hadith përmendet që:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، أَنَّهُ سَمِعَ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ "أَرَأَيْتُمْ لَوْ أَنَّ
بَنِي إِسْرَءِيلَ أَتَوْا أَحَدَكُمْ، يَسْأَلُهُمْ فِيهِ كُلَّ يَوْمٍ مِائَةً، مَا تَقُولُ ذَلِكَ يُنْفِقِي مِنْ ذَرَنِهِ
". قَالُوا لَا يُنْفِقِي مِنْ ذَرَنِهِ شَيْئًا. قَالَ "فَذَلِكَ مِثْلُ الصَّلَاةِ الْخَمْسِ، يَمْحُو
اللَّهُ بِهَا خَطَايَا".

Hazret Ebu Hurejra ^{r.a.} tregon: "E kam

dëgjuar të Dërguarin e Allahut ^{s.a.v.s.} të thotë: "Shikoni, sikur një lumë të rridhte përpara derës së njërit prej jush dhe ai të lahej në të çdo ditë pesë herë. Si thoni, a do t'i mbetet atij diçka nga papastërtia?" I thanë (të pranishmit): "Nuk do të mbetej asnjë gjurmë papastërtie në të." Ai tha: "Ky është shembulli i pesë namazeve me të cilat Allahu i fshin gabimet dhe gjynahet (e robërve të Tij)".²

Në një hadith gjejmë këtë porosi:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِنَّ أَوَّلَ مَا يُحَاسَبُ
بِهِ الْعَبْدُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ مِنْ عَمَلِهِ صَلَاتُهُ فَإِنْ صَلَحَتْ فَقَدْ أَفْلَحَ وَأَنْجَحَ وَإِنْ
فَسَدَتْ فَقَدْ خَابَ وَخَسِرَ فَإِنْ انْتَقَصَ مِنْ فَرِيضَتِهِ شَيْءٌ قَالَ الرَّبُّ عَزَّ وَجَلَّ
اانْظُرُوا هَلْ لِعَبْدِي مِنْ تَطَوُّعٍ فَيُكَمَّلَ بِهَا مَا انْتَقَصَ مِنَ الْفَرِيضَةِ ثُمَّ يَكُونُ
سَائِرُ عَمَلِهِ عَلَىٰ ذَلِكَ

Hazret Ebu Hurejra ^{r.a.} transmeton se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë: "E para (vepër) për të cilën do t'i kërkohet llogari njeriut në Ditën e Gjykimit është namazi i tij. Në qoftë se namazi është i rregullt, atëherë ka shpëtuar njeriu dhe ka arritur suksesin, por në qoftë se i mungojnë namazet, atëherë ka dështuar ai dhe ka përfunduar në humbje. Nëse ka mangësi në namazet e tij të obliguara, Zoti i Madhërishtëm thotë "Shikoni, nëse robi Im ka falur namaze nafle (vullnetare), me të cilat mund të plotësohet mangësia e namazeve të obliguara". Pastaj, do të gjykohej në gjitha veprat e tij, në këtë mënyrë.³

Cila është shkalla e përcaktimit të namazit?

Cilat janë ato kushte apo kritere në bazë të të cilave, njeriu mund të kuptojë

se a janë të vlefshme e të pranueshme namazet e tij apo jo. Këtë na ka treguar Allahu në Kuranin Famëlartë. Ai thotë:

أَتْلُ مَا أُوحِيَ إِلَيْكَ مِنَ الْكِتَابِ وَأَقِمِ الصَّلَاةَ ۚ إِنَّ الصَّلَاةَ تَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنكَرِ ۗ وَالذِّكْرُ لِلَّهِ أَكْبَرُ ۗ وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا تَصْنَعُونَ ﴿٥٠﴾

Lexo atë që të është zbritur ty prej Librit (Kuranit) dhe fale namazin! Me të vërtetë, namazi e ruan (njeriun) nga paturpshmëria dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që të kujtuarit e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që veproni ju.⁴

Pra, ky është kriteri për të mësuar se a me të vërtetë namazi ynë është i pranueshëm në prapësinë e Allahut. Nëse ne falemë rregullisht, por prapëseprapë dorëzohemi para tundimeve të nefsit apo nuk ndalojmë dot veten nga veprat e papëlqyera, atëherë ky është sinjali i qartë që adhurimi ynë nuk është në shkallën e duhur. Ne duhet të përqendrohemi më shumë në namaz dhe duhet të lutemi me më shumë përgjërëm e sinqeritet.

Shtatë nivelet e përsosjes së namazit

Hazret Kalifi i dytë i Mesihut të Premtuar ^{r.a.} ka përshkruar në mënyrë shumë të bukur dhe të përmbledhur që si mund të quajmë namazin tonë të plotë. Kjo është një mënyrë mjaft e thjeshtë dhe praktike. Ai e ka krahasuar namazin me një shkallë që ka shtatë nivele.

1. Niveli i parë është që besimtari të

kryejë rregullisht të gjitha namazet e detyrueshme dhe të mos e lë asnjë namaz pa falur. Ky është kuptimi i vërtetë i fjalëve وَيَتِمُّونَ الصَّلَاةَ se ata e falin namazin rregullisht e pandërprerë.

2. Pasi që ka arritur nivelin e parë, ai ngjitet në **shkallën e dytë**, e cila është që besimtari të falë namazin me përpikëri në kohën e caktuar. Allahu gjithashtu ka thënë në Kuranin Famëlartë:

إِنَّ الصَّلَاةَ كَانَتْ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ كِتَابًا مَوْفُوتًا ﴿٥١﴾

Sigurisht, namazi u është obliguar besimtarëve në kohë të caktuar.⁵

3. Pasi që arrin këto nivele, besimtari hedh hapin për t'u ngjitur në **nivelin e tretë**, në të cilin ai duhet të falë namazin me xhemat. Në këtë pikë, ai nuk e fal namazin vetëm, por bashkë me besimtarët e tjerë, siç tregon porosia e Kuranit وَيَتِمُّونَ الصَّلَاةَ se ata e falin namazin me xhemat. Ky është gjithashtu një ndër qëllimet e namazit dhe në këtë nivel besimtari nuk e fal namazin e detyrueshëm me xhemat vetëm në situata të jashtëzakonshme dhe gjithmonë mundohet të falë namazin me xhemat.

4. Niveli i katërt i kësaj shkalle është që njeriu i cili tashmë ka nisur të falë namazin me xhemat, tani duhet të mësojë gjithashtu kuptimin a përkthimin e namazit. Kur njeriu di kuptimin e namazit, ai reflekton dhe pasqyron mbi fjalët e namazit, dhe mendon thellë mbi

fjalët që shqipton.

5. Në **nivelin e pestë**, njeriu arrin njëlloj përqendrimi në namaz. Tashmë gjatë namazit, ai zhytet plotësisht në kujtimin e Zotit dhe shkëputet nga bota e jashtme. I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} në hadithin e tij të famshëm ka përshkruar këtë gjendje me këto fjalë:

“أَنْ تَعْبُدَ اللَّهَ كَأَنَّكَ تَرَاهُ، فَإِنْ لَمْ تَكُنْ تَرَاهُ فَإِنَّهُ يَرَاكَ”

Të adhurosh Allahun sikur ti e sheh Atë, e nëse nuk (ke arritur këtë nivel) që ta shikosh Atë, bëj sikur Ai të shikon ty”.⁶

Në këtë nivel përfundon përshkrimi i namazeve të detyrueshme, pasi ato akoma nuk janë të mjaftueshme për të ndërtuar një lidhje të tillë besnikërie me Allahun, e cila mund të përmbushë qëllimin e jetës së njeriut dhe që e bën faqebardhë para Zotit.

6. Në **nivelin e gjashtë**, njeriu i thotë vetes: Nuk më mjaftojnë vetëm pesë namaze në ditë. Unë nuk kënaqem duke u takuar me të Dashurin tim vetëm pesë herë në ditë dhe nuk ngopem duke harxhuar kaq pak kohë në praninë e Tij. Unë dua ta takoj Atë më shpesh. E kështu, ai fillon të falë nafilet (namaze vullnetare) për të shpenzuar më shumë kohë në praninë e Zotit të tij të dashur.

7. **Niveli i fundit** i kësaj shkalle është falja e namazit të tehexhudit. Ky namaz falet në pjesën e fundit të natës, para kohës

së agimit dhe namazit të sabahut. Kur bota është zhytur në errësirën e natës e të gjumit dhe kur atë nuk e sheh askush, ai çohet nga dëshira për të kujtuar Zotin. Në këtë mënyrë ai arrin majën e shkallës së afërsisë me Zotin e Lartësuar.

Këto janë shtatë nivele të shkallës së namazit. Derisa besimtari nuk është ngjitur në këtë shkallë dhe nuk ka arritur majën e saj, ai nuk mund të thotë se meqë kam falur namazet e detyrueshme dhe derisa kam përmbushur detyrën time, kam arritur kënaqësinë e Zotit.

Allahu na mundësoftë të falim namazet tona me vetëdijë të plotë dhe ta arrijmë atë nivel përqendrimi dhe devotshmërie, të cilin Ai pret prej nesh! Allahu na mundësoftë ta krijojmë një lidhje të singertë me Zotin tonë dhe të mbulojmë qenien tonë me dashurinë e Tij gjithëpërfshirëse! Amin.

SHËNIME:

[1] *Kurani Famëllartë* 2:2:6.

[2] *Sabihu i Buhariut*, Libri koha e faljes së namazeve, hadith numër: 528.

[3] *Sunen Tirmidbi*, Libri i namazet, hadith numër: 413.

[4] *Kurani Famëllartë* 29:46.

[5] *Kurani Famëllartë* 4:104.

[6] *Sabihu i Buhariut*, Libri i besimit, hadith numër: 50.



13 metoda për t'u zgjuar për namazin e tehexhudit

Një mënyrë, të cilën personalisht e konsideroj të padobishme, është përdorimi i ziles. Kjo krijon njëfarë varësi te njeriu dhe dështon t'i forcojë vullnetin e palëkundur. Nëse njeriu bie në gjumë, duke pasur vendosmëri për t'u zgjuar për tehexhud, ai sikur ka kaluar gjithë natën në adhurimin e Zotit. Ndërsa, ai që varet nga zilja dhe i mungon vullneti për t'u zgjuar, shpesh do të mbyllë zilen dhe do të bjerë prapë në gjumë. Edhe kur zgjohet, përgjumet në namaz. Një varësi e tillë i privon ata nga zgjimi dhe vëmendshmëria e plotë. Megjithatë, përdorimi i ziles mund të jetë i dobishëm në gjendjen fillestare ose për ndonjë nevojë specifike.

Janë trembëdhjetë metoda, që mund të përdoren për t'u zgjuar herët, dhe çdokush që i provon sinqerisht, në dashtë Allahu, do të fitojë dobi prej tyre. Ndonëse në fillim, ato mund të duken të mundimshme, por në fund do të rezultojnë të suksesshme. Unë kam qëmtuar këto metoda nga Kurani Famëllartë dhe hadithet, dhe i jam mirënjohës Zotit që më zbuloi këto pika që deri tani ishin të fshehura nga të

tjerët. Për të qenë sa më konciz, unë do të ndaj vetëm përfundimet, pa u ndalur te citatet a burimet.

1. Sipas ligjit të natyrës çdo gjëje që i krijohen kushtet e njëjta, kthehet në gjendjen e saj të zanafillës. Shpeshherë, njeriu përjeton të njëjtën sëmundje, që ai ka patur në fëmijëri, madje ky parim përfshin edhe botën shtazore e botanike. Ky rregull mund të shërbejë për të ngulitur vetinë e të zgjuarit herët natën. Bëni pak dhikr pas namazeve të jasisë. Sa më shumë dhikr të bëjë njeriu, aq më herët do të zgjohet ai në mëngjes.

2. Mos bisedoni me dikë pas namazit të jasisë. Ndonëse i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ndonjëherë vijonte bisedën edhe pas jasisë, por në përgjithësi ai e ka ndaluar atë. Ka dy arsye pas kësaj porosie: (a) Nëse bëni muhabet në atë kohë, ju do të bini vonë në gjumë dhe rrjedhimisht nuk mund të zgjoheni herët në mëngjes. (b) Nëse tema e bisedës nuk është shpirtërore, atëherë njeriu do të zgjohet po me ato mendime. Sigurisht, nuk është e ndaluar të kryejmë obligimet tona të rëndësishme pas jasisë,

megjithatë është më mirë të kalojmë pak kohë në dhikr, para se të flemë.

3. Para se të shkojë në shtrat, njeriu duhet të marrë abdes të ri, edhe nëse ka qenë me abdes. Ky veprim ndikon në gjendjen e tij shpirtërore dhe ia ngjall njëlloj freskie. Nëse njeriu bie në gjumë në këtë gjendje freskie, ai gjithashtu do të zgjohet me të njëjtën ndjesie. Kjo është një dukuri e përgjithshme. Nëse dikush bie në gjumë në gjendje gëzimi, ai zgjohet me buzë në gaz, ndërsa ai që qan para gjumit, ngrihet i pikëlluar. Prandaj, me abdes do të ndieni freski, edhe kur bini për të fjetur si dhe kur zgjoheni. Kjo gjithashtu do t'ju ndihmojë për t'u zgjuar herët.

4. Para se të bjerë në gjumë, njeriu duhet të bëjë dhikr. Kjo praktikë do ta ndihmojë atë për t'u zgjuar herët për dhikr. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. çdo natë, para se të flinte, bënte këtë dhikr : së pari recitonte ajetin e Kursisë (2:256) dhe tri sure të fundit të Kuranit dhe pastaj frynte lehtë mbi duart dhe me to fërkonte trupin e tij tri herë. Pastaj shtrihej në krahun e djathtë dhe thoshte:

اللَّهُمَّ أَسْلَمْتُ وَحْيِي إِلَيْكَ، وَفَوَّضْتُ أَمْرِي إِلَيْكَ، وَأَلْبَسْتُ ظَهْرِي إِلَيْكَ،
رَغْبَةً وَرَهْبَةً إِلَيْكَ، لَا مَلْجَأَ وَلَا مُنْجَأَ مِنْكَ إِلَّا إِلَيْكَ، آمَنْتُ بِكِتَابِكَ الَّذِي
أَنْزَلْتَ، وَبِنَبِيِّكَ الَّذِي أَرْسَلْتَ.

All-llahumme eslemtu nefsi ilejke, ve vexhxhehtu vexhhi Ilejke, ve fevvedtu amri ilejke, ve elxhe'tu dhebri ilejke, regbeten ve rahbeten Ilejke la melxhe'e ve la menxh'e

minke il-la ilejke, amentu bi kitabik el-ledhi enzelte ve bi-nebijjikel-ledhi erselte.

O Allah! Ty ta dorëzova veten time. Nga Ti e drejtova fytyrën time. Te Ti e solla çështjen time. Te Ti u mbështeta duke shpresuar e duke u druajtur ndaj Teje. Nuk ka strehë dhe nuk ka shpëtim nga Ti përveç Teje. Besova në librin që ke zbritur dhe në profetin që ke dërguar.¹

Besimtarët duhet ta bëjnë këtë dhikr dhe pastaj vazhdojnë me ndonjë lutje tjetër derisa i zë gjumi. Një dhikr i rëndësishëm për këtë kohë është:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ، سُبْحَانَ اللَّهِ الْعَظِيمِ

Subhan-Allahi ve bi-Hamdihi, subhan-Allahil-Adhim

I shenjtë është Allahu me lavdinë e Tij. I Shenjtë është Allahu i Madhërishëm.

Gjendja në të cilën, njeriu shkon në gjumë, e shoqëron atë gjatë kohës që ai fle. Nëse dikush bie në gjumë duke bërë tespìh (madhërimin e Zotit) dhe Tahmid (lëvdimin e Zotit), një gjendje shpirtërore do ta rrethojë gjatë gjithë natës. Kjo dukuri vërehet veçanërisht te gratë dhe fëmijët, të cilët kanë pasur brengë dhe ndjenja trishtimi para gjumit, kur kthehen në krahun tjetër, rënkojnë me dhimbje. Ndërkohë, personi që bie në gjumë duke bërë tespìh, shpreh të njëjtat fjalë kur ndërron pozicion. Allahu ka thënë:

تَتَجَافَى جُنُوبُهُمْ عَنِ الْمَضَاجِعِ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ خَوْفًا وَطَمَعًا وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ

Ata i lënë shtretërit e tyre, lusin Zotin e tyre me frikë e shpresë dhe shpenzojnë nga ajo që Ne u kemi dhënë.²

Në shikim të përciptë, ky përshkrim nuk duket i besueshëm, sepse i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} bënte gjumë po ashtu dhe besimtarë të tjerë. Por në realitet gjumi i tyre është njëloj Teshpih, sepse ata bien në gjumë duke bërë teshpih andaj gjendja e tyre e fjetjes, konsiderohet lavdërimi i Zotit. Trupat u ndahen nga shtrati dhe ata përfshijnë veten në kujtimin e Zotit të tyre.

5. Para se të shkoni në gjumë, zotoni me vendosmëri se do të zgjoheni për Tehexhud. Zoti ia ka dhënë njeriut fuqinë për t'ia nënshtuar mendjen vullnetit të tij. Edhe filozofët e njohin këtë parim. Vendosni në mënyrë të prerë që do të ngriheni për tehexhud. Edhe pse trupi pushon, mendja nuk do të flejë, dhe do t'ju zgjojë pikërisht në kohën e caktuar.

6. Metoda e gjashtë u vlen vetëm atyre që janë të fortë në besim. Në vend që të falni namazin e Vitrit (namazi që falet me tri rekate dhe konsiderohet sunet i fortë) pas namazit të Jacisë, mund të lini vitrin për të falur në kohën e tehexhudit. Në përgjithësi, njerëzit falin namazet e detyruara me rregullsi, ndërsa tregojnë plogështi në namazet vullnetare. Namazi i Vitrit

është vaxhib, pra është një adhurim thelbësor, ndonëse jo i domosdoshëm si Farz, por më i rëndësishëm se Nafil. Kur nafilit (adhurimit vullnetar) i bashkëngjitet një vaxhib (adhurimit të detyrueshëm), kjo vetëm i shton më shumë fuqi vendosmërisë për të kryer të dyja adhurimet. Shpirti i besimtarit nuk qetësohet derisa e përmbush vaxhibin dhe në këtë mënyrë ai do të kryejë dhe namazet nafile. Ndërsa, ai që tashmë ka falur Vitrin pas namazit të jacisë, ndoshta nuk do të ngrihet për tehexhud, edhe pse të jetë i zgjuar. Ai do të ndihet shpirtërisht i qetë sepse ka përmbushur vaxhibin. Nëse vitri mbetet akoma i pakryer, shpirti gjithashtu mbetet i paqetë dhe e zgjon njeriun nga gjumi. Megjithatë, vetëm ata që janë të fortë në besim, duhet ta provojnë këtë metodë, ndryshe të dobëtit në këtë përpjekje mund të privojnë veten edhe falja e vitrit.

7. Metoda e shtatë gjithashtu vlen për ata njerëz, që gjenden në shkallë të lartë shpirtërore. Sipas kësaj, besimtari pas namazit të jacisë, duhet të falë nafilet, e t'i vazhdojë derisa bëhet i përgjumshëm dhe gjumi dhe e kaplon gjumi plotësisht. Edhe pse kjo metodë kërkon më shumë përpjekje, besimtari me doemos do të zgjohet në kohën e tehexhudit. Kjo metodë është njëloj ushtrim shpirtëror.

8. Metoda e tetë është praktikuar nga sufijtë. Ndonëse nuk kam ndier nevojë për ta provuar, ajo është e dobishme.

Nëse dikush ka gjumë të rëndë, i duhet të ndërrojë shtratin e butë, me një më të ashpër.

9. Hani darkë disa orë para se të flini. Hani para namazit të akshamit apo menjëherë pas tij. Nganjëherë, shpirti është i gjallë dhe i zellshëm, por trupi e topit dhe e plogështon atë. Trupi i ngjan zgjedhës, e nëse është i rëndë, e mbyt dhe shpirtin. Kur bie në shtrat, barku nuk duhet t'i jetë shumë i mbushur, sepse kjo ndikon keqas dhe i shkakton shpirtit gjendje plogështie e amullie.

10. Njeriu nuk duhet të shkojë për të fjetur, duke qenë i papastër (*xbunub*), sepse engjëjt janë një krijesa të dëlira, dhe ata u shmangen të papastërve. Njëherë, të Dërguarin e Allahut ^{s.a.v.s.} e qerasën me një ushqim, i cili kishte një erë të rëndë. Ai vetë nuk e pranoi atë, por i lejoi sahabët që ta hanë. Ai gjithashtu shpjegoi se engjëjt, që i zbresin rregullisht, nuk pëlqejnë erëra të tilla.

Engjëjt nuk e durojnë ndyrësinë. Njëherë Hazret Kalifi I ^{r.a.} shkoi në shtrat pa i larë duart pas darke. Ai pa në ëndërr se vëllai i tij i madh dëshiron t'i dhurojë Kuranin Famëllartë. Por, para se ta prekte me dorë, vëllai e tërhoqi Kuranin dhe tha "Mos e prek Kuranin, sepse ke duar të papastra".

Higjiena e jashtme ndikon në dëlirësinë e brendshme. Prandaj, engjëjt do të frymëzojnë të pastrit për t'u zgjuar,

ndërsa të papastërve nuk do t'u afrohen. Prandaj, ruani higjienën vetjake.

11. Shtrati gjithashtu duhet të jetë i pastër. Duke mos ditur se higjiena e shtratit lidhet ngushtë me gjendjen shpirtërore, shumëkush nuk i jep rëndësi kësaj pastërtie. Prandaj, duhet të tregoni vëmendje të veçantë në këtë aspekt.

12. Kjo metodë është e tillë, që nëse zbatohet nga njerëz të thjeshtë, mund të sjellë rezultate të papëlqyeshme, ndërsa njerëzit e veçantë nuk pësojnë asgjë të keqe. Sipas kësaj metode, çifti bashkëshortor nuk duhet të flejë në të njëjtin shtrat. Ndonëse i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ndante shtratin me gratë e tij, ai gjendej në shkallën më të lartë shpirtërore. Kjo gjë nuk e ndikonte aspak, ndërsa të tjerët duhet t'i shmangen kësaj gjëje. Sa më të fuqishme të jenë epsheet trupore, aq më shumë ato pengojnë shqisat shpirtërore. Kjo është arsyeja pse Islami na mëson:

كُلُوا وَاشْرَبُوا وَلَا تُسْرِفُوا إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُسْرِفِينَ

Hani e pini dhe mos e teproni.³

Përse Islami na ndalon nga shkelja e kufijve? Sepse kjo dëmton anën shpirtërore të njeriut. Ata që zotërojnë mirë veten e tyre, nuk pësojnë asnjë dëm duke fjetur bashkë, por njerëz të thjeshtë do të gjejnë se kjo vetëm ua zgjon ndjenjat joshëse. Kjo dëmton gjendjen e tyre shpirtërore dhe nuk i lë

të zgjohen për ibadet.

13. Metoda e fundit është me të vërtetë e shkëlqyer. Kjo jo vetëm që ndihmon njeriun për t'u zgjuar për tehexhud, por edhe e ruan nga mëkate dhe sjellje të dobëta. Sipas kësaj metode, para se të flejë, njeriu duhet të mendojë me vete se mos vallë ka ndjenja urrejtjeje, dashakeqësie, mllefi apo paragjykimi ndaj dikujt, dhe nëse po, atëherë duhet t'i flakë ato menjëherë nga mendja. Pastërtia që arrin shpirti në këtë mënyrë, e ndihmon njeriun për t'u zgjuar për tehexhud."

Në kohën e gjumit, zemra e njeriut duhet të jetë plotësisht e pastër. Por nëse dikush kujton se kësisoj ndjenjash janë të duhura për interesat e tij materiale, ai le t'i lejojë vetes emocione të tilla gjatë ditës, por nuk ka asnjë arsye për t'u pushtuar prej tyre gjatë natës. Se fundja fundit, ai nuk do të ndeshet me të në gjumë.

Kur njeriu i shkul kësisoj mendimesh nga mendja, në përgjithësi ato nuk shfaqen më. Por edhe nëse i dalin prapë, nuk do t'i sjellin ndonjë pasojë. Sa më gjatë dikush qëndron i lidhur ngushtë me dikë tjetër, aq më shumë ndikohet prej tij. Nëse fshini diçka me sfungjer, ai e thith lagështinë e bëhet i njomur. Por nëse sfungjeri thith ujin për një kohë të gjatë, ai bëhet qull. Mendimet që sorollaten në mendje dhe vërshojnë tërë

natën në shpirt, kanë fuqi të trazojnë zemrën.

Emocione të tilla nuk e ndikojnë mendjen aq shumë gjatë ditës sepse ajo është përfshirë në punë të ndryshme, por gjatë natës, ajo është plotësisht e lirë dhe pushtohet lehtësisht. Prandaj, hiqni çdolloj mendimesh negative kundër të tjerëve në kohën para gjumit, para se ato të lëshojnë rrënjë të thella dhe shkulla e tyre bëhet e pamundur. Po sikur ajo të ishte nata e fundit e jetës, ai do të humbte mundësinë për t'u penduar për mendime të errëta. Njeriu duhet të mposhtë nefsin, e nëse arrin të çlirojë mendjen nga kjo ndyrësi, ai do të fitojë shpëtim prej saj. Njeriu, kur pastron mendjen nga të menduarit negativ, ai gjithashtu fiton fuqi për t'u zgjuar për tehexhud.

SHËNIME:

[1]. *Sabih Buhariu*, numri i hadithit 6311.

[2]. *Kurani Famëlartë* 32:17

[3]. *Kurani Famëlartë* 7:32

**SPROVAT
NË JETËN E BESIMTARIT**

وَلْيَتْلُوْكُمْ بِشْيٍ مِّنَ الْخَوْفِ وَالْجُوعِ وَنَقْصِ مِّنَ الْأَمْوَالِ وَالْأَنْفُسِ وَالثَّمَرَاتِ ﴿١٠٠﴾
 وَيُنَبِّئُ الصَّابِرِينَ ﴿١٠١﴾ الَّذِينَ إِذَا أَصَابَتْهُمُ مُّصِيبَةٌ قَالُوا إِنَّا لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاغِبُونَ

Ne patjetër që do t'ju sprovovjmë, duke ju përballur me pak frikë, me pak uri, me pak humbje të pasurisë, të njerëzve e të vjelave. Jepu lajm të gëzueshëm durimtarëve. Të cilët kur i godet ndonjë fatkeqësi, thonë: “Sigurisht, jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi”.¹

Shumë njerëz në këtë botë nuk e kuptojnë Zotin dhe planet e Tij. Ata nuk i njohin atributet e Tij e as nuk kanë idenë se çfarë raporti ka Zoti me krijesat e Tij. Shumëkush ankohet se atyre nuk u përgjigjen lutjet ose shpreh pakënaqësinë pasi janë rrethuar me lloj-lloj sprovash dhe mjerimesh.

Jeta e kësaj bote është pasqyrimi i botës shpirtërore. Për të na aftësuar ta përfetojmë këtë botë shpirtërore, Zoti na ka lënë gjithashtu mjaft shenja dhe shembuj të mirëfilltë, të cilat na orientojnë të kuptojmë paqëndrueshmërinë e kësaj jete dhe përkohshmërinë e çdo gjendjeje gëzimi a hidhërimi. Ngjarjet që na ndodhin, na nxisin të jetojmë në atë mënyrë e cila përkon me thirrjen e Zotit dhe na bën t'i bindemi Atij ashtu siç Ai pret prej nesh.

Ajeti i sipërm tregon se Allahu sprovon njeriun për të nxjerrë në pah gjendjen e tij të brendshme me anë të mirësive dhe nganjëherë me anë të vështirësive. Sipas Kuranit Famëlartë, duke sprovuar robin Zoti në përgjithësi synon dy qëllime:

Ai e sprovon atë, i cili gjendet në një shkallë të lartë shpirtërore. Si shembull kemi rastin e Ibrahimit^{a.s.}.² Në këtë mënyrë, Ai e bën atë njeri të rrezatojë si një shembull mirësie, devotshmërie dhe pastërtie.

Ai gjithashtu sprovon atë njeri, i cili akoma nuk ka arritur një shkallë të lartë shpirtërore.³ Në këtë mënyrë Ai ia dëfton atij mangësitë dhe të metat, të cilat i duhet të ndreqë për të përparuar shpirtërisht. Ndonëse, sprovat dhe fatkeqësitë përmbajnë dhimbje dhe vuajtje të mëdha, ato gjithashtu i japin njeriut një mundësi të artë për t'u ngritur shpirtërisht dhe për të pastruar veten nga dobësitë e karakterit. Ato shërbejnë për të forcuar besimin dhe premtojnë shpërblime dhe dhunti të mëdha tek Allahu.

Në këtë ajet Allahu ka përmendur pesë mjete për ta realizuar këtë sprovë:

Frika: Në këtë gjendje shqetësimi a ankthi, frika e rrethon njeriun nga të

gjitha anët ndërsa armiku i kanoset me lloj-lloj rreziqesh dhe pasojash.

Uria: Në këtë gjendje të mungesës së ushqimit, armiku jo vetëm ia pret të gjitha lidhjet me botën e jashtme por e rrethon atë duke e izoluar plotësisht nga ushqimi apo mjetet e tjera.

Humbja e pasurisë dhe pronës

Humbja e njerëzve të dashur

Humbja e të vjelave: Kjo gjithashtu nënkupton dështimin e përpjekjes (mosarritja e frutit), humbjen e fitimit nga ndonjë burim apo shkatërrimin e tregtisë etj.

Në këtë ajet Allahu gjithashtu ka bërë të qartë që sjellja e Tij ndaj robit i ngjan raportit që ekziston midis dy shokëve. Derisa respektohen të drejtat e ndërsjella midis tyre, miqësia vijon të forcohet, por në momentin që njëri prej tyre i hap telashe dhe probleme si borxhe etj. shokut tjetër, miqësia prishet. Asnjë miqësi në këtë botë nuk mund të mbijetojë, nëse njëri prej tyre e ruan vetëm për shkak të interesave dhe fitimeve personale.

P.sh. kur ai është zhytur në borxh apo ka ndonjë hall tjetër, dhe shkon te shoku i vetë dhe i kërkon ndihmë. Por, sa çlirohet nga barra e borxhit apo i largohet halli, ai harron këtë mirësi dhe tregohet mosmirënjohës. Një miqësi

e tillë, nuk mund të quhet në asnjë mënyrë, një miqësi e sinqertë dhe e vërtetë. Miqësia e sinqertë bazohet në interesat reciproke, dhe një miqësi që synon të arrijë vetëm interesat e njërës palë, është destinuar të prishet. Zoti i Madhërisëm ka përshkruar sjelljen e Tij ndaj robit me shembullin e kësaj miqësie. Në njërën anë Ai u drejtohet robërve të Tij dhe thotë:

وَقَالَ رَبِّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ

Zoti juaj ka thënë: “Lutuni Mua, se do t’ju përgjigjem!”⁴

Pra Zoti ka përmbushur pjesën që i takonte Atij në këtë miqësi. Ai në njëfarë mënyrë i thotë robit: Shiko, unë jam kujdesur për ty, duke plotësuar nevojat e tua. Unë të kam mundësuar gjithçka që të nevojitej për të jetuar dhe njëkohësisht të kam mbështetur në çdo situatë. Tani, shprehu para Meje dhe tregomë hallin tënd dhe Unë do t’i përgjigjem lutjes. Por, Zoti gjithashtu manifeston dashurinë e Tij ndaj robit, e cila është më e fort se dashuria e nënës ndaj fëmijës së saj.

Ndonjëherë, për ta provuar dashurinë dhe besnikërinë e robit ndaj Tij, Zoti gjithashtu e sprovon atë me anë të vështirësive të ndryshme pasi ato janë të domosdoshme dhe të dobishme për robin e Tij. Para se të trajtohet një plagë apo t’i vihet balsami për të lehtësuar

dhimbjen, njeriu duhet të ndërmarrë një ndërhyrje kirurgjikale për të trajtuar plagën. Në të njëjtën mënyrë Zoti deklartoi që Unë sprovov robërit e Mi me këto vështirësi.

Njeriu është i prirë të sillet në përgjithësi me mosmirënjohje. Siç tregon ky ajet kuranor:

وَإِذَا أَعْمَنَّا عَلَى الْإِنْسَانِ أُعْرِضَ وَثَائِي بِجَانِبِهِ وَإِذَا مَسَّهُ الشَّرُّ كَانَ يَكُفِّرُ

Kur i japim një të mirë njeriut, ai largohet dhe e mban anën e tij dhe kur e prek e keqja, mbetet shumë i dëshpëruar.⁵

Kur gjithçka shkon mbarë me njeriun dhe ai gëzon shëndetin, harmoninë dhe mirësitë e Zotit, vjen koha që ai nuk merakoset më për Krijuesin e Tij. E tillë është natyra njerëzore, siç e ka përshkruar Allahu në një vend tjetër:

وَإِذَا أَعْمَنَّا عَلَى الْإِنْسَانِ أُعْرِضَ وَثَائِي بِجَانِبِهِ وَإِذَا مَسَّهُ الشَّرُّ فَذُو دُعَاءٍ عَرِيضٍ

Kur i dhurojmë dhuntitë Tona njeriut, ai largohet dhe na kthen kurrizin, mirëpo, kur atë e godet e keqja, ai lutet gjerë e gjatë.⁶

Ndërkohë, besimtari pavarësisht situatës në të cilën ndodhet, qoftë në gëzime a në hidhërime, në mbarësi po ashtu në mjerim, pra në çdo gjendje mundohet të ruajë këtë miqësi me Zotin.

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} gjithashtu ka përshkruar këtë sjellje të besimtarit:

عَنْ صُهَيْبٍ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ

”عَجَبًا لِأَمْرِ الْمُؤْمِنِ إِنَّ أَمْرَهُ كُلَّهُ خَيْرٌ وَلَيْسَ ذَلِكَ لِأَحَدٍ إِلَّا لِلْمُؤْمِنِ إِنْ أَصَابَتْهُ سَرَّاءٌ شَكَرَ فَكَانَ خَيْرًا لَهُ وَإِنْ أَصَابَتْهُ ضَرَاءٌ صَبَرَ فَكَانَ خَيْرًا لَهُ“.

Suhejbi ^{r.a.} Transmeton se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë: “E çuditshme është çështja e besimtarit. Çdo gjendje që ai kalon, mban mirësi për të dhe kjo i ndodh vetëm besimtarit dhe askujt tjetër. Nëse i qëllon diçka e mirë, ai e falënderon (Allahun) dhe kjo i sjell dobi, dhe nëse e godet e keqja ai tregohet i durueshëm dhe kështu (edhe) kjo i sjell dobi”.⁷

عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ، عَنْ رَسُولِ اللَّهِ - صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ - أَنَّهُ قَالَ ”عَظُمَ الْخَزَاءُ مَعَ عَظَمِ الْبَلَاءِ وَإِنَّ اللَّهَ إِذَا أَحَبَّ قَوْمًا ابْتَلَاهُمْ فَمَنْ رَضِيَ فَلَهُ الرِّضَا وَمَنْ سَخِطَ فَلَهُ السُّخْطُ“.

Enes ibn Maliku ^{r.a.} transmeton se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë: “Shpërblimet e mëdha vijnë bashkë me sprovat e mëdha. Nëse Allahu e do një popull, ai e vë atë në sprovë. Ai që pajtohet me sprovën, fiton kënaqësinë e Allahut, ndërsa ai që tregohet i pakënaqur, tërheq zemërimin e Tij”.⁸

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ ”مَا يَزَالُ الْبَلَاءُ بِالْمُؤْمِنِ وَالْمُؤْمِنَةُ فِي نَفْسِهِ وَوَلَدِهِ وَمَالِهِ حَتَّى يَلْقَى اللَّهَ وَمَا عَلَيْهِ خَطِيئَةٌ“.

Ebu Hurejra ^{r.a.} transmeton se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë: “Për aq kohë sa besimtari dhe besimtarja do të vijnë në të rëndohen nga sprovat mbi veten, fëmijët dhe pasurinë e tyre, deri sa ta takojnë Allahun, ata nuk do të kenë asnjë mëkat

me vete”.⁹

Mesihu i Premtuar ^{a.s.} ka thënë:

“Njerëzit që nuk marrin asnjë pjesë nga hidhërimet dhe brengat e kësaj bote, e konsiderojnë veten të mbarë dhe fatlumë. Ata janë të paditur e të panjohur nga të fshehtat dhe të vërtetat e Allahut të Madhërishëm. ... Natyra njerëzore është e tillë që për të arritur përsosmërinë, ajo kërkon të kalojë përmes dhimbjes. Nëse Allahu i Madhërishëm e vë dikë në sprovë, ai duhet ta shikojë atë si mirësi dhe favor prej Tij. Sprovat i forcojnë njeriut durimin dhe aftësinë për të qenë i kënaqur me caktimin e Allahut.

... Allahu i Madhërishëm është i Plotëfuqishëm mbi çdo gjë, por çfarë ndodh me ata që nuk sprovohen nga vështirësitë a fatkeqësitë. Ata janë të përhumbur pas kësaj bote me gjithë dëshirat e saj. Ata kurrë s’e ngrejnë kokën lart dhe nuk e kujtojnë Zotin as në mënyrë të pavetëdijshme. Ata që thonë se nuk kanë kaluar asnjë sprovë, janë fatkeq, sepse duke pasur gjithmonë rehati e gëzime, ata bëjnë një jetë shtazore.

... Përmes kësaj dukurie, e cila gjendet e gërshetuar në natyrën e njeriut, Allahu i Madhërishëm manifeston realitetin e kësaj dynjaje, me lloj-lloj gjëmash e fatkeqësish. Edhe lutjet shfaqin shenja dhe rezultate të çuditshme në kohë

sprovash”.¹⁰

Ai gjithasthu shkruan:

“Të dini se ka dy rrugë për të arritur mirësinë e Allahut. E para kalon përmes ibadetit, vetëmohimit dhe përpjekjeve ndërsa e dyta kalon përmes kaderit dhe caktimit. Rruga e përpjekjeve është mjaft e mundimshme, sepse për këtë robi vetë duhet të lëndojë e të dobësojë trupin e tij. Në përgjithësi, natyra njerëzore është e prirë të mos e çojë veten qëllimisht para vështirësive, ndërsa ngjarjet dhe fatkeqësitë që e godasin njeriun përmes kaderit dhe caktimit, ndodhin papritmas. Kur ato e godasin njeriun, ai nuk ka zgjidhje tjetër dhe i duhet t’i përballojë ato medoemos, dhe kështu kjo bëhet shkas për pastrimin e tij shpirtëror”.¹¹

Në një vend tjetër, ai shkruan:

“Lind pyetja: përse vuajnë profetët dhe besimtarët? Edhe ata kalojnë nga disa vështirësi, të cilat për ta janë shenja mëshire. Shikoni, sa shumë vështirësi ka pasur në jetë Profeti ynë Hazret Muhammed ^{s.a.v.s.}? Të duhet një zemër e fortë edhe sikur t’i numërosh ato. Drithërohesh vetëm duke i kujtuar ato. Gjithashtu, historia është dëshmitare edhe për ato që kanë hequr shokët e Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}. A ekziston vallë ndonjë shqetësim që nuk i është shkaktuar Profetit ^{s.a.v.s.} dhe sahabëve të tij? Ashtu siç mohuesit nuk lanë diçka të

mangët në shkaktimin e vuajtjeve për ta, edhe Zoti i Madhërishëm nuk la diçka të mangët për t'i bekuar ata. Në të vërtetë, shqetësimet e tilla njerëzve të tillë u bëhen shërim. Zoti i Madhërishëm ua hap thesaret e mëshirës së Tij, pikërisht për shkak të këtyre shqetësimeve.

بر بلا کیں قوم را حق دادہ است
زیر آں گنج کرم بہادہ است

Por duhet, që në një kohë të tillë, njeriu të ketë durim të përsosur dhe të mos e paragjykojë Zotin e Madhërishëm. Njerëzit si sahabët e shohin Islamit si bekim të Zotit dhe për këtë arsye gjejnë një kënaqësi edhe në sprovat. Gradat e afrimit me Zotin siç mund t'i arrini gjatë sprovës, nuk mund t'i arrini dot me dëlirësi, adhurim dhe ushtrim të zakonshëm, edhe sikur këto t'i bëni për vite. Ata të cilët u bënë shembuj të afrimit me Zotin, të cilëve u ishte dhënë medalje e udhëheqjes së njerëzve dhe që u bënë të dashur të Zotit, secili prej tyre ka pasur në jetë ndonjë kohë kur atij i kanë rënë vështirësi dhe shtrëngime sa një mal. Shembulli i tyre është si qesja e myshkut. Derisa myshku është i mbyllur në të, ai nuk ndryshon nga një gur ose një copë dheu. Por kur ta shtypësh atë ose ta çash me thikë, menjëherë del një aromë prej tij, e cila edhe krejt shtëpinë mund ta parfumojë, madje parfumohet edhe ai që i afrohet. E njëjtë është gjendja e profetëve dhe e besimtarëve të sinqertë.

Derisa vështirësitë nuk i godasin ata, aftësitë e tyre të brendshme mbeten të fshehura dhe dera e përparimit të tyre mbetet e mbyllur”.¹²

Allahu na mundësoftë ta kuptojmë e të forcojmë këtë lidhje miqësore që ekziston midis Zotit dhe robit. Allahu na mundësoftë të pranojmë çdo vështirësi e sprovë me kënaqësi dhe ta bëjmë atë si një mjet për të përparuar drejt Tij! Amin

SHËNIME:

- [1] Kurani Famëlartë 2:156-157
- [2] Kurani Famëlartë 2:125
- [3] Kurani Famëlartë 29:3
- [4] Kurani Famëlartë 40:60
- [5] Kurani Famëlartë 17:84
- [6] Kurani Famëlartë 41:60
- [7] Sahihu i Muslimit, #2999
- [8] Sunen Ibni Maxha, #4031
- [9] Xhami' at-Tirmidhi, # 2399
- [10] Melfuzat, vëll. 2, f. 146-147
- [11] Gazeta el-Bedr, vëll. 3, numër 13, 16 gusht 1904, f. 3,4
- [12] “Melfuzat”, vëll. 5, f. 187 – 194.



KUSH ËSHTË DEXHALLI
(ANTIKRISHTI)?

Në disa hadithe, është paralajmëruar për ardhjen e dytë të Isait^{a.s.} dhe një ndër veprat e tij krejsore do të ishte mbytja e Dexhallit. Në veprën e njohur të haditheve “Sahih Muslim”, te libri i sprovave dhe shenjat e Orës, gjejmë një hadith të gjatë. Ndër të tjera, në këtë hadith thuhet:

عَنْ النَّوَاسِ بْنِ سَعْمَانَ قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: {...فَيَبْتِغِي هُوَ كَذَلِكَ إِذْ بَعَثَ اللَّهُ الْمَسِيحَ ابْنَ مَرْيَمَ فَيُزِيلُ عِنْدَ الْمَنَارَةِ الْبَيْضَاءِ شَرِيْقَ دِمَشْقَ بْنَ مَهْرُودَتَيْنِ وَاضِعًا كَتِفَيْهِ عَلَى أَخْبِجَةِ مَلَكَيْنِ إِذَا طَاطَأَ رَأْسُهُ قَطَرَ وَإِذَا رَفَعَهُ تَحَدَّرَ مِنْهُ جُمَانٌ كَاللُّؤْلُؤِ فَلَا يَحِلُّ لِكَاْفِرٍ يَحْدُ رِيْحَ نَفْسِهِ إِلَّا مَاتَ وَنَفْسُهُ يَنْتَبِي حَيْثُ يَنْتَبِي طَرْفُهُ فَيُطْلَبُهُ (أي الدجال) حَتَّى يَذْرُوكَهُ بِتَابٍ لَدَى فَيُثَلِّهُ

Nevvas ibn Muslimi^{r.a.} ka përcjellë se i Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.} ka thënë: ... dhe pikërisht në këtë kohë, Allahu do të dërgojë Mesihun, të birin e Merjemes, dhe ai do të zbresë në minaren e bardhë në Lindjen e Damaskut. (Ai do të jetë) i veshur me dy rroba të lyera lehtë me shafran dhe duke vendosur duart në krahët e dy engjëjve. Kur të përkulë kokën, do t'i bjerë uji pika-pika nga koka dhe kur ta ngrejë lart, rruazat e ujit i bien si perla. Çdo mohues që gjen frymën e tij do të pësojë vdekjen, dhe fryma e tij do të arrijë aq larg sa të rrokë syri. Më pas ai (Mesihu) do ta kërkojë atë (Dexhallin) derisa ta zërë te porta e Ludit dhe ta mbyjë atë.¹

Kush është Dexhalli (antikrishti)?

Shumica e njerëzve janë të prirë të marrin fjalët e haditheve në lidhje me ardhjen e Dexhallit në mënyrë të drejtpërdrejtë (kuptimin literal). Mbizotërimi i kuptimit të dukshëm në mendësinë muslimane dhe shmangia

e kuptimit figurativ ka mundësuar që shumica e muslimanëve besojnë se Dexhalli qenka një njeri i cili si gogol zotëron aftësi të jashtëzakonshme për qëllime të tmerrshme. Sipas këtij besimi, dexhalli do të vijë në fund të kohës dhe përmes fuqive të tij të pazakonta do do t'u shkaktojë muslimanëve dëme e humbje të mëdha. Pra, ky botëkuptim është krejtësisht i gabuar pasi bazohet në pranimin e kuptimit literal të haditheve, gjë që i kundërvihet jo vetëm Kuranit Famëlartë madje edhe haditheve të sakta.

Ne duhet të nënvizojmë se tema e ardhjes së Mesihut dhe daljes së Dexhallit është përcjellë nga më shumë se njëzet sahabë dhe janë përmendur në mjaft libra. Përsëritja e temës së dexhallit në mënyrë të shpeshtë në një varg hadithesh e bën atë një nga temat më të besueshme të përmendura nga hadithi i nderuar. Por siç është theksuar më lartë, këto hadithe përmbajnë kuptime figurative që kërkojnë interpretime dhe shtjellime të cilat duhet të përputhen me Kuranin Famëlartë. Ndërkohë marrja e kuptimit drejtpërdrejtë dhe literal të haditheve e çon lexuesin drejt mendimeve kontradiktore. Madje, shumica nga këto paralajmërime kanë lidhje me vizione apo ëndrra të cilat kishte parë i Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.}. P.sh.: Njëherë i Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.} e pa në ëndërr Ebu Xhehlin në Xhenet dhe ai tha: “Ç’lidhje ka Ebu Xhehli me Xhenetin?” Por, më vonë kur djali i tij Ikrimë ibn Ebi Xhehli përqafoi Islam, in,

të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.} iu zbulua për herë të parë kuptimi i vërtetë i ëndrrës, pra ai që nënkuptohej në ëndërr është Ikrima, jo Ebu Xhehli.

Shembulli më i qartë i kuptimit figurativ gjendet në hadithin që ka përcjellë Hazret Xhabir ibn Abdullahu ^{r.a.}, në lidhje me Ibn Sejadin dhe historinë e tij me të Dërguarin e Allahut ^{s.a.v.s.} dhe dy sahabë të tij të shquar Hazret Ebu Bekrin ^{r.a.} dhe Hazret Omer ibn el-Hattabin ^{r.a.}, të cilët besonin se Ibn Sejadi qenka Dexhalli. I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} i kishte thënë Hazret Omerit ^{r.a.}: “Nëse vërtet qenka ai (dexhalli), atëherë ti je bashkëkohësi i tij”.²

Studimi i plotë i këtyre haditheve dhe shqyrtimi i elementeve të përmendura në to a çon drejt përfundimit se Dexhalli i cili do të përballet me Mesihun e Premtuar në fund të kohës simbolizon popullin e krishterë dhe në veçanti priftërinjtë, filozofët dhe studiuesit fanatikë të cilët do të kërkojnë të përhapin doktrinat e korruptuara e të rreme të krishterimit. Nëse në njërën anë ata bazojnë besimin e tyre në disa hipoteza të rreme të lidhura me ngjarjen e kryqëzimit, në anën tjetër filozofët e tyre promovojnë mendime të shtrembra dhe sjelljen amorale. Nganjëherë sulmet kundër Islamit shfaqen në formën e dyshimeve dhe argumenteve të pabaza, me të cilat kundërshtarët duan të përdhosin emrin e Islamit apo tentojnë të baltosin emrin e Profetit

Muhammed (paqe dhe bekimet e Allahut qofshin me të!). Ky popull do të përdorte si mjet mashtrimin dhe dhëlpërinë për të shtrembëruar dhe për të fshirë faktet, dhe do të tentojë ta paraqesë doktrinat e shtrembëruara të krishterit sikur të ishte e vetmja fe e vërtetë. Pra, pavarësisht shtrembërimit dhe kontradiktave të panumërta, ata do të tentojnë të paraqesin krishterimin si të vërtetë, ndërsa Islamit sikur të ishte një katastrofë.

Përshtkrimi i Dexhallit (i Antikrishtit), aftësitë dhe fuqitë e tij, shfaqja e Xhuxh-Maxhuxhit, dalja e kafshës, udhëtimi dhe qëndrimi i Dexhallit, të gjitha këto janë profeci të hollësishme që do të ndodhin në kohën kur shkenca e dija do të arrijnë zhvillim të jashtëzakonshëm. Në këtë periudhë, do të shpiken mjetet e reja të komunikimit dhe transportit, të cilat do të mundësojnë përhapjen e thirrjes së Dexhallit dhe lëvizjen e tij drejt vendeve të largëta. Ai do të ushtrojë ndikimin e tij dhe do të mposhtë çdo kundërshtim. Është e çuditshme që Allahu i Plotfuqishëm ka spikatur një veti, e cila gjendet e fshehur në emërtimin e *fitnes* (sprovës) si dhe në emërtimin e shpëtimtarit të premtuar. Pra, fitneja (sprova) është quajtur “fitneja e Dexhallit” dhe ky përshtkrim tregon se sprova e Dexhallit lidhet ngushtë me doktrinat e shtrembëruara të krishterimit, i cili do të shënojë rritje të vullshme anëmbanë botës përmes gënjeshtrave dhe

mashtimeve. Personi i cili do të vinte për të përballuar Dexhallin është quajtur gjithashtu nëpër hadithe si “Mesih” dhe kjo tregon se Mesihu i vërtetë do të ballafaqohet me Mesihun e rremë dhe të trilluar. Pra, kjo është arsyeja përse në hadithe, ai është quajtur “*el-Mesihud-Dexhall*”.

Megjithatë, ne shohim se për fat të keq disa u veshin haditheve të Dexhallit kuptime të drejtpërdrejta e literale, dhe mendojnë se ai qenka një burrë, pavarësisht se një kuptim i tillë has kontradikta të mëdha. Madje vetë i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} e ka quajtur sprovën e Dexhallit si sprova më e madhe për njerëzimit, që nga krijimi i Ademit deri në ardhjen e Kiametit:

عَنْ هِشَامِ بْنِ عَامِرٍ الْأَنْصَارِيِّ قَالَ سَمِعْتُ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ مَا بَيْنَ خَلْقِ آدَمَ إِلَى أَنْ تَقُومَ السَّاعَةُ فِتْنَةٌ أَكْبَرُ مِنْ فِتْنَةِ الدَّجَالِ

“Që nga krijimi i Ademit e deri në ardhjen e Orës, nuk ka gjëmë më të madhe se sa gjëma e Dexhallit”.³

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.}, i lutej Allahut për strehim e mbrojtje prej sprovës së Dexhallit, madje ai porositi muslimanët që të bënin këtë lutje në çdo falje.

عَنْ غَائِشَةَ، زَوْجِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَخْبَرَتْهُ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ يَدْعُو بِالصَّلَاةِ “اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الْمَحْيَا وَفِتْنَةِ الْمَمَاتِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْمَأْثَمِ وَالْمَغْرَمِ”

Sipas Hazret Ajshes^{r.a.}, i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} bënte këtë lutje gjatë namazit: O Allah! Më mbro nga ndëshkimi i varrit! Më mbro nga trazira e Dexhallit të kohës së Mesihut! Më

mbro nga trazira e jetës e nga trazira e vdekjes! O Allah! Më mbro nga mëkatet dhe nga barra e borxheve!⁴

Për sa i përket pretendimit të disa djetarëve se meqë i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} dyshonte se Ibn Sajadi ishte Dexhalli, prandaj kjo është dëshmi e mjaftueshme se Dexhalli duhet të jetë një burrë, por një përfundim i tillë është i gabuar. Kur Profeti ^{s.a.v.s.} e quajti Dexhall, ai paralajmëroi për devijimin që do të pësonte Ibn Sajadi. Në fillim ai pranoi Islamin, por më vonë deklaroi se ishte profet dhe në këtë mënyrë ishte një prej 30 Dexhallëve (mashtuesve) që do të deklaroheshin se janë profetë por do të jenë mashtues e gënjeshtarë.

Ne e lexojmë këtë në një hadith:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ “لَا تَقُومُ السَّاعَةُ حَتَّى يَخْرُجَ ثَلَاثُونَ كَذَّابًا دَجَالًا كُلُّهُمْ يَكْذِبُ عَلَى اللَّهِ وَعَلَى رَسُولِهِ”.

Hazret Ebu Hurejra ^{r.a.} ka përcjellë se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë: “Nuk do të vijë Ora (e kijametit) derisa të mos kenë ardhur 30 Dexhallë (gënjeshtarë). Secili prej tyre do të trillojë të pavërtetat për Allahun dhe për të Dërguarin e Tij”.⁵

Në thëniet e të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.} ka mjaft tregues dhe shenja që paralajmërojnë se Dexhalli i premtuar është një popull i cili do të shfaqet pas pushtimit të romakëve. Në hadith përmendet:

عَنْ نَافِعِ بْنِ عُثْبَةَ، قَالَ كُنَّا مَعَ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِي غَزْوَةٍ - قَالَ - فَأَتَى النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَوْمٌ مِنْ قَبْلِ الْمَغْرِبِ عَلَيْهِمْ ثِيَابُ الصُّوفِ فَوَافَقُوهُ عِنْدَ أَكْمَرٍ فَأَتَاهُمْ لَيْثَامٌ وَرَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَاعِدٌ - قَالَ -

- فَقَالَتْ لِي تَقْسِي إِلَيْهِمْ فَهُمْ يَنْبَهُمْ وَيَنْتَهُ - قَالَ - ثُمَّ كُنْتُ لَعْلَهُ نَحْيِي مَعَهُمْ . فَأَتَيْتُهُمْ فَكُنْتُ يَنْبَهُمْ وَيَنْتَهُ - قَالَ - فَحَضَيْتُ مِنْهُ أَرْبَعَ كَلِمَاتٍ أَعْدُهُنَّ فِي يَدَيَّ قَالَ " نَعُزُّونَ جَزِيرَةَ الْعَرَبِ فَيَنْتَحِهَا اللَّهُ ثُمَّ قَارِسَ فَيَنْتَحِهَا اللَّهُ ثُمَّ نَعُزُّونَ الرُّومَ فَيَنْتَحِهَا اللَّهُ ثُمَّ نَعُزُّونَ الدِّجَالَ فَيَنْتَحِهَا اللَّهُ " . قَالَ فَقَالَ نَافِعُ يَا جَابِرُ لَا تَرَى الدِّجَالَ يَخْرُجُ حَتَّى تُفْتَحَ الرُّومُ .

Hazret Nafi' ibn 'Utba ^{r.a.} ka përcjellë: "Ne ishim me të Dërguarin e Allahut ^{s.a.v.s.}

në një betejë. Atëherë erdhi një popull te i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} nga Perëndimi. Ata ishin të veshur me rroba leshi dhe qëndronin pranë një kodre derisa e takuan Profetin ^{s.a.v.s.} kur ai ishte ulur. Unë thashë me vete: Më mirë shko tek ata dhe qëndro mes atij (Profetit) dhe atyre që të mos e sulmojnë. Më vonë mendova se ndoshta ai po bën ndonjë bisedë të fshehtë me ta. Megjithatë, unë iu afrova atyre dhe qëndrova mes tij (Profetit) dhe atyre. Më kanë mbetur në kujtesë katër fjalë (nga biseda e Profetit ^{s.a.v.s.}) të cilat i përsëris (në gishtat e dorës). Ai (i Dërguari i Allahut) tha: Ju do të sulmoni Gadishullin Arabik dhe Allahu do t'ju mundësojë ta triumfoni atë, pastaj do t'ju mundojë të sundoni Persinë. Pastaj do të sulmoni Romën dhe Allahu do t'ju mundësojë ta pushtoni atë, pastaj do të sulmoni Dexhallin dhe Allahu do t'ju mundësojë ta mposhtni edhe atë". Nafiu tha: "O Xhabir! Ne nuk do të shohim daljen e Dexhallit derisa të pushtohet Roma (territori i Sirisë)".⁶

Në 1453 Sultan Mehmeti II pushtoi Kostandinopojën dhe kështu perëndoi Perandoria Bizantine. Kjo ngjarje shënoi gjithashtu shtrirjen e Perëndimit

dhe kolonizimin gjeografik të vendeve në të gjitha vendet e botës. Pak më vonë në 1492, rikonkuistimi rrëzoi Emiraten e Granadës dhe muslimanët u dëbuan nga Andaluzia. Në të njëjtin vit u zbulua Amerika, më pas Perëndimi me një hov të madh nisi pushtimin e vendeve muslimane. Fundi i epokës së Perandorisë Osmane u përputh në arritjen kulmore të Perëndimit.

Nëpër librat e hadithit ne gjejmë gjithashtu porosinë e të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.}, se pjesa e parë dhe e fundit të sures El-Kehf përmbajnë mbrojtje nga trazirat e Dexhallit. Nëse shfletojmë këtë sure dhe lexojmë ajetet e para dhe të fundit të saj, zbulojmë se ato përmbajnë një paralajmërim për njerëzit që thanë

وَيُنذِرَ الَّذِينَ قَالُوا اتَّخَذَ اللَّهُ وَلَدًا

"Allahu mori një bir".⁷

Ata që kanë humbur të gjitha përpjekjet në këtë botë dhe për të cilët Zoti i Madhëruar thotë:

الَّذِينَ ضَلَّ سَبِيلُهُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَهُمْ يُحْسِنُونَ أَنْهُمْ يُحْسِنُونَ ضُنْعًا

Janë ata që humbën gjithë mundin e tyre në jetën e kësaj bote dhe mendojnë se po shkëlqejnë në ndërtim.⁸

فَحِطَّتْ أَعْمَالُهُمْ فَلَا تَنفَعُهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَرُثَا

...Veprat e tyre u janë zhvlerësuar dhe, ditën e kiametit, Ne nuk do t'u japim kurrfarë vlere.⁹

Nga këto dëshmi del e qartë se Dexhalli përbën një popull, dhe Kurani Famëlartë dhe hadithet dallojnë tiparet e tyre dhe paralajmërojnë kohën e shfaqjes së tyre. Ne duhet të theksojmë se veprimtaria

e Dexhallit nuk kufizohet vetëm në përhapjen e doktrinave të shtrembëruara të krishterimit, madje për të shpëtuar nga kontradiktat dhe dobësitë e besimit, ai do të përdorë edhe mjete të liga dhe premtime joshëse për të rrënjosur mendimet ateiste në shoqëri. Një ndër kuptimet e të qenit “Dexhall” është se ai ndonjëherë do të mbulojë besimin e krishterë me dredhi, dhe nganjëherë do të heqë mantelin e besimit dhe do të shfaqet si i pafe apo njeri liberal e laik. Ai do të mohojë të gjitha fetë dhe do t’i shtyjë njerëzit drejt mosbesimit. Megjithatë, ai i frikësohet Islamit – sepse e di që Islami beson në Zotin e vërtetë. Prandaj, ideologjia ateiste përfshihet edhe në profecinë e Dexhallit. Hadithet japin edhe hollësi të tjera për Dexhallin. Ndër këto hollësira është përmendur se ai është qorr nga syri i djathtë, ndërsa syri i majtë do të jetë shumë i mprehtë ose, syri i tij i majtë është prëshkruar si rrushi lundruar ose si një yll i shndritshëm ose si një qelq jeshil. Në ballin e tij janë të shkruar shkronjat ke-fere (qafir ose jobesimtar) që mund të lexojë çdo besimtar, i shkolluar apo i pashkolluar. Ai urdhëron qiellin, që të lëshojë shi dhe urdhëron tokën që të mbijë. Ai do të nxjerrë thesare nga shkretëtira, të cilat do ta ndjekin si bletët ndjekin mbretëreshën e tyre. Ai do të ndajë një njeri në dy pjesë dhe pastaj e kthen sërish në gjendjen e mëparshme. Parajsa (xheneti) dhe ferri (xhehenemi) do ta shoqërojnë atë. Ai do të vijë në një gomar gjigant i cili i

paraprin diellit në Perëndim, ndërsa nuk dallohet bishti i tij nga pjesa e përparme. I Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.} gjithahtu ka përmendur në hadithin e Temim ed-Dariut^{r.a.} i cili në ëndërr e kishte parë Dexhallin të prangosur brenda një kishe që ndodhej në një ishull. Nëse vështrojmë këto hadithe dhe përpiqemi të kuptojmë ato në bazë të mendimit se Dexhalli u përket këtyre popujve të krishterë, të cilët përfaqësojnë krishterimin dhe besimin e shtrembëruar. Në dashtë Allahu, do të shfaqen akoma më shumë aspekte dhe profeci të hollësishme që vulosin vërtetësinë e të Dërguarit të Allahut^{s.a.v.s.}

SHËNIME:

1. *Sabih Muslim*, Kitab: el-Fiten ve Eshratus-Sa’ah, Bab: Dhikrud-Dexhall ue Sifetuhu vema Ma’ahu, hadith numër: 2937a
2. *Mishkatul Mesabih*, Kitabul Fiten, Bab: Kissetu ibn Sejjad, hadith nr. 5504.
3. *Musned Imam Ahmed*, hadith nr. 15831.
4. *Sabihu i Buhariut*, Kitab: Ezan, bab: Ed-dua kables-salam, hadith numër: 832.
5. *Sunen ibn Daud*, Libri: 39 Kitabul Melahim, Bab: Fi Khabri Ibn Sa’id, hadith numër 4334.
6. *Sabihu i Muslimit*, Kitab: El-Fitenu ve eshratus-Sa’ati, bab: Ma jekunu min Futuhatil-muslimin kabled-Dexhall, hadith numër: 2900.
7. *Kurani Famëlartë* 18:5.
8. *Kurani Famëlartë* 18:105.
9. *Kurani Famëlartë* 18:106.

Burim (në arabisht): <https://islamahmadiyya.net/inner.asp?recordID=33587>

وَلِلّٰهِ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَىٰ فَادْعُوهُ بِهَا وَذَرُوا الَّذِينَ يُلْحِدُونَ
فِي أَسْمَائِهِ سَيُجْزَوْنَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿١٠٦﴾

اَللّٰهُ

EMRAT E ALLAHUT



14. EL-GHAF-FĀR (GJITHËFALËSI)

رَبِّ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا الْعَزِيزُ الْغَفَّارُ ﴿١٤﴾

Zoti i qiejve, i tokës dhe i asaj që gjendet mes tyre, i Gjithëfuqishmi, Falësi.¹

Kuptimi leksikor

Emri el-Ghaffār është një prej emrave të Allahut që rrjedh nga rrënja غ ف ر (*Gha-Fe-Rr*) që do të thotë për të mbuluar, për të fshehur apo për të mbrojtur diçka nga papastërtia, për të falur dikë etj. Fjala مَغْفَرٌ (*mighfer*), e cila rrjedh nga e njëjta rrënjë, do të thotë përkrenare e mbajtur nga një ushtar në betejë. Sipas leksikut arab Lisan el-Arab, عَفَرَ اللهُ ذُنُوبَهُ (*ghafar-Allahu dhunubehu*) do të thotë se Allahu ia mbuloi mëkatet. Rrënja غ-ف-ر nënkupton gjithashtu mbrojtjen midis njeriut dhe mëkatit ose mëkatit dhe pasojave të mëkatit.

Emri el-Ghaffār është përmendur pesë herë në Kuranin Famëlartë. P.sh. Allahu thotë:

فَقُلْتُ اسْتَغْفِرُوا رَبَّكُمْ إِنَّهُ كَانَ غَفَّارًا ﴿١٠٠﴾

Dhe u thashë: Kërkojini falje Zotit tuaj, sigurisht, Ai është shumë Falës.²

Nga rrënja غ ف ر (*Gha-Fe-Rr*) rrjedhin tre emra të bukur الْغَفَّارُ (*el-Ghaffār*), الْغَفُورُ (*el-Ghafūr*) dhe الْغَافِرُ (*el-Ghāfir*), por vetëm dy të parët janë përmendur në 99 emrat e Allahut.

عَنْ أَبِي بَكْرٍ الصِّدِّيقِ، - رَضِيَ اللهُ عَنْهُ قَالَ لِرَسُولِ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَلَيْنِي دُعَاءُ أَدْعُو بِهِ فِي صَلَاتِي . قَالَ "قُلِ اللَّهُمَّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي ظُلْمًا كَثِيرًا وَلَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ فَاعْفُرْ لِي مَغْفِرَةً مِنْ عِنْدِكَ وَارْحَمْنِي إِنَّكَ أَنْتَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ "

Hazret Ebu Bekr es-Siddiku ^{r.a.} përcjell: "I kërkoja të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. të më mësonte një lutje që mund ta bëja në namazin tim. Ai më tha: Thuaj "O Allah! Kam shkelur shumë veten time dhe askush nuk m'i fal mëkatet përveç Teje. Andaj, jepma faljen prej Teje dhe mëshiromë. Ti je me të vërtetë Mëkatfalësi, Mëshirëbërësi".³

Emri el-Ghaffār tregon se Allahu është falësi i mëkateve të vogla e të mëdha, madje Ai e fal edhe shirkun (idhujtarinë) nëse njeriu pendohet prej tij. Siç thotë:

قُلْ يَا عِبَادِيَ الَّذِينَ أَسْرَفُوا عَلَى أَنْفُسِهِمْ لَا تَقْنَطُوا مِنْ رَحْمَةِ اللهِ إِنَّ اللهَ يَغْفِرُ الذُّنُوبَ جَمِيعًا ﴿٤٠﴾

Thuaj: O robërit e Mi që keqtrajtuat veten tuaj! Mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Sigurisht, Allahu fal të gjitha mëkatet. Sigurisht, Ai është Falësi, Mëshirëbërësi.⁴ Dhe thotë:

وَمَنْ يَعْمَلْ شُوْءًا أَوْ يَظْلِمْ نَفْسَهُ ثُمَّ يَسْتَغْفِرِ اللهُ يَجِدِ اللهُ غَفُورًا رَحِيمًا ﴿١٠٠﴾

Kushdo që bën vepër të keqe ose shkel veten e tij, më pas i kërkon falje Allahut,

do ta gjejë Allahun shumë Falës, shumë Mëshirëbërës.⁵

Sado të mëdha të jenë mëkatet, falja e Zotit është akoma më e madhe. Zoti ka thënë:

إِنَّ رَبَّكَ وَاسِعُ الْمَغْفِرَةِ

Sigurisht, Zoti yt ka falje të gjerë.⁶

Megjithatë, besimtarit nuk i lejohet të vazhdojë të kryejë mëkatet dhe të mos kërkojë falje me pretekstin që Zoti është falës dhe mëshirëplotë. Allahu gjithashtu ka thënë:

وَإِنِّي لَعَفَّارٌ لِّمَن تَابَ وَآمَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا ثُمَّ اهْتَدَىٰ

Dhe sigurisht, Unë jam shumë Falës për atë që pendohet, beson dhe bën të mira dhe më pas qëndron në udhëzim.⁷

Pra, falja e Zotit është vetëm për ata që i shprehin keqardhje për sjelljet e tyre dhe i kthehen tërësisht rrugës së Zotit:

إِن تَكُونُوا صَالِحِينَ فَإِنَّهُ كَانَ لِلْأَوَّابِينَ غَفُورًا

Zoti juaj di më së miri çfarë keni në shpirtin tuaj. Nëse jeni të sinqertë, atëherë sigurisht, ndaj atyre që pendohen shumë, Ai është shumë Falës.⁸

Besimtari gjithashtu duhet të shlyejë mëkatet e tij duke iu bindur porosive të Allahut të shpallura në Kuranin Famëlartë, dhe të synojë delirësinë shpirtërore. Ai gjithashtu duhet t'i

kërkojë falje Zotit, siç ka qenë praktika e të Dërguarit të Allahut ^{S.A.V.S.}

عَنْ ابْنِ عُمرَ، قَالَ إِنَّ كُنَّا لَنُتَعَدُّ لِرَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِي الْمَجْلِسِ الْوَاحِدِ مِائَةَ مَرَّةٍ “رَبِّ اغْفِرْ لِي وَثُبْ عَلَيَّ إِنَّكَ أَنْتَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ

Hazret Abdullah ibn Omeri ^{r.a.} rrëfen: “Ne numëruam se i Dërguari i Allahut ^{S.A.V.S.} thoshte gati njëqind herë gjatë një takimi: “O Zoti im! Më fal dhe më prano pendimin. Vërtet Ti je Falës, Mëshirëplotë”.⁹

مَنْ قَالَ أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ وَأَتُوبُ إِلَيْهِ غُفِرَ لَهُ وَإِنْ كَانَ قَرَّةً مِنَ الرَّحْفِ

I Dërguari i Allahut ^{S.A.V.S.} ka thënë: Nëse dikush bën këtë lutje, atij do t'i falen (mëkatet), edhe sikur të jetë larguar nga lufta. “I kërkoj falje Allahut. Nuk ka të adhurar tjetër përveç Atij, të Gjallit, të Qëndrueshmit. Unë kthehem i penduar tek Ai”.¹⁰

Emri el-Ghaffār është përmendur edhe në hadithe. P.sh. Hazret Said el-Hudriu ^{r.a.} përcjell:

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: إِنَّ الشَّيْطَانَ قَالَ: وَعَرَيْكَ يَا رَبِّ لَا أَبْرَحُ أُعْوِي عِبَادَكَ مَا دَامَتْ أَرْوَاحُهُمْ فِي أَجْسَادِهِمْ فَقَالَ الرَّبُّ عَزَّ وَجَلَّ: وَعَرَّيْتُ وَجَلَّالِي وَارْتَفَاعَ مَكَانِي لَا أَزَالُ أَعْفِرُ لَهُمْ مَا اسْتَغْفَرُونِي

I Dërguari i Allahut ^{S.A.V.S.} ka thënë se djalli tha: “O Zoti im! Për fuqinë Tënde, unë do të vazhdoj t'i devijoj robërit e Tu për sa kohë që shpirtrat e tyre janë në trupat e tyre” Zoti i Madhërishëm u

përgjigji: Beto hem për fuqinë, lavdinë dhe pozitën time të lartësuar, unë do të vazhdoj t'i fal për aq kohë sa ata më kërkojnë falje”.¹¹

عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِذَا تَصَوَّرَ مِنَ اللَّيْلِ قَالَ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ، رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا، الْعَزِيزُ الْغَفَّارُ

Hazret Aisheja^{r.a.} përcjell se kur i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} zgjohej nga gjumi, ai thoshte: “Nuk ka zot tjetër përveç Zotit, i Vetmi, i Lartësuari, Zoti i qiejve dhe i tokës dhe i gjithçkaje që gjendet ndërmjet tyre, i Fuqishmi dhe Falësi”.¹²

Ebu Is'hak ez-Zexhaxhi thotë: Kur përdoret për Allahun, fjala الغفر *el-ghafu* do të thotë se Ai ua mbulon mëkatet robërve të Tij dhe ua fsheh të metat.¹³

Emri i Zotit të Plotfuqishëm *el-Ghaffār* është përmendur në Kuran si dyshe me emrin *el-'Aziz* triumfuesi, dhe ky çift emrash “Falës dhe Triumfues” tregon se fitorja absolute e Zotit kërkon nënshttrimin dhe ndëshkimin e atyre që e kundërshtojnë, megjithatë madhështia e Tij kërkon që Ai ti falë të gjitha mëkatet.

Ebū Hāmid el-Ghazālīu ka thënë:

“Çdo krijesë është e destinuar të ketë përsosmëri e papërsosmëri, apo shëmti e bukuri, kështu që kushdo që e anashkalon të shëmtuarën dhe përmend

vetëm të bukurën është ai që shfaq këtë atribut”.

Mëkati dhe pendimi

Mesihu i Premtuar ^{a.s.} shkruan:

“Në një hadith përcillet se kur robi i përgjërohet Allahut me ngashërim dhe i kërkon falje në mënyrë këmbëngulëse, Zoti e lajmëron përfudimisht: “Unë të kam falur, tani bëjë si të duash”. Kjo tregon se zemra e një njeriu të tillë ndryshon tërësisht dhe ai tashmë ndjen një neveri të brendshme ndaj mëkatit. Nëse dikush shikon një dele duke ngrënë bajgat e jashtëqitjet, atij kurrë nuk i ngjallet dëshira për ta konsumuar atë. Në mënyrë të ngjashme, njeriu i cili ka fituar faljen e Allahut, kurrë nuk i kthehet mëkatit. Muslimanët instinktivisht e urrejnë mishin e derrit edhe pse mund të bëjnë mijëra gjëra të tjera të paligjshme e të ndaluara. Urtësia në vendosjen e kësaj forme neverie te muslimanët është të ilustruhet se njerëzimi duhet të përftojë një ndjenjë të tillë neverie ndaj mëkatit.”¹⁴

SHËNIME

1. *Kurani Famëllartë* 38:67.
2. *Kurani Famëllartë* 71:11.
3. *Sunen en-Nesai*, hadith numër 1302.
4. *Kurani Famëllartë* 39:54.
5. *Kurani Famëllartë* 4:111.
6. *Kurani Famëllartë* 53:33.
7. *Kurani Famëllartë* 20:83.
8. *Kurani Famëllartë* 17:26
9. *Sunen Ebi Daud*, hadith numër: 1516.

10. *Sunen Ebi Daud*, hadith numër: 1517.
11. *Musned Imam Ahmedi*, hadith numër 11237, hadith Hasan
12. *Sahih ibn Hibban*, numri i hadithit 5530, *En-Nesā'i*, numri i hadithit 10700.
13. *Tefsirul Esmā'*, f. 38
14. Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}, *Melfuzat* Vëll 1, Tilford, Surrey, Islam International Publication Ltd., 2018, f. 3-4.



15. EL-KAH-HAR (I ASHPËRI)

يَا صَاحِبِي السَّيِّئِ الْأَرْبَابِ مُتَّقِفُونَ خَيْرٌ أَمِ اللَّهُ الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ

“O shokët e mi të burgut! Më mirë janë zota të ndryshëm, apo Një, i Plotfuqishmi?”¹

Zoti ka krijuar çdo gjë nga asgjëja dhe i ka dhënë asaj një formë të veçantë dhe një trajtë unike që i përgjigjet plotësisht funksionet dhe veprimtaritë e saj. Kjo formë e bën atë të dallueshme nga të tjerët pavarësisht shumëllojshmërisë dhe mjaftueshmërisë së saj.

Kuptimi leksikor

Emri الْقَهَّار el-Kahhar është një prej emrave të Allahut, i cili rrjedh nga rrënja قَهَرَ (kahr) që nënkupton sovranitetin dhe autoritetin absolut. *El-Kahhari* mbizotëron tjetrin përmes fuqisë së tij.

Nga rrënja قَهَرَ (kahr) dalin dy emra:

1) *القاهر el-Kahir* (veprues) dmth. i papërballueshëm dhe triumfues, i cili është përdorur 2 herë në Kuran (6:19, 6:62). Allahu është *el-Kahir*, sepse Ai i mbizotëron kundërshtarët, me anë të shenjave që vërtetojnë njëshmërinë e Tij. Po ashtu Ai i mbisundon sundimtarët tiranë me anë të fuqisë së Tij absolute dhe i nënshton të gjitha krijesat përmes vdekjes.

2) *القهار el-Kahhar* (emri në shkallën superlative) dmth. i Ashpër, i Plotfuqishëm, Mbizotërues, Nënshtrues, Triumfues etji dhe është përdorur 6 herë në Kuran.

Sipas Imam Ragibit, *el-Kahr* nuk do të thotë vetëm mbizotërim absolut, por kjo fjalë gjithashtu nënkupton ushtrimin e autoritetit ndaj tjetrit dhe nënshtrimin e plotë me hir a me pahir.

Imam Bejhakui shpjegon këtë atribut kështu: “Fjala *القهار el-Kahhar* është shkalla superlative e mbiemrit *القاهر el-Kahir*. Meqë Allahu është i Plotfuqishëm, mbiemri *el-Kahhar* i përgjigjet atributit të Tij të plotfuqishmërisë, e cila është vetia e Tij e qenësishme. Është thënë se Ai ia nënshton krijesës atë që dëshiron”. Sipas et-Tabariut: Ai e nënshton çdogjë jashtë Tij, përmes plotfuqishmërisë së Tij absolute”. Meqë Universi vepron në bazë të ligjeve të përcaktuara, andaj Ai është Zoti i gjithësisë.

Përmendja në Kuranin Famëlartë

قُلْ اللَّهُ خَالِقُ كُلِّ شَيْءٍ وَهُوَ الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ ﴿١﴾

Thuaj: Allahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai është i Vetmi, Mbizotëruesi.²

لَوْ أَرَادَ اللَّهُ أَنْ يَخْلُقَ وَلَمَّْا لَأَظْفَقَ مِمَّا يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ ۚ سُبْحَانَهُ هُوَ اللَّهُ
الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ ﴿٢﴾

Po të donte Allahu të kishte ndonjë djalë, do të zgjidhte çfarë të donte nga ato që Ai ka krijuar. I pastër është Ai (nga kjo e metë). Pikërisht Ai Allah është i Vetmi, Mbizotëruesi.³

يَوْمَ هُمْ تَارِضُونَ ۚ لَا يَخْفَىٰ عَلَى اللَّهِ مِنْهُمْ شَيْءٌ ۚ لَبِئْسَ الْمَلِكُ الْيَوْمَ
لِلَّهِ الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ ﴿٣﴾

Ditën kur ata do të dalin, gjendja e tyre nuk do t'i fshihet Allahut aspak. Kujt i përket sundimi sot? Allahut, të Vetmit, Triumfuesit.⁴

I vetmi që sundon mbi çdogjë

Është interesante se në secilin ajet, ku përmendet atributi *el-Kahhar*, atë e paraprin atributi *el-Vahid* (i Vetmi). Kjo tregon se fuqia e Tij absolute që mbizotëron dhe nënshton të gjithë krijesat e Tij, i përket vetëm Atij. Qiejt, toka, gjallesat, engjëjt, gjithçka i nënshtrohet Atij:

ثُمَّ اسْتَوَىٰ إِلَى السَّمَاءِ وَهِيَ دُخَانٌ فَقَالَ لَهَا وَلِلْأَرْضِ ائْتِيَا طَوْعًا أَوْ كَرْهًا
قَالَتَا أَتَيْنَا طَائِعِينَ ﴿٤﴾

Më pas Ai iu drejtua qiellit që ishte

tym. I tha atij dhe tokës: “Ejani me hir a me pahir!” Ata thanë: “Erdhëm të nënshtruar”.⁵

Ibn Kejjimi thotë: “*el-Kahhar* dmth. Mbizotëruesi duhet të jetë një e i pashoq. Nuk është e mundshme që të ketë të dytë. Meqë plotfuqishmëria dhe njëshmëria janë attribute të ndërlidhura me njëri-tjetrin, prandaj sundimi, plotfuqishmëria, mbizotërimi dhe madhështia i takojnë vetëm Zotit të Vetëm, dhe çdo qenie tjetër është i nënshtruar dhe i mbizotëruar prej Tij”.

Atributi “el-Kahhar” në hadith

عَنْ عَائِشَةَ، قَالَتْ سَأَلْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَنْ قَوْلِهِ عَزَّ وَجَلَّ {يَوْمَ يُبْدَلُ الْأَرْضُ غَيْرَ الْأَرْضِ وَالسَّمَوَاتُ} فَأَيَّنَ يَكُونُ النَّاسُ يَوْمَئِذٍ يَا رَسُولَ اللَّهِ فَقَالَ ” عَلَى الصِّرَاطِ ”

Hazret Aisheja^{r.a.} ka përcjellë: “Unë e pyeta të Dërguarin e Allahut^{s.a.v.s.} në lidhje me thënien e Allahut ‘Ditën kur toka do të ndryshojë me tokën tjetër dhe, edhe qiejt do të dalin para Allahut, të Vetmit, Triumfuesit’.⁶ se ku do të jenë njerëzit atë ditë?” Ai tha: “në (urën e) Siratit”.⁷

Kur i Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.} gjatë gjumit kthehej në shpinë, ai thoshte:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ، رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا الْعَزِيزُ الْغَفَّارُ

Nuk ka të adhureshëm tjetër përveç Allahut, të Vetmit, Mbizotëruesit, Zotit

të qiejve dhe të Tokës, dhe të gjithçkaje midis të dyjave, triumfuesit dhe Falësit.⁸

I Vetmi që meriton adhurimin

Allahu është i Plotfuqishëm dhe vetëm Ai meriton të adhurohet. Zotat e tjerë të remë janë vetëm krijesa, që janë të dobëta, të mjerueshme dhe të nënshtruara para Allahut. Ai që nuk i largon dot vetes ndonjë të keqe, si mund të mbizotërojë dikë tjetër. Prandaj, Hazret Jusufi^{a.s.} iu drejtua dy shokëve të tij të burgut dhe u tha:

يَا صَاحِبِي السِّجْنِ أَأَرْبَابٌ مُتَفَرِّقُونَ خَيْرٌ أَمْ اللَّهُ الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ

O shokët e mi të burgut! Më mirë janë zota të ndryshëm, apo Një, i Plotfuqishmi?⁹

Ky atribut nuk i përshtatet njeriut

Nuk është i përshtatshëm që atributi el-Kahr dmth. nënshtrimi t’i atribuohet njeriut, sepse kur dikush nënshtron tjetrin, ai e bën këtë me shtypje, tirani dhe dhunë. Njeriu i tillë sundon mbi të varfrit dhe të dobëtit me despotizëm siç Allahu ka përmendur në historinë e Faraonit. Ai thotë:

قَالَ سَتَقُلُّ أَبْنَاءَهُمْ وَتَسْتَحْيِي نِسَاءَهُمْ وَإِنَّا فَوْقَهُمْ قَاهِرُونَ

“Ne do t’i vrasim keqas bijtë e tyre, kurse gratë e tyre do t’i mbajmë gjallë; dhe ne sigurisht jemi të plotfuqishëm mbi ta”.¹⁰

Nënshtrimi dhe dorëzimi i plotë ndaj Zotit

Ky atribut i Allahut i përgjigjet atributit të nënshtimit të njeriut. I tillë është edhe kuptimi i Islamit, pra dorëzimi i plotë i dëshirave, veprave, fjalëve, shqisave, aftësive dhe fuqive para vullnetit të Zotit të gjithësisë. Kurani jep shembullin e Ibrahimit ^{a.s.} dhe thotë:

إِذْ قَالَ لَهُ رَبُّهُ أَسْلِمْ ۖ قَالَ أَسْلَفْتُ لِرَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١١٠﴾

(Kujtojeni) kur Zoti i tij i tha: “Nënshtrohu!” Ai (pa ngurrim) tha: “Iu nënshtrova Zotit të botëve”.¹¹ Nënshtrimi i njeriut para dëshirave të nefsit është humbja dhe poshtërimi i tij, ndërsa dorëzimi i vetes para vullnetit të Zotit është një ngritje e gjithanshme. Shembulli i sakrificës së Ibrahimit ^{a.s.}, Haxhires ^{r.a.} dhe Ismailit ^{a.s.} është dëshmia e gjallë e këtij parimi.

Zotin e njohim përmes plotfuqishmërisë së Tij

Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.} Shkruan:

“Kështu që, procesi i shpërblimit dhe i ndëshkimit patjetër që fillon menjëherë dhe xhehenemliu hyn në xhehenem dhe xhenetliu në xhenet. Por pas kësaj, ka edhe një kohë tjetër për manifestim më të plotë, të cilën Zoti Urtiplohtë vendosi ta shfaqë. Sepse Ai e krijoi njeriun, me qëllim që Ai të njihet përmes fuqisë

së Tij krijuese; do t’i shkatërrojë të gjithë, që të njihet përmes fuqisë së Tij shkatërruese, dhe do t’i ringjallë të gjithë një ditë, duke iu dhënë jetë të përsosur dhe duke i tubuar të gjithë në një fushë, që të njihet përmes plotfuqisë së Tij”.¹²

SHËNIME

1. *Kurani Famëlartë* 12:40.
2. *Kurani Famëlartë* 13:17.
3. *Kurani Famëlartë* 39:5.
4. *Kurani Famëlartë* 40:17.
5. *Kurani Famëlartë* 41:12.
6. *Kurani Famëlartë* 14:49.
7. *Sabihu i Muslimit*, Kitab: *Sifetul Kijameti*, uel *Xheneti uen-Nar*, Bab: *Fil-B’athi*, uen-*Nushuri*, ue *Sifetil-Erdi jomel-Kijameti*, numër 2791.
8. *En-Nesai fis-Sunenil-Kubra*, numër 10700.
9. *Kurani Famëlartë* 12:40.
10. *Kurani Famëlartë* 7:128.
11. *Kurani Famëlartë* 2:132.
12. Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}, *Filozofia e mësimeve të Islamit*, Islam International Publications Ltd., Tiranë, 2019, f. 164.



*Pesë arsye
pse agjërojnë muslimanët?*

Gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit, miliona muslimanë anembanë botës agjërojnë nga mëngjesi deri në perëndim të diellit. Ky muaj ofron një kohë të volitshme për Vetëreflektim e meditim, dhe besimtarët muslimanë përqendrohen në përmirësimin e lidhjes së tyre me Zotin (ibadet) si dhe në bamirësinë ndaj njerëzve; ndërkohë duke e përmbajtur veten nga ushqimi, uji dhe marrëdhëniet bashkëshortore gjatë orëve të ditës.

Por, pse agjërojnë muslimanët kur si praktikë ajo nuk është aspak e lehtë. Mjafton të pyesni ndonjë musliman praktikant se si ndien kur agjëron gjatë ditëve përvëluese të verës (ndonëse agjërimi gjatë muajve të dimrit është shumë më i lehtë!). Vërtet, në fillim, duket e vështirë për të logjikuar arsyen pse muslimanët u përmbahen vullnetarisht rregullave kaq të forta të agjëritimit dhe për një muaj të tërë, e mendojnë veten e tyre me vetëprivim e vështirësi. Pikërisht për ta kuptuar këtë praktikë, po paraqes pesë arsye pse muslimanët agjërojnë gjatë Ramazanit.

1. Një urdhër hyjnor

Nëse zbërthejmë kuptimin e fjalës “*musliman*”, ai i referohet personit i cili ka gjetur paqe, duke iu nënshtruar Allahut (Zotit). Kurani Famëllartë, të cilin muslimanët e besojnë si fjala absolute e Allahut, jep urdhër për të agjëruar gjatë

këtij muaji.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“O ju që besuat! Ju obligohen agjërimet ashtu siç u ishin obliguar atyre që ishin para jush, që të bëheni të druajtur (ndaj Zotit)”.¹

Një musliman i sinqertë mundohet të ndjekë të gjitha udhëzimet që gjenden në Kuran apo në praktikën e Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}, sepse vetëm nëpërmjet këtij nënshtrimi të plotë, me fjalë e me vepra, ai mund të gjejë shpëtim. Shenjat e këtij shpëtimi, besimtari i sheh fillimisht në këtë botë kalimtare dhe më pas në botën e përtejme. Siç thotë Kurani:

وَلَعَنَ خَافَ مَقَامَ رَبِّهِ جَنَّاتٍ

“.. dhe për atë që frikësohet nga pozita e Zotit te tij, do të ketë dy xhenete”.²

Xheneti i parë ka të bëjë me pastërtinë, dëlirësinë dhe lumturinë e brendshme që i dhurohet besimtarit i cili e ndjek besnikërisht rrugën e Islamit dhe shfaq një dashuri të sinqertë për Krijuesin e tij.

2. Një mjet për të fituar druajtjen ndaj Zotit

Çdo urdhër në Kuranin Famëllartë shoqërohet me një shpjegim që tregon urtësinë dhe filozofinë e tij. Allahu nuk është një tiran që zbret verbërisht urdhra nga lart, përkundrazi të gjitha porositë



e Tij në Kuran synojnë t'i sjellin dobi njeriut në mënyra të ndryshme. Në lidhje me agjërimin, Allahu thotë në ajetin 184 të sures el-Bekare se qëllimi i tij është *"që të bëheni të druajtur"*. Agjërimi i jep njeriut një efekt freskie në trup, pra ai ia frenon ndjenjat e papërmbajtshme dhe i mpreh mendjen. Muslimanët gjithashtu u kushtojnë më shumë kohë namazeve të detyrueshme a vullnetare, lexojnë dhe studiojnë Kuranin Famëlartë, si dhe bëjnë vepra bamirëse. Agjërimi i ngjall njeriut ndjenjat e mirënjohjes ndaj Zotit për të gjitha bekimet e Tij mbi ne. Secili nga këto veprime është i lavdërueshëm në vetvete, por kur ato bëhen gjatë muajit të Ramazanit, ato janë veçanërisht të pranueshme për Zotin. Hazret Selman el-Farisiu ^{r.a.} transmeton se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ قَدْ أَظْلَمَكُمْ شَهْرٌ عَظِيمٌ ، شَهْرٌ فِيهِ لَيْلَةٌ خَيْرٌ مِنْ أَلْفِ شَهْرٍ ، جَعَلَ اللَّهُ صِيَامَهُ فَرِيضَةً ، وَقِيَامَ لَيْلِهِ تَطَوُّعًا ، وَمَنْ تَقَرَّبَ فِيهِ بِخَصْلَةٍ مِنَ الْخَيْرِ كَانَ كَمَنْ أَدَّى فَرِيضَةً فِيهَا سِوَاهُ ، وَمَنْ أَدَّى فَرِيضَةً كَانَ كَمَنْ أَدَّى سَبْعِينَ فَرِيضَةً فِيهَا سِوَاهُ ، وَهُوَ شَهْرُ الصَّبْرِ ، وَالصَّبْرُ ثَوَابُهُ الْجَنَّةُ ، وَشَهْرُ الْمَوَاسِقَةِ ، وَشَهْرٌ يُزَادُ فِيهِ رِزْقُ الْمُؤْمِنِ ، وَمَنْ فَطَّرَ فِيهِ صَائِمًا كَانَ مَغْفِرَةً لَذَنْبِهِ وَعَتَقَ رَقَبَتَهُ مِنَ النَّارِ ، وَكَانَ لَهُ مِثْلُ أَجْرِهِ مِنْ غَيْرِ أَنْ يَنْتَقِصَ مِنْ أَجْرِهِ شَيْءٌ ، قَالُوا : يَا رَسُولَ اللَّهِ لَيْسَ كُلُّنَا يَجِدُ مَا يُفْطِرُ الصَّائِمَ ، قَالَ : يُعْطِي اللَّهُ هَذَا الثَّوَابَ مَنْ فَطَّرَ صَائِمًا عَلَى مَذْقَةٍ لَبَنٍ أَوْ تَمْرَةٍ ، أَوْ شَرِبَةٍ مِنْ مَاءٍ ، وَمَنْ أَشْبَعَ صَائِمًا سَقَاهُ اللَّهُ مِنْ الْحَوْضِ شَرِبَتْهُ لَا يَطْمَأُ حَتَّى يَدْخُلَ الْجَنَّةَ ، وَهُوَ شَهْرُ أَوَّلِهِ رَحْمَةٌ ، وَوَسْطُهُ مَغْفِرَةٌ ، وَآخِرُهُ عَتَقٌ مِنَ النَّارِ ، فَاسْتَكْبَرُوا فِيهِ مِنْ أَرْبَعِ خَصَالٍ : خَصْلَتَانِ ثَرَضُونَ بِهَا رَيْكُم ، وَخَصْلَتَانِ لَا غَنَى بِكُمْ عَنْهَا ، أَمَّا الْخَصْلَتَانِ اللَّتَانِ ثَرَضُونَ بِهَا رَيْكُم : فَشَهَادَةُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ ، وَتَسْتَغْفِرُوهُ ، وَأَمَّا الْخَصْلَتَانِ اللَّتَانِ لَا غَنَى بِكُمْ عَنْهُمَا : فَسَأَلُونَ الْجَنَّةَ ، وَتَعَوَّذُونَ مِنَ النَّارِ

O njerëz! Ju ka ardhur një muaj madhështor, një muaj i bekuar, në të cilin gjendet një natë e cila (nga dobitë dhe madhështitë e saj) është më e mirë sesa një mijë muaj. Allahu i Lartësuar ju ka obliguar agjërimin gjatë tij, ndërsa adhurimin gjatë netëve të tij e ka bërë nafil. Nëse dikush synon t'i afrohet Allahut me ndonjë vepër të mirë vullnetare, do të shpërblehet sikur të ketë bërë një vepër të obligueshme. Nëse dikush realizon një vepër të obligueshme në këtë muaj, është sikur të ketë kryer 70 vepra të obligueshme në ditë të tjera. Ky është muaji i durimit dhe durimi shpërblehet me xhenet. Ky është muaji i dashurisë dhe dhembshurisë, gjatë të cilit i shtohet risku besimtarit. Nëse dikush ia çel agjërimin një agjëruesi, atij i shlyhen mëkatet dhe ai fiton shpëtimin nga zjarri. Njeriu i tillë shpërblehet njësoj si agjëruesi, pa ia pakësuar asgjë nga shpërblimi i tij.

Fillimi i këtij muaji është mëshira, kulmi është falja dhe përfundimi është shpëtimi nga zjarri. Gjatë këtij muaji, Allahu jo vetëm që e fal por edhe e çliron nga zjarri atë njeri i cili ia lehtëson detyrën punëtorit apo shërbëtorit të tij”.³

3. Agjërimi mëson vetëpërmbytjen

Shpesh kemi ndjerë se na mungon vullneti ose vetëdisiplina për të arritur qëllimet tona? Kjo vetëdije është universale dhe është interesante se një mënyrë për të interpretuar ajetin e mësipërm (2:184) është ta përkthejmë atë si “ju obligohen agjërimet ashtu siç u ishin obliguar atyre që ishin para jush, që të bëheni të vetëpërmbytjen”.⁴

Ky është një shembull i mrekullueshëm se si shkrimi arab i Kuranit lejon nuanca të ndryshme të kuptimeve që mbështesin njëri-tjetrin në mënyrë të ndërsjellë. Në këtë rast, agjërimi në fenë islame nuk mëson vetëm drejtësinë, por edhe vetëpërmbytjen. Agjërimi ndalon

ushqimin, pijen dhe marrëdhëniet bashkëshortore gjatë orëve të ditës. Largimi prej asaj që normalisht është e lejuar, ndërton e çelikos vullnetin tonë dhe në këtë mënyrë agjërimi na bëhet një mik besnik për ta nënshtruar këtë aftësi të brendshme për shpëtimin nga varësia e zakoneve dhe e veseve të këqija.

Jo vetëm kaq, por aftësia për të vonuar kënaqësinë në jetë është një tregues i mirë se sa të suksesshëm mund të bëhemi në një sërë veprimesh. Në 1972, psikologu Walter Mischel bëri një studim interesant në lidhje me vonimin e kënaqësisë, i cili njihet si “*Eksperimenti marshmallou në Stanford*”.⁴ Në këtë eksperiment një fëmijë do t’i paraqitej një marshmallou dhe do t’i thuhej se mund të ketë një marshmallou tani, ose mund të presë pesëmbëdhjetë minuta dhe të ketë dy marshmallou. Studimet e mëtejshme treguan se fëmijët që ishin në gjendje të vononin kënaqësinë e tyre dhe të duronin për të fituar dy marshmallou, ishin në gjendje të vepronin më mirë në një sferë të gjerë veprimesh në jetë dhe të tregoheshin më mirë në shkallën e mirëqenies. Ndonëse në Islam, agjërimi u obligohet vetëm atyre të rriturve që gëzojnë shëndet të plotë dhe nuk janë në udhëtim (2:186), megjithatë, në mund të mësojmë nga ky eksperiment i thjeshtë që përfshin fëmijët. A nuk do të ishim më mirë duke pasur më shumë vetëkontroll?



4. Zhvillimi i aftësive të brendshme për të përjetuar vizione

Ndonëse shumicës së njerëzve ndoshta nuk i është shfaqur kurrë një vizion të mrekullueshëm, kemi parë ëndrra që dalin të vërteta dhe në disa raste ndoshta kemi ndjerë një shqisë të gjashtë, dhe kemi përjetuar ndjesi të forta për ndonjë fenomen apo ngjarje që akoma nuk kishte ndodhur. Kurani Famëlartë ia atribuon këto përjetime shpirtërore shpalljes, e cila mund të marrë formën e ëndrrave, vizioneve dhe madje edhe vizitave engjëjllore.⁵

Ndoshta mund të jetë e vështirë për të besuar, megjithatë ata që kanë bërë përparime në zhvillimin e këtyre aftësive shpirtërore mund të vërtetojnë se padyshim agjërimi është një metodë e shkëlqyer për zhvillimin e këtyre aftësive të brendshme.

Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ^{a.s.} (1835-1908) ishte Mesihu i Premtuar dhe reformatori hyjnor, i dërguar për të sqaruar dhe shpjeguar mësimet e vërteta të Islamit. Ai shkruan në një vend në lidhje me bekimet e agjëritimit:

“Me fjalët ‘muaji Ramazan është ai në të cilin u zbrit Kurani’ kuptojmë rëndësinë e Ramazanit. Sufistët thanë se ky muaj është shumë i dobishëm për ndriçimin e zemrës. Gjatë tij njeriu shpesh përjeton vizione (*keshf*). Namazi ia pastron

shpirtin dhe agjërimi ia ndriçon zemrën.

Pastrim i shpirtit do të thotë që njeriu të fitojë largësinë nga epshet e nefsit amarah (që nxit për të keqen) dhe ndriçimi i zemrës do të thotë që atij t’i hapet dera e vizionit (*keshfit*), në mënyrë që ta shohë Zotin. Pra, fjalët “në të cilin u zbrit Kurani” këtë gjë e tregojnë. Nuk ka aspak dyshim që shpërblimi i agjëritimit është shumë i madh”.⁶

5. Agjërimi është mishërimi i së mirës

Kjo shprehje gjithëpërfshirëse buron nga Kurani. Allahu thotë në 2:185 “... dhe nëse agjëroni, kjo është mirë për ju, në qoftë se e dini”. Deri tani, kemi përmendur dobittë shpirtërore dhe shoqërore të agjëritimit, por ai ka edhe shumë dobi shëndetësore e fizike. Sipas një artikulli me titullin “*8 Health Benefits of Fasting, Backed by Science*” (8 dobittë shëndetësore të agjëritimit, të mbështetur nga shkenca)⁷ botuar nga Healthline, agjërimi është i dobishëm sepse ai

1. mbështet kontrollin e sheqerit në gjak duke zbritur rezistencën ndaj insulinës
2. ndihmon uljen e pezmatimit në organe të ndryshme
3. mund të shtojë efikasitetin e zemrës duke përmirësuar presionin e gjakut, trigliceridet (yndyra në gjak) dhe nivelin e kolesterolit

4. mund të rrisë funksionin e trurit dhe të parandalojë rregullimet neurodegenerative

5. ndihmon humbjen e peshës duke kufizuar marrjen e kalorive dhe duke përmirësuar metabolizmin

6. mund të rrisë sekretimin e hormonit të rritjes, i cili është baza jetike për rritjen, metabolizmin, humbjen e peshës dhe forcën e muskujve

7. mund të vonojë plakjen dhe të zgjasë jetëgjatësinë

8. mund të ndihmojë në parandalimin e kancerit dhe të rrisë efektivitetin e kimioterapisë

Pra ja ku i keni, pesë arsye për të agjëruar gjatë muajit të Ramazanit.

Prisni pak, a mos kam harruar të përmend se ka një festë në fund?

Në fund të ramazanit vjen një ditë e shënuar që njihet si *'Idul Fitr'* pra dita e Fitër Bajramit. Në këtë ditë festive, muslimanët mbledhen në një vend për të adhuruar Allahun dhe shprehin mirënjohje për bekimet e Tij si dhe për përjetimin e muajit të shenjtë të Ramazanit.

Shkurt, ramazani është një periudhë e bekuar për muslimanët anembanë botes. Është një muaj, të cilin ata e presin me

padurim e ngazëllim dhe trishtohen kur e shohin të largohet. Pra, nëse rastësisht takoni një musliman gjatë këtyre ditëve të bekuara, mos harroni ta uroni e ta përgëzoni atë me urimin tradicional *'Gëzuar ramazanin!'*

1. Kurani Famëlartë 2:184

2. Kurani Famëlartë 55:47

3. Hafiz Ibn Haxhr el-Askalani, *Hidajeturr-Ruvati ila Takbrixhi Abadith*, Dar Ibn el-Kajjim, në Damam, 2001, f. 1906.

4. https://www.wikiwand.com/en/Stanford_marshmallow_experiment

5. "Nuk është e mundur për një njeri që Allahu t'i flasë atij, përveçse me anë të shpalljes ose mbrapa një perdeje ose atij t'i dërgohet (prej Allahut) një i dërguar (pra engjëll), i cili i shpall atij me urdhrin e Tij për çfarë të dojë Ai. Sigurisht Ai është shumë i Lartë, shumë i Urtë". (Kurani Famëlartë 42:52)

6. Mirza Ghulam Ahrned ^{a.s.}, *Melfuzat*, vëll. 2, botimi 2003, Rabvah, f. 561-562.

7. <https://www.healthline.com/nutrition/fasting-benefits>

Rreth autorit

Azhar Goraya (Az'har Goraja) është i diplomuar në Institutin Ahmedian të Gjuhëve dhe të Teologjisë në Kanada. Ai aktualisht po shërben si Imam (misionar) në Meksikë. Ai është gjithashtu Koordinator i Amerikës Qendrore për revistën *"The Review of Religions"* në gjuhën spanjolle.

Salatul-haxhe

Lutja dhe namazi për nevojë

Hazret Abdullah Ibni Eufa ^{r.a.} tregon se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë:

Ai që ka nevojë për diçka prej Zotit të Madhërishëm ose prej ndonjë njeriu, le të marrë abdes sa më mirë e të falë dy nafile si namazi për nevojë (salatul-haxhe). Pas lavdërimit dhe falënderimit të Zotit të Madhërishëm dhe dërgimit të salavateve, le të bëjë këtë lutje:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْحَلِيمُ الْكَرِيمُ سُبْحَانَ اللَّهِ رَبِّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ أَسْأَلُكَ مُوجِبَاتِ
رَحْمَتِكَ وَعَزَائِمَ مَغْفِرَتِكَ وَالْغَنِيَمَةَ مِنْ كُلِّ بَرٍّ وَالسَّلَامَةَ مِنْ كُلِّ إِثْمٍ لَا تَدْعُ لِي ذَنْبًا إِلَّا غَفَرْتَهُ وَلَا هَمًّا إِلَّا
فَرَجْتَهُ وَلَا حَاجَةً هِيَ لَكَ رِضًا إِلَّا قَضَيْتَهَا يَا أَرْحَمَ الرَّاحِمِينَ

Nuk ka të adhurar tjetër përveç Allahut, të Dhembshurit dhe Bujarit! I Shenjtë është Allahu, Zoti i arshit madhështor! Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve. Të kërkoj gjërat që tërheqin mëshirën Tëndë, shkaktarët e faljes Sate, mundësinë për të bërë çdo vepër të mirë, mbrojtjen nga çdo mëkat. Mos më lër gjynah pa falur, brengë pa larguar dhe nevojë që përputhet me pëlqimin Tënd, pa plotësuar, o më i Mëshirshmi nga të gjithë mëshiruesit.

(Tirmidhiu, Kitabul-vitr, bab salat-il-haxhah)

INDEX IN ENGLISH

10 6 grades of Moral Development

An in-depth explanation of the Holy Qur'an, which explores the six levels of moral development of human being.

HAZRAT MIRZA GHULAM AHMAD ^{A.S.}
PROMISED MESSIAH & IMAM MAHDI

18 How to find God?

HAZRAT MIRZA GHULAM AHMAD ^{A.S.}
PROMISED MESSIAH & IMAM MAHDI

20 If God is truly compassionate, then why there is so much suffering in the world?

HAZRAT MIRZA GHULAM AHMAD ^{A.S.}
PROMISED MESSIAH & IMAM MAHDI

26 The First Hadith about intention

An explanation of the first hadith from the collection of “40 *Hadith of Imam Nevevi*”

30 10 Arguments about the Existence of God

The first argument about the existence of God based on the unity between various religions.

HADHRAT MIRZA BASHIRUDDIN MAHMOOD AHMAD ^{R.A.}
SECOND SUCCESSOR TO PROMISED MESSIAH

40 Silence or Sanctity: Islamic teachings on safeguarding honour yet seeking justice

Why Islam prohibits public disclosure of vulgarity and instructs people to report injustices to the right authorities.

IFTEKHAR AHMAD

52 Rape in Islamic law: Establishing the crime and upholding the rights of the innocent'

62 7 Levels of the perfection of prayer

66 Tahajjud without an alarm clock: 13 ways to wake up without snoozing

If you have been struggling to wake up, here are 13 effective ways to get up for Tahajjud without the aid of an alarm clock.

HADHRAT MIRZA BASHIRUDDIN MAHMOOD AHMAD ^{R.A.}
SECOND SUCCESSOR TO PROMISED MESSIAH

72 Trials in the life of a believer

78 Who is Dajjal (Antichrist)?

84 Attributes of Allah

This series delves deeper into each of God's Attributes to gain a better understanding of His Being.

92 5 Reasons Why Muslims Fast During Ramadan

An answer to the question why do Muslims willingly go through a month of self-deprivation and hardship?

الذِّكْرُ لِلَّهِ يُتْلَىٰ فِي الْقُلُوبِ

Dijeni!
Zemrat getësohen vetëm
me përmendjen e Allahut!

Kurani Famëlartë 13:29

VERË 2022

6 GRADAT E ZHVILLIMIT MORAL

VERTETËSIA

NUMRI 14

SHPINË